

revista shqiptare e turizmit rajonal

# travel

albaniantravel.info

N° 21 | 2016



Perioidike / Botim i Blue Agency / ÇMIMI/PRICE Shqipëri 300 lekë / Kosovë, Mali i Zi 3 € / Maqedoni 160 Den. Greqi, Itali 5.5 €

## Aromë Berati

Udhëtim mes magjisë e shijeve të Qytetit të Bardhë

## Festa e Ullirit

Ripërtëritja e Roskovecit, qytetit-stacion të Rrugës Egnatia

## Të jetosh malet

përmes tureve me biçikleta nëpër bukuritë e Malësisë së Madhe

Nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Fier, Z. Armando Subashi, ky është projekti më i madh etnokulturor i vitit 2016 dhe 2017 i Bashkisë Fier, që do të zhvillohet në të 10-të njësitë administrative të saj dhe që synon të rivitalizojë traditat kulturore të të gjithë trevës së Myzeqesë

Në ballinë:  
Kostume kombëtare të Myzeqesë  
Foto: Elvi Kote ©

*Harajd' dalim*

nga

# Myzeqeja

Projekti më i bukur etnokulturor 2016-2017



★★★★  
**SCARDUS**  
— HOTEL —

Kodra e Diellit, 1220 Tetovë, Tetovo, Macedonia; +389 44 361 227; info@hotelscardus.com

[www.hotelscardus.com](http://www.hotelscardus.com)




- 4 stars standard
- Pool
- Jacuzzi
- Sauna
- Turkish Sauna
- Sport activities
- Room services
- Free Wi-Fi

*Stay with us and feel like home...*





*Ju fantazoni për t' u bërë të dashurve të zemrës,  
surprizën më bukur të jetës  
Ne ju ndihmojmë ta realizoni atë*



**Shërbimet:**

- Fluturime VIP për udhëtarë
- Fluturime udhëtarësh për evente të ndryshme
- Fluturime për misione të ndryshme filmike dhe fotografike (private apo për televizione)
- Guidë për turistë vendas dhe të huaj, etj.

**Autostrada Tiranë – Durrës,  
Km 12 Bërçull, Tiranë, Albania**

**Tel.: +355 4 2408418 / 419; Fax: +355 4 2408420**

**Mob: +355 68 8030355; Mob: +355 68 4030143**

**e-mail: [info@shega-air.com](mailto:info@shega-air.com); [www.shega-air.com](http://www.shega-air.com)**



**Shega Air**

*feel the difference...*






# Përmbajtja/Contents

Jemi mësuar me imazhe të tjera të Gjirokastrës si trashëgimi e UNESCO-s, me kalldrëmet dhe shtëpitë e saj të bukura. Por kjo ndodh sepse nuk njohim shumë anën tjetër të saj, natyrën e pashoqe, fshatrat karakteristike, trashëgiminë e paçmuar kulturore, historike, shpirtërore e fetare që ndodhet në këto fshatra. Nëse nuk e keni provuar se çfarë dotë thotë të vizitosh nga afër Libohovën, Antigonën, Kardhiqin, Zagorinë, Lunxhërinë, atëherë do të thotë që ka ardhur koha ta provoni tani. Duke kalëruar. Me Caravan Riding Centre

Photo: Blue Albania ©







## Rubrika / Articles

- 8 Editorial**  
Sezoni turistik 2016 dhe pritshmëritë për vitin 2017  
*Milva Ekonomi*
- 24 Intervista**  
Shkëlzen Rexha: Do të kisha dashur t`ia jepja vetë Papës fotografinë e Gjakovës për tolerancën fetare  
*Irhan Jubica*
- 22 Speciale**  
Me arbëreshët në Molise dhe Kalbari  
*Mal Berisha*
- 22 Fokus**  
Ukraina, porta e një tregu të mundshëm turistik dhjetëra milionësh  
*Tatjana Bajraktari*
- 53 Reportazh**  
Është koha e duhur për të kalëruar  
*Flora Xhemani Baba*
- 60 Natyrë**  
Rreth e qark Ballkanit.... me biçikletë  
*Egerin Braçe*
- 66 Itinerar**  
**Jugu I mistershëm**  
prej këndvështrimit të vizitorëve ndërkombëtarë
- 70 Traveller**  
Zgjidh pesë aventurat më të mira shqiptare  
*Dillon Thompson*

## Destinacione / Destinations

- 38** Në Krujën e bukur të Skënderbeut, Muzeve e Pazarit karakteristik
- 42** Vjeshtë përmetare
- 46** Thethi, kreshniku i bukur i Alpeve
- 50** Të jetosh malet e Malësisë së Madhe përmes tureve me biçikleta

## Events

- 35 Festa e Gjelit të Detit**  
Dhjetor, Cakran, Fier
- Panairi i Shtutgartit**  
Janar 2017





Botues: Blue Agency ©

Administrator: Florian Baba

Kryeredaktor:  
Irhan Jubica

Koordinatorë:  
Flora Xhemani Baba

Konsulentë  
Arjan Konomi  
Sophia Clingenberg

Gazetare:  
Irena Kanani

Bashkëpunëtorë:  
Adriana Mile, Blerina Ago, Bledar Kaciu, Dillon Thompson, Egerin Braçe,  
Ermir Hoxha, Ilirjan Gjika, Giz, CABRA, Luan Dervishej, Mal Berisha, Kas-  
trio Faci, Milva Ekonomi, Rudina Hoxha, Sonila Hoxholli, Tatjana Bajraktari.

Falëndrojmë:  
Bashkinë e Fierit, Bashkinë e Roskovecit, AADF - Fondacionin Shqiptaro-  
Amerikan të Zhvillimit, Ekipi i Projektit "Zhvillimi i Integruar dhe i  
Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor" /GIZ, Projektin Giz-CABRA, Cesvi  
Përmet, Vis Albania, Klubin "Discover Albania".

Fotografia:  
AADF, Giz, Adis Shera, Aler Travel, Ardjan Bërdufi, Aurel Duka, Blue Albania,  
Cesvi Përmet, Elvi Kote, Igli Pustina, Fation Plaku, Kastriot Faci, Mal  
Berisha, Vis Albania, Klubi "Discover Albania, Thoma Duka,

Designer:  
Anisa Kaso, Adriatik Baba

Marketingu  
Blue Agency

Distribucioni:  
Shqipëri: Adrion L.t.d,  
Posta Shqiptare  
Kosovë: Rilindja, Buzuku  
Maqedoni: TDS Kiosqe Sh.p.k.

Përgjegjës botimi për Maqedoninë  
TDS Kiosqe Sh.p.k.

## travel

magazine

Btv. Bajram Curri, P. Agimi, Nr. 14/260  
Tel: +355 68 40 17 309  
Email: revista@albaniantravel.info  
Web: www.albaniantravel.info

Partners:



# Mos humbisni:

# Destinacionet ujeshkë-dimër

Të dashur lexues!

U bënë tashmë thujse gjashtë vjet që revista Travel ju sugjeron destinacionet dhe itineraret turistike më të bukura e më të frekuentuara në Shqipëri dhe në trojet shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi. Kemi qenë bashkë në Veri e në Jug, i kemi rënë atdheut kryq e tërthor e kemi zbuluar bashkë vende të bukura e të mbushura me magji, mister, natyrë, kulturë e histori, në çdo cep të vendit. Shqipëria sa ç'është e vogël, aq është edhe e madhe dhe bukuritë e saj nuk kanë fund. Tashmë ne vazhdimisht përpiqemi t'ju sjellim jo më vende të reja por qasje të reja për vende të njohura, lloje të reja eksperiencash e mënyrash udhëtimit, duke e bërë pushimin tuaj më interesant. Në këtë numër që përfshin brenda tij edhe festat më të bukura të

A e ndjeni ndopak atmosferën e festave të Fundvitit?

"Takhemi së shpejti në Cakran, aty ku do t'i vendosim kuroren e mbretit të shpendëve, Gjelij të Detit, këtij sukcesi të fermerëve cakranjotë!"

- Në vazhdim të Turit Etnokulturor të Bashkisë Fier -




vitet për ne, ato të Nëntorit dhe të Fundvitit, ju kemi sjellë një buqetë përvojash e përjetimesh që i kapërcejnë stinët dhe shkojnë përtej një sezoni të thjeshtë. Zbuloni se sa bukur është të përshkoh Ballkanin me biçikletë, sa hare e madhe është të festosh me vendasit nëpër festa lokale, traditat e tyre më të bukura, përjetoni emocionet dhe mallin e Arbëreshëve të Italisë përmes rrëfimit të një ambasadori shqiptar që i ka takuar ata atje ku jetojnë, njihni produktet natyrale dhe mikpritjen shqiptare përmes fermave unike në Shqipëri e shijoni përvoja të paharrueshme përmes ripërtëritjes së traditave të vjetra, ardhur në kohëra të reja, më bukur e më fort se më parë. Udhëtim të këndshëm!





# RADIKA

HOTEL & SPA RESORT



Hotel Radika  
V. Leunovo Mavrovo  
Republic Of Macedonia  
© Radika.Com.Mk  
Contact:  
Telephone+389 42 22 33 00  
Mobile+389 75 32 53 06  
E-Mail Info@Radika.Com.Mk



RADIKA

HOTEL & SPA RESORT





## NË SHIFRA

140.000.000

euro është afërsisht shifra e të ardhurave nga turizmi për 6-mujorin e I<sup>re</sup> të vitit 2016, shifër që u deklarua edhe në Samitin e Diasporës, në Panelin e Turizmit dhe që u pohua edhe nga ministrja e turizmit e pranishme në panel. Megjithatë, deri në mbyllje të vitit, shifrat nuk janë ende zyrtare

63.800.000

euro do të investojë Banka Botërore për infrastrukturën në Gjirokastrë, Berat e Përmet. Veç zbutjes së varfërisë, projekti synon rritjen e mirëqenies dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit.

574.600

turistë nga Maqedonia kanë realizuar mbi 1.3 milionë netë fjetjeje në Greqi gjatë periudhës Janar-Qershor 2016, duke shpenzuar mbi 69 milionë euro. Vendet e para në Greqi i kanë gjermanët, britanikët e bullgarët.

45.000

polakë, ose 10% më shumë se një vit më parë, e vizituan Shqipërinë gjatë sezonit veror të 2016 me 4 chartera në javë. Agjencitë turistike do të sjellin 10 chartera në javë në Qershor-Shtator 2017.

575

lloje të faunës, 402 lloje bimësh dhe 59 lloje peshqish kërcënohen në Shqipëri, e një pjesë e të cilave nga ndërtimet pa kriter në zonat që shërbejnë si habitatet e tyre natyrore.

15

klube alpinistësh veprojnë në territorin malor të Shqipërisë, duke përfshirë Bajram Currin, Shkodrën, Kukësin, Peshkopinë, Beratin, Gjirokastrën, Përmetin etj.

2

vende ballkanike - Turqia dhe Greqia, janë dëmtuar rëndë në turizëm nga vala e emigrantëve. Shifrat zyrtare flajn për rënie të të ardhurave nga turizmi deri në 30% për Turqinë dhe 4.9% për Greqinë.



Muzeu i kujtesës, BUNK'ART 2, në kujtim të viktimave të terrorit të diktaturës komuniste. © Blue Albania

## NË VEND TË EDITORIALIT

# Pasqyra e sezonit turistik 2016 dhe pritshmëritë për 2017-ën

**Milva Ekonomi\***

Sezoni turistik veror 2016 ishte padyshim sezoni turistik më i suksesshëm deri tani. Kjo nuk është aspak e rastësishme, por është meritë e përpjekjes në radhë të parë të sipërmarrjes turistike por pa lënë mënjanë punën intensive të agjencive të ndryshme shtetërore për t'iu përgjigjur në kohë nevojave të tyre.

Shifrat për këtë sezon turistik tregojnë se numri i vizitorëve të huaj që erdhën në Shqipëri gjatë Sezonit Turistik Veror (Qershor – Gusht) 2016 në total ishte 2.376.000 shtetas të huaj, 19,7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015. Gjatë këtij sezoni numri më i madh i vizitorëve, ashtu si dhe një vit më parë, ka qenë nga Kosova, ndjekur më pas nga Maqedonia, Mali i Zi, Greqia, por një numër i lartë vizitorësh erdhën nga Anglia, Gjermania, Çekia, Franca, Italia, Norvegjia etj.. Megjithatë, bie më shumë në sy se gjatë këtij sezoni veror ka patur një rritje të numrit të vizitorëve nga disa prej tregjeve të synuara Evropiane dhe Botërore, si rritja me 111% nga vizitorët ukrainas, rritja me 63% e vizitorëve suedezë, rritja me 42% e vizitorëve bullgarë, rritja me 33% e vizitorëve norvegjezë, rritja me 30% të vizitorëve polakë dhe rritja me 22% e vizitorëve kroatë.

Ndërkohë numri i fluturimeve charter gjatë sezonit veror 2016 arriti në 116 përkundrejt vetëm 60 që ishte ky numër në vitin 2015. Kjo rritje fluturimesh 198% solli dhe një rritje të drejtpërdrejtë prej 204% të numrit të pasagjerëve që udhëtuan drejt vendit tonë.

Gjithashtu, gjatë sezonit 2016 në vendin tonë operuan edhe dy linja të reja ajrore, "Bravo Airways" dhe "Onur Air", të cilat kanë mundur fluturime charter të programuara me destinacion Shqipërinë.

Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, tregojnë se hyrjet e Kroçerave dhe Jahteve turistike në Shqipëri gjatë periudhës Janar – Gusht 2016 janë rritur me 30% duke e cuar në 924 numrin e mjeteve të tilla që arritën brigjet shqiptare.

Ndër to, numri më i madh përbëhet nga mjetet "Jahte/Veliere turistike", të cilat zënë një pjesë

prej 85% të të gjithë mjeteve. Fluksi më i lartë, në këtë periudhë është vënë re në Portin e Sarandës, ndjekur nga Porti i Durrësit dhe me pas nga Porti i Vlorës.

Një rritje e ndjeshme është vënë re edhe në shifrat e turizmit kulturor. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Kulturës, vërehet një trend pozitiv i treguesve të ndryshëm (vizitorë dhe të ardhura). Më saktësisht, nga viti 2015 në vitin 2016, gjatë sezonit veror, vizitorët në muze, parqe dhe monumente kulturore janë rritur me 15%, ndërkohë që të ardhurat e arkëtuara nga këto institucione janë rritur me 16%. Vërehet që numri më i lartë i vizitorëve është i përqendruar në Parqet

### Sezoni

### turistik

### veror 2016 ishte

### padyshim sezoni turistik më

### i suksesshëm deri tani. Kjo nuk

### është aspak e rastësishme, por

### është meritë e përpjekjes në

### radhë të parë të sipërmarrjes

### turistike por pa lënë mënjanë

### punën intensive të agjencive të

### ndryshme shtetërore për t'iu

### përgjigjur në kohë nevojave

### të tyre.

Kombëtarë.

Ndërkohë edhe turizmi natyror në Shqipëri ka patur një rritje të ndjeshme. Në vendin tonë ekziston një sistem i zonave të mbrojtura (ZM), që mbulojnë mbi 460,000 ha dhe shtrihet në mbi 16% të territorit të vendit. Baza e sistemit të zonave të mbrojtura konsiston kryesisht në 15 parqe kombëtare, disa rezervate natyrore të menaxhuara e peizazhe të mbrojtura, në të cilat strehohen vlerat më të mëdha natyrore dhe biodiversitetit në vend.

Numri i turistëve në këto zona ka pasur një rritje prej 3.3 herësh në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë. Konkretisht gjatë vitit 2015 numri total i vizitorëve brenda këtyre zonave gjithsej ka qenë 471,967 vizitorë prej të cilëve 359,937 ishin vizitorë vendas dhe 112,080 vizitorë të huaj. Gjatë vitit 2016





numri total i vizitorëve brenda ZM-ve ka qene (deri më 31 Gusht 2016) gjithsej 1,562,148 vizitorë. Ndër to 1,430,630 ishin vizitorë vendas dhe 131,518 vizitorë të huaj.

Po ashtu edhe të ardhurat nga Turizmi kanë pasur një rritje mjaft të lartë. Të ardhurat nga udhëtim/turizmi për 6-mujorin e parë të vitit 2016, sipas Bilancit të Pagesave të Bankës së Shqipërisë, kanë qenë 640 milionë Euro, duke shënuar një rritje prej 8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur këto të ardhura kanë qenë 592 milionë euro. Të dhënat nga Banka e Shqipërisë evidentojnë se në tremujorin e dytë të këtij viti portofoli i kredisë për bizneset në aktivitetet e hotelerisë dhe shërbimeve u rrit me 2,9%, duke zënë 38,1% të portofolit total të kredisë.

Të ardhurat neto nga udhëtim/turizmi për 6-mujorin e parë të 2016 kanë qenë 140 milionë euro. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur të ardhurat neto ishin 118 milionë euro, kemi një rritje prej 19%. Grupi i subjekteve të regjistruara "Akomodim dhe shërbimi ushqimor" nga të dhënat që vijnë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ka pasur rritje me 2,4% për periudhën janar-gusht 2016 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërkohë po t'i referohemi të dhënave nga ËTTC deri në fund të 2016-s, sektori i turizmit pritet të gjenerojë punësim për rreth 77,000 persona.

Shifrat mbresëlënëse nuk janë të rastësishme. Është punuar shumë dhe me prioritet për promovimin e vendit në tregjet ndërkombëtare. Promovimi i Shqipërisë vitet e fundit ka patur një rritje eksponenciale nëpërmjet pjesëmarrjes në panairt ndërkombëtare më të rëndësishëm të turizmit, si: WTM Londër, Ferien Messe, Vjenë, FITUR Madrid, Spanjë, BIT Milano, Itali; ITB Berlin, Gjermani si dhe në panairt e tregjeve të synuara si Rusia, Çekia, Hungaria, Kosova etj.

Padyshim që eventit europian i futbollit "Euro 2016" që një rast i mirëpritur për të promovuar Shqipërinë turistike. Në shtëpinë e kuq e zinjve, stenda shqiptare turistike i ofroi De Biazit dhe krye bashkiakut të Perros Quirec edhe pasaportën e Shtetasit Turistik Shqiptar.

Kështu vetëm numri i pjesëmarrjes së Shqipërisë në panairt ndërkombëtare të turizmit ka shënuar një dyfishim po ti krahasojmë me vitin 2013. Kujtojmë se kjo është një rritje e cila ndodh për herë të parë gjatë gjithë historisë dhe veprimtarisë së turizmit shqiptar në drejtim të promovimit të produkteve të veta turistike në tregun Europian dhe Botëror të Turizmit.

Gjatë kësaj periudhe kohore për herë të parë Shqipëria është shtrirë edhe në tregje perspektivë jashtë kontinentit Europian si në Azinë e Largët dhe Kinë. Krahas pjesëmarrjeve nëpër panairt, të cilat njihen si vendtakimet më të mëdha të biznesit turistik botëror, gjatë kësaj periudhe dhe veçanërisht në 2016 kanalet e komunikimit kanë qenë të larmishëm dhe efikase, si psh udhëtimet familjarizuese me media prestigjioze botërore (National Geographic, TV Monde 5, RAI, Yahoo Travel, Lonely Planet, etj) dhe subjekte të huaja (për t'u përmendur shoqata e A.T.T.A- s, Shoqata Ndërkombëtare e Turizmit të Aventurës), promovimi online, projektet për nxitjen e turizmit etj. Janë organizuar 14 udhëtime familjarizuese deri në fund të gushtit të këtij viti me operatorë dhe media të huaja, të cilët mbresat dhe eksperiencat nga vizita i pasqyrojnë në mediat e tyre respektive.

Pa dyshim që në këtë rritje të përmendur më lart, një kontribut të rëndësishëm kanë edhe subjektet e biznesit turistik privat, pa të cilët rritja do të kish qenë e vështirë. Pjesëmarrja e tyre në panairt e turizmit ka ardhur në rritje dhe në një shtrirje të konsiderueshme, duke përfshirë krahas agjencive me përvojë dhe të konsoliduara edhe agjenci të reja aktive dhe dinamike në treg.



Po projektohet dhe po krijohet një imazh cilësor dhe i qëndrueshëm i turizmit duke u fokusuar në atë çka e bën Shqipërinë unike, por dhe duke garantuar shërbime për turistin, sa më afër standardeve ndërkombëtare.

Projekti më i rëndësishëm në kuadër të promovimit të vendit tonë është përfaqësimi në Panairin e Shtutgartit si vend partner, status ky i cili do të lejojë që vendosja në panair të jetë qëndrore dhe sytë të jenë të drejtuar drejt vendit tonë. Kjo për turizmin shqiptar do të thotë më shumë vizibilitet në tregun europian ose edhe më gjerë. Arritja deri këtu, është bërë e mundur falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me Messe Shtutgart, por edhe prej angazhimit të gazetarëve gjermanë, të cilët në mënyrë vazhdueshme kanë marrë pjesë në "Fam Tour" në Shqipëri, duke ndikuar në rritjen e fluksit të turistëve gjermanë në vendin tonë. Nga ana tjetër, Samiti i Berlinit dhe përpjekjet e bëra nga GIZ në Shqipëri, kanë rritur vëmendjen ndaj turizmit shqiptar. Por, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe punën e mirë që ka bërë media ndërkombëtare sepse Shqipëria, përveç shtypit gjerman, kanë qenë qendër të vëmendjes edhe në shtypin anglez, italian, grek, spanjoll, ballkanik, amerikan, francez dhe të gjitha bashkë influencuan që Shqipëria të ishte vend partner në CMT Shtutgart.

Për sa i përket punës në vazhdim, vlen të përmendet se sot vendi ka hartuar dhe miratuar planin kombëtar të rregullimit të territorit, planin e rregullimit të bregdetit dhe ka hartuar një program për zhvillimin e zonës Durrës-Tiranë, DURANA. Këto dokumente po shërbejnë si bazë për të përditësuar edhe strategjinë e zhvillimit të turizmit, e cila do të përfundojë brenda këtij viti. Ky është kuadri i përgjithshëm i veprimit, i cili do të shoqërohet me aktivitete konkrete si zhvillimi i marinave, thithjen e investimeve strategjike sipas zonave të zhvillimit të turizmit, rinovimin i informacionit promovues mbi produktin turistik që ofron Shqipëria, certifikimi i standardeve të strukturave akomoduese dhe çka është më e rëndësishme projektimi i markës Quality Albania, duke dhënë më shumë fokus edhe aftësimin profesional të punonjësve të industrinë e turizmit.


#### \* Ministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes











## Drilon, Pogradec, AL

Është një prej spoteve natyrore më të spikatura në Shqipëri, ku të gjitha stinët janë të mrekullueshme por më e bukura nga të gjitha është Vjeshta. Të vizitosh Drilonin në Vjeshtën e Dytë dhe të Tretë, është një kënaqësi që nuk duhet t' i hiqni vetes çdo vit, aq më tepër që edhe vjeshta nuk vjen kurrë e njëjlojtë

Photo: Blue Albania"©









## **Lugina e Bogës Malësi e Madhe, AL**

E quajtur ndryshe edhe si Porta e Alpeve Shqiptare, Lugina e Bogës, është një prej vendeve më të bukura të Malësisë së Madhe, e cila në stinën e vjeshtës merr një pamje mahnitëse, prej pranisë së drurëve të ahut. Me infrastrukturën e përmirësuar, ajo është bërë mjaft tërheqëse për turistët.

Photo: Blue Albania"©



# Moj e bukura Moré.....

## Me Arbëreshët në Molise dhe në Kalabri

Arbëreshët, si vazhdues të denjë të frymës 'Skënderbjane' dhe ruajtës së traditave shqiptare ndër shekuj, duket se i kanë rrëmbyer shpirtin dhe e kanë frymëzuar në kërkimet e tij diplomatit dhe studjuesin Mal Berisha. Ambasadori, i njohur për ndjenjat e tij patriotike, realizoi këtë verë një udhëtim në rajonet arbëreshe të Molisesë dhe Kalabrisë. Duket qartë se ky interes i tij rreth arbëreshëve është i hershëm...

Ja disa nga përshtypjet e tij nga ky udhëtim të shoqëruara me foto nga kamera e tij:



### Mal Berisha\*

Para tre vjetësh, bashkë me zonjën time dhe familjen e një vajze shqiptare, atë kohë diplomate e Shqipërisë në Londër, e shquar për patriotizimin e saj, zonjën Xhoana Papakostandini, të shoqin Serxhion dhe vajzën tre vjeçare Anjën, vajtëm për të dhuruar dhe inaguruar Bustin e Skënderbeut në një fshat arbëresh, në Rajonin Molise, në fshatin Munxhufuni.

Ai fshat është një prej 52 fshatrave arbëreshe të Italisë Jugore. Si dhe fshatrat e tjera, banorët e atyshëm arbëreshë i kanë ruajtur në mënyrë shembullore gjuhën, traditat dhe zakonet shqiptare deri në ditët e sotme. Ky bust u vendos pas një kërkese që arbëreshja e atij fshati me banim në Londër, Maria Vittoria D'Inzeo, i bëri Ambasadës Shqiptare për ta ndihmuar në vendosjen e një busti të Skënderbeut në





fshatin e saj, Munxhufuni. Kjo ide asaj i lindi pas pjesëmarrjes në ceremoninë e organizuar për inagurimin e bustit të Skënderbeut në Londër, me datën 28 nëntor 2012.

### Në katundin arbëresh Çifte (Civita)

Fshati Çifte është i vendosur në mes të një lugine të rrethuar tërësisht me shkëmbinj. Në fakt të duket sikur aty je në një hon të krijuar për të kujtuar Kështjellën e Krujës dhe atë të Kalasë së Ali Pashë Tepelenës së bashku. Nga ana tjetër sikur je në këmbët e Kështjellës së Rozafës.

Në Çifte, tradita e respektit ndaj Skënderbeut vazhdon. Në hyrje, objekti i parë me të cilin ballafaqohesh është busti i Skënderbeut. Ne mes të fshatit gjenden dy piktura murale të mëdha, Muzeu i Katundit si dhe Kisha. Aty vërehet qartë tradita shqiptare e ndërtimit e kombinuar me atë të Italisë së jugut. Gëzim dhe krenari për vëllezërit e *“Gjakut tonë të Shprishur”* që e ruajtën identitetin në shekuj. Por kohërat kanë bërë që arbëreshët të ballafaqohen me plakje populsië, largim masiv të rinisë, rënie drastike të lindshmërisë ... Pikturat në fshat të kujtojnë dekorin e fshatrave arbëreshe në Rajonin e Molises.

Fshatrat arbëreshe, si edhe ato italiane të Kalabrisë kanë një karakteristikë të përbashkët: Shtëpitë janë shumë afër me njëra-tjetrën. Rrugicat kalojnë nëpër korridore që gjarpërojnë pas çdo cepi shtëpie. Duket sikur nga ballkoni i katit të dytë mund t'i zgjasësh kafënë gjithë ditës. Dyert vijë njëra pas tjetrës. Mjerisht një numër i madh i atyre dyerve kishin vite që ishin mbyllur.

Kalojmë mospërmasë fshatit. Një rrap shekullor lëshon hije të rëndë dhe një çezmë freskon me ujë e vet të ftohtë. Më kujton rrapin e Libohovës dhe atë të Shën Vasilit në Sarandë. Aty janë grumbulluar burrat e fshatit dhe kuvendojnë arbërisht. Afrohemi dhe flasim me ta. Kemi vështirësi të kuptohemi por jo se nuk merremi vesh. Pasi na pyesim se nga jemi dhe iu tregojmë që jemi nga Shqipëria njëri nga ata na thotë:

*“Ah mirë, mirë, thamë se jeni nga Kosova. Ata nuk na kanë harruar asnjëherë”*. Pastaj përshëndetemi me një zonjë që ka dalë në ballkon. Ajo menjëherë na tregon që është arbëreshe dhe fshati është i tëri i populluar me arbëreshë. *“Katundi, – na thotë ajo, – kishte pesë mijë vetë, por tani nuk jemi as tre mijë. Njerëzia po ikin”*. Ecim dhe shohim se në mes të fshatit gjendet kisha. Pranë saj ndodhet edhe muzeu etnografik.

### Vizitë në “Muzeo Etniko Arbëresh” në Çifte

Në katund të orientojnë tabelat: *“Kështjeli i Krujës”, “Udhëtim Mëmëklishtë”, “Grykat e Rrakanjelit”, “Ura e Djallit”, “Muzeo Etniko Arbëresh”*. I kalojmë të gjitha dhe vimë tek muzeu. Hyjmë brenda dhe para nesh shfaqet një muzeum që të bën të ndalësh frymën. Ai është i mbushur me gjërat më përfaqësuese të arbëreshëve: Veshje popullore, qëndisje me dorë, vegla pune, libra, koleksioni i revistës *“Katundi Ynë”*, botime, fotografi njerëzish të shquar, historira të fshatit. Muzeu funksionon që prej vitit 1970. Ciceroni na tregon dhe për kujdesin e treguar nga diplomatët shqiptar Visar





Zhiti dhe Gerarta Zheji Ballo për studimet e fshatit. Dhimitri Emmanueli, botuesi i revistës na citon në arbërisht:

*“Kur isha i vogël gjith folëjin arbrisht. Edhe kushërinjët ka Kasana folëjin arbrisht sepse e jëma cje Maria ish Ciftjote. Edhe sot, na miq, cë nëngë jemi aq trima, folëmi, me hir dashje, arbrisht. Edhe kur përpiqemi me miqtë ka Frasinata, ka Ungra, ka, Spixana, ka Shën Mitri, ka Mbuzati, ka Strighar, edhe ka Picilia folmi arbrisht. Po trimat me ata më të voglit folëjin vetëm italisht.”*

### “Bukë dhe Verë” arbëreshe në Santa Sofia d’Epiro

Ndalemi në fshatin Santa Sofia d’ Epiro. Aty menjëherë dallojmë dy gjëra shqiptare: Flamurin shqiptar përkrah atij italian dhe europian që valviten pranë e pranë në fasadën e kishës. Në krah të kishës gjëndet një restorant mbi derën hyrëse të të cilit shkruhet në gjuhën shqipe: **Bukë dhe Verë**.

Ndalemi dhe flasim me arbëreshët e klubit. Ndjejmë mikëpritjen e njerëzve të gjakut tonë. Na ftojnë të pimë diçka të freskët. Njeri më thotë:

*“Eja me mua të shohësh Fjamurin tënë mbi kishë”!*

Dhe vërtetë ashtu ishte. Aty në një dyqan të thjeshtë gjejmë edhe disqet e këngëve për arbëreshët të inçizuar nga

këngëtari shqiptar Lirio Nushi nga Vlora. Në një rën prej tyre thuhej:


*“Askush nuk mund të më kthej nga rruga që jam nisur,  
Askush nuk më ndalon dot të shkoj ndër arbëreshët,  
Atje më janë vëllezërit e mi të lashtë,  
Atje më janë vëllezërit e mi antik,  
Bijtë e arbërit me gjak të pashpristë”.*

### Me Mikelanxhelo La Lunën në Shën Mitër Koronën e De Radës

Në mesditën e 29 korrikut 2016, “grupi” ynë ishte musafir i Mikelanxhelo La Lunës në Shën Mitër. Jemi po ata që ishim në Munxhufuni, Anja tani është gjashtë vjeçe, italiani Sergio me Xhoanën, Donika dhe unë. Mikelanxhelo quhej edhe babai edhe njëri nga djemtë e De Radës. La Luna është krenar për origjinën e tij, jo vetëm si arbëresh por edhe si bashkëfshatari i De Radës. La Luna na tregon për fshatin, historinë e tij, dhe mbi të gjitha historinë e Kolegjit të Shën







Adrianit dhe të Shën Mitër Koronës. Por më parë le të vizitojmë fshatin e lindjes së De Radës, në Maki. Fshati Maki nuk është larg nga Shën Mitri, rreth katër kilometra. Sapo hymë në fshat na shfaqet busti i De Radës, përpara Kishës. E nderojmë atë dhe hymë në rrugën me emrin "Jeronim De Rada", e cila hapet pasi lemë kishën në të djathtë dhe bustin e poetit në të majtë. Aty shohim një derë harkore që të shpie në një oborr. Është një portik oborri pa derë. Ne shohim fasadën ballore të murit të shtëpisë së De Radës. Në hyrje, në krahun e majtë gjëndet një pllakë në të cilën shkruhet në mermer të bardhë në gjuhën italiane:

***Në këtë vend në vitin 1814, ka lindur Jeronim De Rada, poeti dhe themeluesi i letërsisë shqipe. Vdiq në vitin 1903.***

Brenda oborrit të rrethuar nga shtëpitë e tjera shfaqet edhe një pllakë tjetër mermeri ku shkruhet:

***Poetit të madh shqiptaro italian, në 150-vjetorin e Lindjes, Nga populli i qytetit të tij.***

Aty gjëndet edhe guri i De Radës të cilin ai e përdorte për të hypur çdo ditë në gomarin e tij që të shkonte në Shën Mitër Koronë. Ai mbetet një shenjë e varfërisë së tij, thjeshtësisë, përunjësisë, modestisë e sot për ne e madhështisë së tij. Studjuesit e jetës së tij thonë se edhe pak kohë para se të vdiste në Manastir, ai vazhonte të shkonte dhe të jpte mësim nga Maki në Shën Mitër.

Jemi pikërisht aty ku jetoi njeriu më i rëndësishëm i letrave shqipe të deri asaj kohe. Jeronim De Rada. Tek ecën kalldrëmeve aq të pastra të atyre rrugëve të fshatit, nuk rri dot pa imagjinuar Jeronimin fëmijë tek luante, djalosh tek projektonte të ardhmen, burrë, tek ndërtonte veprën e tij të pavdekshme, plak të urtë meditativ që vuante humbjen e katër djemve të tij dhe mjerimin shpirtëror sa për familjen aq edhe për atdheun. Eh këta poetët! Mendja më shkon edhe tek Lum Lumi dhe tek Ationi! De Rada i mbylli sytë me brengën e madhe për Shqipërinë duke lënë një emër dhe trashëgimi të madhe.

Mal Berisha, Kalabri, Korrik, 2016.

*\*Ish Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Britaninë e Madhe.*





# Si e ndërtoi fazhizmi Sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë

**Ermir Hoxha**

Deri në fillim shekullin XX, Tirana e "panjohur", ishte zhvilluar "... si një udhëkryq i lidhjeve të rëndësishme territoriale, me një strukturë urbane osmane të çrregullt e të ndarë në disa miniqendra me densitet rreth xhamive."<sup>1</sup> Por me shpalljen e saj si kryeqytet në vitin 1920, nevojitej riorganizimi dhe përshtatja e saj si kryeqendër.

Pas tendencës neorinashimentale e manieriste të fillimit të viteve '30, në zhvillimet arkitektonike të mëvonshme do të zhvillohej gjuha e racionalizmit monumental përfaqësuar nga Gherardo Bosio (1903-1941). Prej vitit 1939, deri në kapitullimin e Italisë, (1943) zhvillimin urbanistik e mori në dorë "Zyra Qendrore e Edilicjes dhe Urbanistikës së Shqipërisë", e cila drejtohej nga vetë Bosio. Qëllimi i Zyrës ishte të arrinte të krijonte në Shqipëri ndërtimet më të mira e më harmonike, në përputhje me politikën kolonianiste të Italisë fashiste. Në zyrë punohej si për projektimin urban e arkitektonik, ashtu edhe për kontrollin e mbarëvajtjes së punimeve. Planet e këtij institucioni jetëshkurtër u shtrinë në këto vite, përveç Tiranës dhe Durrësit edhe në qytetet e Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Vlorës, Gjirokastrës e Beratit. Një nga detyrat e para dhe ajo më e rëndësishmja për këtë institucion mbeti plani rregullues i Tiranës, ideuar e pjesërisht realizuar po nga G. Bosio. Planin në vetvete duhej të merrte parasysh problemin e identitetit që duhej të transmetonte,



harmoninë e tij me të kaluarën dhe të tashmen e qytetit. M. A. Giusti shprehet se: "Në këtë kuptim theksohet përballja me traditën, e ndërmjetësuar nëpërmjet një vizioni popullor të folklorit lokal, që del i qartë nga disa shënime në projekte. Tirana kish në vetvete një karakteristikë ambientale të qartë, e dukshme kjo nga kopshtet e shumtë me lule e perime, që i jepnin një pamje të gëzueshme e piktoreske. Kjo karakteristikë, e cila i atribuohet dashurisë së shqiptarit për natyrën, dhe e atij shpirti të pavarur, që nuk duron subjektivizma e stërhollime, i dedikohet dashurisë së tij për shtëpinë si simbol bashkimi, dhe e gjithë kjo nuk mund të anashkalohej nga plani rregullues."<sup>2</sup>

Planin parashikonte zhvillimin e qytetit në formë rrezore, (ashtu siç është dhe sot), duke tentuar të lidhte periferinë me qendrën nëpërmjet një sistemi të thjeshtë rrjetëzimi. Bulevardi, nyja kryesore e këtij zhvillimi, duhej të shtrihej edhe më tej drejt veriut deri tek stacioni (i sotëm) i trenit, për t'u mbyllur me kompleksin e Piazza Littorio e pas tij me parkun e gjelbër. Me këtë nyje gjigante ndërthureshin arteriet e tjera kryesore të qytetit që lidhnin zonat e ndryshme industriale, apo sportive. Vetë plani u shtri fillimisht në 500 hektarë, për t'u zgjeruar më pas në 2900 hektarë, ku përshiheshin zona ushtarake, aeroporti, zonat industriale, parqe publike e sportive, etj. Rrjetëzimi rrezor që zhvillohej

<sup>1</sup>N. D. Baldassarre, M. L'Abbate, A. B. Menghini, F. Pashako, M. Pessina, A. Vokshi. Tirana, - Piccola guida agli edifici italiani sull'asse monumentale, (Tirana, Green advertising, 2014): 15.

<sup>2</sup>M. A. Giusti. Vepër e cituar: 54.





nga qendra duhej të lidhte në formë harmonike të gjitha zonat e qytetit, ato aktuale dhe ato që do krijoheshin më pas. Kjo qendër, e njohur si sheshi "Skënderbej", shërbeu si pikë takimi e dy anëve të bulevardit. Nën drejtimin e Bosios nisi kështu ndërtimi i drejtimt jugor, njohur si "Viale dell'Impero", sot Blv. "Dëshmorët e Kombit". Bulevardi u mendua si një rrugë e gjerë që duhet të lidhte bërthamën e vjetër të qytetit me ndërtimet e reja të ri politik. Në fakt, në fund të tij, u ngritën disa ndërtesa me funksione të ndryshme administrative (edifici politici del fascio).

Në atë që sot njihet me emrin Sheshi "Nënë Tereza", nisi ndërtimi i "Casa delle Organizzazioni Giovanili", ose "Casa della Gioventù Littoria Albanese", (shkurt G. L. A. – sot Rektorati i UT-së dhe Muzeu Arkologjik), përballë saj "Casa del Opera del Dopolavoro Albanese" (shkurt O. D. A. – sot Universiteti i Arteve) dhe në qendër "Casa del Fascio", (ose "Palazzo Littorio" – sot Fakulteti Politeknik) e të gjitha këto do të rrethonin "Piazza Littorio" (sot sheshi "Nënë Tereza"). Arkitektura e secilës ndërtesë përçohet nga një monumentalitet absolut e një hapësirë skenike, dekoruar me vlera sa plastike aq dhe materiale. Në projektin e Bosios e gjithë "Piazza Littorio" duhej të përmblyhte një kompleks të tërë politik e sportiv<sup>3</sup>, si një konceptim i mirëfilltë urban, ku arkitektura dhe hapësirat, ato boshe e të plota, takohen nga uniteti i ekuilibrit të formave. Vetë ndërtesa qendrore, "Casa del Fascio", ishte emblema e ngritjes metaforike drejt vlerave të reja etike e heroike, në harmoni dhe me kodrat që rrinë në sfond. Si element i fundmë i bulevardit, Casa del Fascio karakterizohet nga monumentaliteti i rëndë strukturor, por dhe nga linjat e qarta e të kthjellëta. Në lidhje me të, Giusti shprehet se: "Palazzo Littorio, që ngrihet në qendër të aksit të Tiranës, imponohet si një fortesë veshur me tulla e me një trup të tkurrur në qendër, tekta të kujton Kullën shqiptare, ose një pallat të fortifikuar toskan. Por tulla traventine që e vesh të tërin, kornizat tek dritaret si shtëpiza mermeri të bardhë nga Carrara, tarraca e gjatë traventine, e në fund homogjeniteti material e shndërron tërë pallatin drejt kërkimit të vlerave të reja të purizmit e metafizikës." Por projektuesit italianë kishin menduar dhe

për sheshin qendror, që me formën e tij katrore, duhej të shërbente si skenë admirimi për arkitekturën e regjimit të ri. Ai duhej të përjetohej si teatër gjigant, ndjesi e stimuluar nga skema e shkallëve në gjithë ndërtesat rrethuese, trotualet dhe rruga e gjerë.

Në krah të "Casa del Fascio", u ngrit në vitin 1942, "Casa dell'Opera del Dopolavoro Albanese" (O.D.A). Për të, Bosio preferon linjat arkitektonike të thjeshta, që zhvillohen në një plan të vetëm në pjesën ballore, një hyrje "modeste" me katër kolona, e një sipërfaqe të ftohtë mermeri, që sjell një strukturë monumentale racionale. Përballë saj u ngrit "Casa delle Organizzazioni Giovanili", njohur ndryshe dhe si "Casa della Gioventù Littoria Albanese" (GLA), një strukturë shumë më e lehtë, e cila mundësonte në sajë të hapësirave lidhjen e "Piazza Littorio" dhe sheshit përballë stadiumit olimpiq. Forma "U", e strukturës bën të mundur shpërndarjen e hapësirave për t'iu përshtatur multifunksionalitetit të ndërtesës. Vetë projekti përfshinte dy ballina, respektivisht në dy sheshet e sipërpërmendur. Pjesa e pasme e ndërtesës ofron një zgjidhje hapësirorë të veçantë, si një shesh brenda sheshit, rrethuar me arkadë dhe pjesërisht me një ballkon të gjatë që ndjek strukturën.

Përgjatë gjithë bulevardit ishte menduar të ngriheshin një seri ndërtimesh si teatri, hoteli, Uffici Lougotenza, Commando Truppe, posta etj. Një pjesë e tyre u ngritën dhe ekzistojnë dhe sot.

Një tjetër ndërtim i rëndësishëm pjesë integrale e këtij aksi ishte dhe stadiumi, i cili finalizonte dhe tërë projektin e Viale dell'Impero. Stadiumi i cili u projektua po nga Bosio, përfundoi vetëm në vitin 1946 (nga Ing. I. Tërshana) edhe pse projektet e para datonin që në mesin e viteve '20. Për të propaganduar kompleksin e ri olimpiq, ku duhet të spikasnin vlerat, forca dhe guximi i rinisë së re fashiste, si bazë etike e regjimit të ri, Bosio parashikoi për ndërtesën një hyrje monumentale, me shkallë të gjera e relieve skulpturore. E gjithë struktura duhej të vishej me elementë të rregullta prej mermeri, për t'i dhënë së tërës një karakter madhështor.

<sup>3</sup>Sipas shtypit të kohës, "Piazza Littorio" kishte për qëllim të edukonte e stërviste rininë fashiste, ndryshe dhe larg nga kompleksi ministerial ku qëndronte aparati shtetëror.



# Turizmi, sektori që po njuh vetëm rritje

## Turizmi botëror u rrit me 4% në 6 muajt e parë të 2016

4 përqind është rritja e numrit të turistëve në nivel botëror për periudhën Janar-Qershor 2016. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO) destinacione të ndryshme turistike priten 561 milionë vizitorë, ose 21 milionë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Në komunikatën e UNWTO citohet sekretari i përgjithshëm Taleb Rifai, sipas të cilit "Turizmi po dëshkohet si një nga sektorët më të qendrueshëm, duke krijuar vende pune për miliona njerëz, në kohën kur punësimi është sfidë. Turizmi gjithashtu po zbeh kufijtë mes kombeve dhe steriotipet, duke luftuar frikën dhe mosbesimin reciprok. Meqenëse siguria është një nga kushtet kryesore për zhvillimin e turizmit, është e domosdoshme hartimi i një paketet ligjesh të qendrueshëm."

Sa i takon Europës si kontinent, numri i turistëve për periudhën Janar - Qershor 2016 u rrit me 3%.

Mirëpo e ndarë në zona, ajo Veriore, Qendrore dhe Lindore patën rritje prej rreth 5% të numrit të turistëve, ndërsa Europa Perëndimore u rrit me vetëm 1%, ndërsa në pjesën Jugore rritja ishte 2%.

Sipas UNWTO, meqë në këtë periudhë të vitit realizohen gati gjysma e udhëtimeve (46%), edhe prishmëria për gjashtëmuajorin e dytë është pozitive.

Kështu, priten rritje të mëdha për Afrikën, Amerikën dhe Azinë, por kjo nuk mund të thuhet edhe për Europën dhe Paqësorin.

Si tregu më i madh turistik në botë, Kina ka një rritje galopante me mbi 20% në tremujorin e parë të këtij viti.

Në vend të dytë, SHBA shënoi rritje me 8%, e më pas Gjermania me 4%.

Zonat të tjera ku u rrit fuqishëm numri i turistëve gjatë kësaj periudhe janë: Spanja me 20%, Norvegjia me 11%, Australia me 10 etj.





Sa i takon shepnzimeve, për shkak të gjendjes jo të mirë ekonomike, Rusia dhe Brazili kanë bilancet më të dobëta.

Ndër vendet fqinje me Shqipërinë, sipas Entit Shtetëror të Statistikave, gjatë periudhës Janar-Gusht, Maqedoninë e kanë vizituar 617.150 turistë, ose 4.1% më shumë se një vit më parë, duke realizuar 1.929.279 netëqëndrime, ose 1.8% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë. Mirëpo sipas të njëjtit Ent, muaji Gusht ka rezultuar me një rënie prej 7.9% të numrit të turistëve e me gati 4% të netëqëndrimeve dhe të ardhurave.

Nga ana tjetër, nga Maqedonia në Greqi, gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti kanë shkuar për turizëm mbi gjysë milioni qytetarë, duke shpenzuar në tokën helene 59 milionë euro.

Megjithë këtë numër të madh turistësh nga Maqedonia, por sidomos nga Gjermania, Britania e Madhe dhe Bullgaria, vetë Greqia ka pranuar ulje të ndjeshme të numrit të turistëve të huaj me 4.9% në krahasim me një vit më parë. Më e madhe ka qenë kjo rënie për Turqinë, e cila ka deklaruar 30% më pak të ardhura nga turizmi brenda 6-mujorit të parë të këtij viti, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Megjithatë, në total, të ardhurat nga turizmi në Turqi, për tremujorin e tretë të këtij viti janë 8.277.000.000 dollarë, nga të cilat mbi 6.7 miliardë janë shpenzime individuale dhe 1.6 miliardë janë përmes paketave turistike. Sipas Institutit turk të Statistikave 72% të ardhurave nga turizmi janë nga të huajt, ndërsa 28% nga pushimet e emigrantëve.

Ndërkaq, gjatë sezonit veror, vetëm nga Polonia, Shqipërinë e kanë vizituar 45.000 vizitorë, çka përbën një rritje me 10% në raport me vitin 2015. Sipas agjencive turistike polake dhe shqiptare, turistët kanë ardhur përmes fluturimit të 4 avionëve charter në javë, ndërsa vitin e ardhshëm parashikohet që ky numër të shkojë në 10 fluturime në javë, për kretë sezonin.







# Ukraina,

porta e një tregu të mundshëm  
turistik dhjetëra milionësh

Tatjana Bajraktari  
Aler Travel



Me një popullsi prej 42 milionë banorësh, Ukraina mund të jetë një treg i mirë për turizmin shqiptar. Provat e para të këtij tregu janë dëshmuar që prej më shumë se 10 vitesh, kur turistët e parë ukrainas, të organizuar përmes agjencive turistike shqiptare dhe ukrainase, erdhën në Shqipëri, fillimisht përmes avionëve charter të ulur në pistat e aeroportit të Tivatit në Malin e Zi. Sigurisht që individë nga Ukraina kishin ardhur edhe më herët për turizëm në Shqipëri, por vitet 2013-2014 ishin të parat që shënuan ardhjen e organizuar të turistëve ukrainas në Shqipëri. Vetëm një vit më vonë, më 25 Qershor 2015, në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” të Rinanit

u ul charteri i parë me turistë drejt e nga Kievi. Falë agjencisë turistike Aler Travel, kryeqyteti me gati 3 milionë banorë i Ukrainës është bërë tashmë një pikë reference jo vetëm për turistët ukrainas, por edhe për turistë të shumtë nga disa vende fqinje me të, si Rusia, Kazakistani, Bjellorusia etj. Në të vërtetë, do të ishte i paimagjinueshëm zbakimi në plazhet shqiptare i turistëve nga të gjitha këta vende, që në total kanë një popullsi prej mbi 2010 milionë banorësh, pra një numër turistësh potencialë prej dhjetëra milionësh. Mirëpo kjo gjë nuk është aspak e lehtë, për shkak se ata dinë fare pak për Shqipërinë dhe për ofertën e saj turistike, për të mos folur për ata që janë








të keqinformuar për Shqipërinë. Kjo është arsyeja që Aler Travel prej vitesh po vazhdon fushatën e informimit të këtij publiku për Shqipërinë dhe turizmin shqiptar. Agjencisë i është dashur që fillimisht të studiojë ofertën turistike në Shqipëri e më pas ta promovojë atë në shtetet e mësipërme, edhe përmes bashkëpunimit me agjenci të tjera turistike, kryesisht në vendet rusishtfolëse, me të cilat ekziston tashmë një partneritet i qëndrueshëm me përfitime reciproke.

Rritja e numrit të turistëve nga Ukraina apo të nisur nga Ukraina ishte më e dukshme gjatë sezonit veror të këtij viti. Me uljen 3 charterave gjatë këtij sezoni, në Shqipëri erdhën 1500 turistë, ose tre herë më shumë se një vit më parë. Ndërkaq, agjencia ka planifikuar që gjatë sezonit të ardhshëm turistikë të sjellë në Shqipëri 6 chartera, çka do të thotë dyfishim i numrit të sivjetëm të numrit të turistëve, por edhe gjeografi më e larmishme. Aler Travel po punon që avionët të mos marrin fluturimin vetëm nga Kievi, por edhe nga qytete të tjera të Ukrainës, si dhe nga ndonjë prej shteteve rusishtfolëse të sipërpërmendura.

Mirëpo si çdo industri, edhe turizmi kërkon punë zinxhir, që nga studimi i tregut, identifikimi i ofertës turistike të përshtatshme për tregjet specifike, krijimi i paketave turistike, promovimi i kësaj oferte, organizimi i fluturimeve, por edhe akomodimi i tyre në kushte sa më komode. Për këtë arsye, Aler Travel e ka zgjeruar edhe më aktivitetin e vet si agjenci turistike në Shqipëri, duke marrë në menaxhim hotelet për pushuesit. Shembulli i mirë i menaxhimit me sukses të Aler Hotel në Sarandë gjatë sezonit të 2016, e ka çuar agjencinë në studimin e mundësive për të marrë më shumë hotete në menaxhim në sezonet e ardhshme turisike, me synimin që në një të ardhme të afërt, të krijojë rrjetin Aler Hotel përgjatë gjithë bregdetit shqiptar.





## Shkëlzen Rexha dominon në mesin e fituesve të Wiki Loves Monuments

Shkëlzen Rexha dominoi në mesin e 58 garuesve nga Shqipëria dhe Kosova në edicionin e tretë të konkursit të fotografisë Wiki Loves Monuments, qëllimi i të cilit ishte mbledhja e fotove të monumenteve për Enciklopedinë Wikipedia.

Rexha ishte në mesin e fituesve në Shqipëri dhe Kosovë, krahas Arben Llapashticës, Ardian Lumit, Milot Krasniqit, Lars Haefner etj.

Konkursi zgjati dy muaj dhe fitues për Kosovën ishin Arben Llapashtica me Balsamariumin e Ulpianës, Shkëlzen Rexha me Muzeun Etnologjik në Gjakovë dhe Ardian Lumi me Muzeun Etnologjik në Prishtinë. Ndërsa në Shqipëri, për fotografitë e monumenteve të mbrojtura, fitues doli sërish Shkëlzen Rexha, si dhe Lars Haefner.

Përveç mbështetjes nga ana e Fondacionit Wikimedia, në Shqipëri konkursi u mbështet nga Open Labs, ndërsa në Kosovë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve 10 fotot fituese të Shqipërisë dhe 10 të Kosovës do të konkurrojnë në garën ndërkombëtare të Wikipedias.



# RRËFEN FOTOGRAFI GJAKOVAR Do t'ia jepja unë e harmonisë fet

## Irhan Jubica

Mijëra çaste të fiksuara në celuloid, qindra bashkëpunime me median e shkruar dhe elektronike, dhjetëra ekspozita personale dhe kolektive në shumë vende të botës, e kanë bërë atë jo vetëm dëshmitar të ngjarjeve të mëdha historike në Kosovë e Shqipëri, por edhe një simbol të vërtetë të fotografisë kosovare. I kudondodhur prej gati 50 vitesh, edhe Shkëlzen Rexha e kishte momentin e vet të robërisë, kur më 1999, nuk e lëshoi, por e dokumentoi Gjakovën e martirizuar nga agresioni serb. Sepse fotografia është gjithçka për të. Është vetë jeta.

Në këtë intervistë për Travel, bashkëpunëtori ynë i kahershëm për të cilin kolegu Ilirjan Gjika ka shkruar në numrin 8 të revistës, e pranon me çiltërsi dëshirën për t'ia dhuruar personalisht foton e harmonisë së qytetit të tij Papa Françeskut, ndërsa tregon edhe planet e afërme për një ekspozitë me fotografi artistike.

◀ Harmoni kulturore dhe fetare në Gjakovë  
Foto: Shkëlzen Rexha







SHKËLZEN REXHA

# Papës fotografinë are në Gjakovë

**Z. Rexha! Pas gati 5 dekadash punë, ju jeni bërë tashmë simbol i fotografisë kosovare. A është kjo ajo çka ju keni dashur në jetë?**

Sigurisht që po. Ky është synimi i çdo artisti, e gjithsesi edhe i secilit fotograf. Padyshim edhe unë e kam ëndërruar dhe gjithnjë kam patur dëshirë që me punë dhe angazhim të arrij deri te majat e suksesit.

**Duke ju uruar për çmimin Wiki Loves Monuments që morët kohët e fundit: A**

**do të thotë kjo se ju do t'i përkushtoheni edhe më shumë dokumentimit të trashëgimisë kulturore e shpirtërore shqiptare?**

I jam qasur që nga mosha rinore dhe nuk do t'i ndahem dokumentimit të trashëgimisë sonë kulturore e shpirtërore deri ne frymën time të fundit. Mbase këtë e ndjej edhe si obligim personal, duke patur parasysh se bazën për këtë unë e kam trashëguar nga qyteti im Gjakova, një qytet-muze, që mbart mbi supë një

trashëgimi tejet të pasur kulturore dhe shpirtërore.

**Fotografitë tuaja janë tepër realiste dhe dallohen për nga vërtetësia që përcjellin te publiku. Përveç dokumentimit të ngjarjeve dhe personazheve të rëndësishme të anës më të bukur të botës shqiptare, fotografia e mirëfilltë artistike ka munguar në ekspozitat tuaja të shumta tematike. Apo i takon publikut ta hulumtojë me më shumë vëmendje punën tuaj?**



Portret plaku  
Foto: Shkëlzen Rexha ▲


Një frëngji mbi të shkuarën  
Foto: Shkëlzen Rexha ■

Gjakova e shkatërruar nga lufta  
Foto: Shkëlzen Rexha ▲

Në faqen tjetër:  
14 Qershor 1999. Çlirimi i Gjakovës  
Foto: Shkëlzen Rexha ★

## THE STORY OF KOSOVAN PHOTO

# I would like picture of r



Jo, unë kam realizuar shumë fotografi artistike me vlera të larta, me të cilat kam marrë pjesë në shumë ekspozita me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Madje në disa prej këtyre ekspozitave jam shpërblyer edhe me çmime.

Nga ana tjetër, fotografitë e mia realiste i publikoj më shumë në rrjetet sociale ndoshta edhe sepse ato janë më të ndjekura nga publiku i gjerë. Megjithatë, së shpejti shpresoj të hap ekspozitën personale të radhës, me fotografi artistike të realizuara këto vitet e fundit.

**Në punët tuaja mbizotëron peizazhi dhe objektet, ndërsa njeriu është pak i pranishëm si subjekt. E keni zgjedhur këtë si më pak të eksploruari, apo se zbërthimi i karakterit të një subjekti në lëvizje - si njeriu - nuk është aspak i lehtë?**

Pikërisht sepse nuk është sa duhet i eksploruar, por mbase edhe sepse dua që t'ia jap publikut të gjerë mundësinë që së pari të shijojë bukuritë natyrore dhe të objekteve të tjera, e më pas, pse jo edhe të karakterit të subjektit që ndodhet afër.

**Jeni një ndër fotografët më prodhimtarë edhe në Shqipëri, duke mos munguar në asnjë ngjarje të madhe. Si e përballon një artist sot koston e pasionit?**

Shumë vështirë duke ditur se ky profesion imi, pos që është i lodhshëm edhe kush-ton. Por pasioni për fotografi është më i madh se munda, buxheti dhe lodhja. Fotografia është vetë jeta ime. Është ajo që mban gjallë shpirtin tim.

**Sa ndjeheni i plotësuar nga vlerësimet zyrtare që keni marrë gjatë karrierës?**

Kuptohet që çdo sukses dhe mirënjohje që marr nga të tjerët për punën time, do të thotë shumë dhe më bën të kënaqur. Por si çdo qenie njerëzore, edhe unë pres suksese dhe mirënjohje të reja, pasi për këtë edhe kam punuar fort gjatë tërë jetës.

**A do t'ja dhuronit ju vetë foton e harmon-**

**isë fetare e kulturore të Gjakovës Papa Françeskut?**

Sigurisht që do të doja t'ia dhuroja vetë foton në fjalë Papa Françeskut, por shpesh rrethanat e pamundësojnë këtë, e mbase edhe protokollin e dikton këtë.

**Sa ka qenë e vështirë për artistin që vjen nga qyteti më i martirizuar i luftës, dokumentimi i tragjedisë kosovare në fund të viteve '90?**

Ka qenë tejet e vështirë, sepse gjatë tërë kohës kur kryhej ai gjenocid i paparë ndaj popullit tonë, e në veçanti ndaj popullit të Gjakovës, unë bashkë me familjen kam qëndruar në qytetin tim, duke përjetuar krimet barbare nga forcat serbe. Kjo tragjedi dhe kjo dhimbje shtohet edhe shumë, kur dihet se unë jam autor i shumë fotografive të krimeve të luftës, të bëra nga ushtria, policia e paramilitaret serbë ndaj popullit të pafajshëm në Kosovë. Gjakova është qyteti që më së shumti ka vuajtur nga lufta e fundit, qyteti me më së shumti viktimë, por edhe me më shumti luftëtarë të lirisë.

**Sa të ngjashme dhe sa të ndryshme janë realitetet shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi?**

Nuk ka edhe aq shumë ndryshime. Janë disa detaje - dallime të vogla, që vetëm syri ynë prej artisti - fotografi mund t'i dallojë. Kjo është edhe magjia e artit të fotografisë, e shkrepjes, ku mjafton vetëm një sekondë dhe e tërë bukuria e objektit apo e subjektit shfaqet para teje.

**Nëse do t'ju kërkohet të zgjidhni fotografinë që ju përfaqëson juve personalisht, cila do të ishte ajo?**

Kjo është sikur të pyesësh secilin prind, se cilin prej fëmijëve e do më së shumti. Ka shumë të tilla, për këtë edhe e kam shumë vështirë ta veçoj ndonjërin. I mbetet të tjerëve - publikut ta zgjedhë dhe ta vlerësojë më të mirën.

**Mr. Rexha! After about five decades of work, you're now a symbol of Kosovo's photography. Is this what you wanted to be?**

Of course yes. This is the aim of every artist, and of every photographer as well. I forever dreamed and I have had the desire to work and achieve commitment to the peaks of success.

**Wishing for Wiki Loves Monuments Award you received recently: Does this mean that you will devote even more to record Albanian cultural and religious heritage?**

I am approaching that since my youth, and I will not quit documenting our cultural and spiritual heritage until my last breath. Perhaps I feel this as a personal responsibility, given that the basis for this I have inherited from my hometown Gjakova, a city-museum that bears a very rich cultural and spiritual heritage.

**Your pictures are incredibly realistic and distinguished from that convey the truth to the public. In addition to documenting important events and characters of the most beautiful side of the Albanian world, genuine artistic photography lacked in your many thematic exhibits. It belongs to the public to explore more attention to your work?**

No, I have realized many artistic pictures with higher values, with which I have participated in many exhibitions of national and international character. In some of these exhibits I am rewarded with prizes.

On the other hand, I publish my realistic pictures in social networks perhaps because they are followed by the general public. However, soon I hope the next step will be a personal exhibition with artistic photography realized in recent years.

**Your pictures prevailing by the landscape and facilities, while the man is less present as a subject. You choose this genre as less covered, or because the composition of the character of a subject in motion - a man - is not easy?**

Precisely because it is not sufficiently explored, but perhaps also because I want to give the general public the opportunity first to enjoy the natural beauties and amenities, then why



PHOTOGRAPHER SHKËLZEN REXHA

# to give Pope Francis religious harmony in Gjakova

Thousands of moments fixed in celluloid, hundreds of collaborations with the print and electronic media, dozens of personal and collective exhibitions in many countries have made him not only a witness of great historical events in Kosovo and Albania, but also a real symbol of the Kosovo photography. The omnipresent for almost 50 years, even Shkëlzen Rexha himself had its moment of captivity, when in 1999, he didn't leave the city, but recorded Gjakova martyred

by Serbian aggression. Because photography is everything for him. Is the life himself.

In this interview for Travel, our longtime contributor to whom my colleague Ilirijan Gjika wrote in number 8 of the magazine, wholeheartedly agrees his desire to donate personally Pope Francis the picture of the harmony of his city, and shows relative plans to an exhibition of artistic pictures.

not, the character of the subject that is in it.

**You're one of the most productive photographers even in Albania, not lacking in any great event. How does it cost the artist's passion today?**

Very hard knowing that my profession is tedious and costly. But passion for photography is greater than torment, than the budget and fatigue. Photography is my own life. It's what keeps my spirit alive.

**How you feel fulfilled by official estimates you received during your career?**

It is understood that every success and gratitude I receive from others about my work, means a lot and makes me happy. But like any human being, me too look forward to new successes and gratitude.

**Would you give to Pope Francis the picture of religious and cultural harmony of Gjakova?**

Of course I would like to give personally to Pope Francis this picture, but often circumstances prevent this, and perhaps the protocol dictates.

**It has been difficult for the artist who comes from the most martyred city by the war, documenting the tragedy of Kosovo in the late 90s?**

It has been very difficult, because all the time when this accomplished the unprecedented genocide against our people, especially against the people of Gjakova, I stayed with my family in my hometown, experiencing barbaric crimes by Serbian forces. To this tragedy is added more pain, knowing that I am the author of many photos of war crimes, made by the army, police and paramilitary forces against the innocent people in Kosovo. Gjakova is the city that has suffered most from the war, the city with the most victims, but also with most freedom fighters.

**How similar and how different are Albanian realities in Albania, Kosovo, Macedonia and Montenegro?**

There is not much change. There are some details - small differences, that only our eye as the artist and photographer may differ. This is the magic of the art of photography, shooting, where it only takes a second and the whole beauty of the object or subject appears before you.

**If you are asked to select one picture that represent you personally, which would it be?**

This is like asking parents which child loves more. There are many such, and for this I can't disentangle any of them. I left to others - the public - to select and evaluate the best.

Irhan Jubica





# NGRIHET QENDRA MULTIFUNKSIONALE NË TAMARË

Infrastruktura që nga viti në vit përmirësohen, shërbime turistike që zhvillohen duke vlerësuar traditën dhe duke menduar për mirëqenien e vizitorëve, produkte që kanë më shumë dukshmëri në treg dhe që kanë filluar të identifikohen gjithnjë e më shumë me zonat e mahnitshme nga të cilat vijnë.... Kelmendi dhe me të e gjithë Malësia e Madhe po konfirmohen si një destinacion i ri turistik çdo ditë e më shumë.

Është edhe për këtë arsye që në kuadër të projektit "Bukë, Kripë e Zemër", zbatuar nga VIS në Malësi të Madhe dhe financuar nga Kooperacioni Italian për Zhvillim, u synua ristrukturimi i godinës së Njësisë Administrative në Kelmend, pjesë përbërëse e sheshit të pedonale në fshatin Tamarë.

Qendra e këtij fshati, sa tërheqës tanimë edhe lehtësisht i arritshëm falë rrugës së ndërtuar së fundmi me një panoramë mbresëlënëse, ishte qëllimi i projektit të rilindjes urbane zbatuar nga qeveria shqiptare përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit, godinat e së cilës u ristrukturuan me qëllimin për të krijuar një model të qëndrueshëm të fshatit malor, duke nxitur edhe aktivitetin e tij ekonomik.

Godina që ka brenda saj zyrat e njësisë administrative nuk ishte e përfshirë në një projekt të tillë, duke e bërë kështu në një farë mënyre të paplotësuar sheshin nga këndvështrimi i një vizitori kureshtar. Lindi kështu ideja për ta ristrukturuar, si për t'i ofruar zyra më të përshtatshme administratës publike, ashtu edhe për t'i kushtuar pjesë të hapësirave të disponueshme një Qendre të re Multifunkionale (bazuar në partneritet mes aktorëve të ndryshëm në vend) për vlerësimin e territorit. Një strukturë e tillë favorizon veprime marketingu dhe promovimi të trashëgimisë së jashtëzakonshme që ka zona nga pikëpamja e peizazhit, natyrës, enogastronomisë, historisë dhe kulturës, me të cilat Malësia e Madhe është tërësisht e plotësuar.

Kjo qendër është e pajisur edhe me Zyrën

28

e Informacionit turistik, në të cilën personeli i kualifikuar mund të drejtojë dhe të shoqërojë turistët për të kaluar pushime bazuar në kërkesat e tyre, duke ofruar gjithashtu materiale informative, të cilat përditësohen në vazhdimësi për sa i përket shërbimeve turistike dhe aktiviteteve që mund të kryhen. Qendra do t'u bëjë të mundur gjithashtu subjekteve të veçantë të zinxhirit agro-turistik të paraqiten në treg në mënyrë të dukshme, të bashkërenduar dhe në sinergji dhe do të kontribuojë në rritjen e standardit cilësor të proceseve prodhuese në sektorin agro-ushqimor dhe të ofrimit të shërbimeve në sektorin turistik, duke shmangur në këtë mënyrë cilësinë e pabarabartë të ofertës.

Përveç kësaj prania e një konsorciumi vendor si "Fryma e Kelmendit", selia e të cilit ndodhet pikërisht pranë kësaj qendre, është shembull dhe pikë referimi për zonat e tjera të rajonit, në të cilat shoqatat vendore dhe ndërluginore do të kenë mundësinë të zhvillohen me mbështetjen e duhur. Ceremonia e përrimit të qendrës u zhvillua më datë 10 tetor, në prani të kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe – Tonin Marinaj, të drejtorit të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim – Andrea Senatori, koordinitorit të projektit të VIS - Pier Paolo Ambrosi, dhe të përfaqësuesve të administratave dhe komuniteteve vendore, dhe përfituesve të shumtë të projektit. Eventi dëshmoi një pjesëmarrje bazuar në një frymë miqësore mes të pranishmëve. Në fjalën e tij Z. Senatori e vuri theksin se si prania e qëndrueshme e një OJQ-je në një territor bën të mundur maturimin e një njohjeje të thellë të kontekstit të tij social, ekonomik, kulturor dhe politiko-institucional, duke krijuar raporte të forta besimi dhe bashkëpunimi me komunitete, administrata e ente vendore, të njohura si bashkëbisedues të çmuar në përcaktimin dhe realizimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit vendor.

Për ta përmbyllur këtë moment dhe me urimin e mirë për mbarëvajtjen e qendrës dhe të angazhimeve që e presin, Anton Prenga i "Mrizi i Zanave" përgatiti për të ftuarit një menu me gatesa vendore të Kelmendit, të paraqitura me mjeshtëri e thjeshtësi pranë restorantit Bukë, Kripë e Zemër.



#### KONTAKTE:

VIS Albania; [vis.nordalb@gmail.com](mailto:vis.nordalb@gmail.com)  
Fb: VIS Albania

Tourist Information Office Tamarë +355 69 91 98 065; info@kelmend-shkrel.org; www.kelmend-shkrel.org; facebook: kelmendshkrel  
Tourist Information Office – Dedaj +355 67 411 3458; +355 68 457 5666; njesiashkrel@gmail.com



## 29-30 Shtator Zhvillimi i Turizmit në Zonat e Mbrojtura

"Zhvillimi i Turizmit në Zonat e Mbrojtura" ishte konferenca e mbajtur në Shkodër më 29 - 30 Shtator 2016, organizuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) me mbështetjen e Natural.



## 30 Shtator Përrurimi i Qendrës për Vizitorë në Velipojë

U përrurua në Velipojë Qendra për Vizitorët, e cila synon mbështetjen për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Zonën e Mbrojtur të Lumit Buna, promovimin e vlerave të Parkut, si dhe ofrimin e një hapësire për edukimin e të rinjve.

## 2-15 Tetor

### Takohemi për një libër

Fushata kombëtare e leximit "Takohemi për një libër", e organizuar nga Ministria e Kulturës, u shoqërua me një seri aktivitesh, të përqendruara kryesisht në kryeqytetin Tiranë. Fushata kishte edhe disa çmime, si "Little Free Library në Shqipëri" dhe "AlbFotoBook Nisma në rrjetet sociale: Facebook, Twitter, me hashtagun #AlbFotoBook dhe @Takohemipërnjëlibër, që konsiston në fotografimin e librit dhe të personave që lexojnë në vende të ndryshme publike.



## Tetor

Pas hapjes së qendrave të vizitorëve në Velipojë dhe në Shebenik-Jabllanicë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura po punon për ndërtimin e një qendre të tillë edhe në Parkun Kombëtar të Thethit.



## 27 Tetor - 10 Nëntor Ekspozita Në Kosovë me dashuri

Për Ditën Kombëtare të Cekisë, Ambasada e këtij shteti në Prishtinë hapi ekspozitën me 32 fotografi bardhezi me titullin: "Në Kosovë me dashuri", nga autori Albert Pich, e që ilustron përditshmërinë e vërtetë të jetës në Prishtinë dhe në vendbanime të tjera në Kosovë.

## 29 Tetor

"Shkodra, familja ime, biçikleta ime, historia ime" ishte titulli i ekspozitës së hapur në Muzeun Historik të Qytetit të Shkodrës me rastin e promovimit të albumit fotografik me të njëjtin titull. Në ekspozitë u paraqitën 25 fotografi, të cilat dëltin për herë të parë para publikut, si më të mirat e konkursit të shpallur nga Organizata G02 që në Gusht të këtij viti. 66 fotografiat me fokus biçikletën, bashkë me narracionin përkatës u përgjodhën nga një juri në përbërje të së cilës, përveç

organizatores Eltjana Shkrelly ishin edhe antropologu Përparim Kabo dhe studiuesi i artit Ermir Xh. Hoxha. Ishte hera e parë që përmes metodologjisë së konkurimit, familjet shkodrane hulumtuar arkivat personale dhe pranuan t'i bëjnë publike historitë, të bukura apo të dhimbshme. Prej tyre, juria zgjodhi 10 foto për albumin me 44 faqe, ndërsa për zotëruesit e 6 fotove më të mira u dhanë çertifikata dhe çmime.

Ceremonia u hap me një homazh për ish-deputetin Gilman Bakalli, një ndër pedalesit më të njohur të Shkodrës, ndërsa fotografia e tij, ishte e vëmtej me ngjyra në këtë ekspozitë, që pas prezantimit edhe në Universitetin e Shkodrës dhe në disa institucione të tjera publike, do të hapet edhe në Tiranë, në fillim të vitit të ardhshëm.

Si aktiviteti përmblyllës i Ditës së Biçikletave, ekspozita u vizitua edhe nga kryetarja e Bashkisë.



## 29 Tetor

Në Valbonë, më 29 Tetor u mbajt koncerti-protestë kundër ndërtimit të hidrocentraleve në këtë sit të famshëm turistik.

Përveç aktivistëve të shoqërisë civile, banorëve vendas dhe disa figurave politike, në koncert morën pjesë edhe këngëtarët Elina Duni dhe Eda Zari.



## 4-9 Nëntor

Agjencia Kombëtare e Turizmit si dhe disa operatorë turistikë përfaqësuan Shqipërinë në panairin më të rëndësishëm të turizmit botëror në Londër, World Travel Market 2016. Në panair morën pjesë mbi 50 mijë ekspozues nga 182 vende të botës.

## 8 Nëntor

Në kuadër të World Travel Market 2016, turizmi shqiptar u promovua edhe në Dhomën e Lordëve të Parlamentit Britanik në Londër.

Në këtë prezantim të organuar falë kontributit disavejeçar të Dhomës së tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Britani e Madhe, ishte e pranishme edhe ministria Milva Ekonomi.



## 10 Nëntor

Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Milva Ekonomi ka marrë pjesë në Samitin Botëror të Ministrave të Turizmit, të organizuar nga Organizata Botërore e Turizmit në Londër, ku ishin të pranishëm përfaqësues nga rreth 100 vende të botës.

## 9-13 Nëntor

Nga 9-13 Nëntor, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë u mbajt Panairi i 19 Ndërkombëtar i Librit, ku morën pjesë dhjetëra botues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Diaspora.



## 12-20 Nëntor

Gati 1000 punime të realizuara përgjatë 20 viteve nga fotografi Roland Tasho u ekspozuan paralelisht në Galerinë Kombëtare të Arteve, Muzeun Historik Kombëtar dhe Qendrën për Hapje dhe Dialog pranë Kryeministrisë. Në fotografi janë dokumentuar shqiptarët në botë, ndërsa ekspozita me titull "Flas Shqip" u hap në kuadër të Samitit të Parë të Diasporës Shqiptare, që u mbajt nga 18-20 Nëntor po në Tiranë.

## 15 Nëntor

Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Milva Ekonomi ka diskutuar në një takim të përbashkët me Unionin Turistik Shqiptar (UTSH), masat që duhen marrë për sezonin e ri turistik në Shqipëri.

Revista Travel u përfaqësua në këtë takim nga Koordinatorja e Përgjithshme Flora Xhemani Baba, ndërsa kryetari i UTSH-së tha se vitin e ardhshëm pritet një rritje e numrit të turistëve me rreth 30%.

Nga ana e saj, ministria Ekonomi tha se aktet nënligjore të Ligjit të Turizmit që lidhen me vlerësimin e strukturave akomoduese, udhërrëfyesit turistikë, operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit do të ndikojnë në rritjen e numrit të turistëve në vendin tonë. Në takim u tha se krahas shfrytëzimit të aktiviteteve kulturore ndërkombëtare për promovim, aplikimit të një formulari ose aplikacioni në doganë për regjistrimin statistikor për turistët, ka ardhur koha për hapjen e një kanali televiziv shqiptar Travel.



## 16 Nëntor

Banka Botërore i dha Shqipërisë një financim prej 71 milionë dollarësh për Projektin e Menaxhimit të Integruar Urban dhe Turizmit. Projekti i fokusuar në 4 qendra e Jugut të vendit, tre prej të cilave pasuri e UNESCO-s, Gjirokastrë, Berat e Sarandë si dhe në Përmjet, synon të ndihmojë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e ekonomisë lokale. Projekti shtrihet në një zonë të populluar nga 84.000 banorë ndërkohë që Jugu i Shqipërisë llogaritet të vizitohet nga 300.000 turistë në vit. Aktivitetet e projektit do të përfshijnë përmirësimet urbane dhe infrastrukturore, restaurim të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e produkteve dhe tregut turistik.

Përmes lidhjes me sektorë të tjerë, turizmi kontribon me një të pestën në aktivitetin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës në vend, ndërkohë që pesha e tij direkte në Prodhimin e Brendshëm Bruto ishte 5.9 përqind në 2014. Aktualisht turizmi mbështet 50.000 vende pune - një numër që pritet të rritet në 200.000 në 2025. Megjithatë, infrastruktura urbane e papërshtatshme, mungesa e koordinimit të tregjeve lokale dhe rajonale dhe sezonaliteti i shkurtër i aktivitetit turistik përbëjnë sfida serioze.

"Investimet e projektit do t'i bëjnë më tërheqëse këto katër bashki për vizitorët dhe investitorët privatë, si dhe do të rrisin mundësitë e njerëzve për të gjeneruar të ardhura. Përfutjesit kryesorë janë banorët e këtyre bashkive dhe turistët, të cilët do të përfitojnë në mënyrë direkte nga shërbimet e përmirësuara të infrastrukturës urbane dhe ato turistike," - thuhet në deklaratën zyrtare të Bankës Botërore.

## 16 Nëntor

Komisioni Europian vendosi që udhëtarët nga 60 vende të botës, të cilëve nuk u duhet vizë për të hyrë në shtetet e Bashkimit Europian, do të takohen me nga 5 euro sa herë që vizitojnë vendet e BE-së për qëllime turizmi.







# Çfarë ndodhi në TERRA MADRE - SALONE DEL GUSTO 2016



Terra Madre Salone del Gusto, një nga eventet më të rëndësishëm ndërkombëtar kushtuar ushqimit dhe gastronomisë, protagonistët e vërtetë të të cilit janë njerëzit që kultivojnë, prodhojnë dhe gatujnë ushqimin që ne hamë, uli siparin e tij në fund të muajit shtator.

TREGU mirëpriti ekspozues nga të 5 kontinentet, duke përfshirë PRESIDET SLOW FOOD, EVENTE të ndryshëm u zhvilluan për të zbuluar pasurinë enogastronomike të botës, PROJEKSIONE KINEMATOGRAFIKE, një ENOTEKË prestigjioze, KONFERENCA të ndryshme me synimin për të zgjeruar këndvështrimet në fushën e ushqimit, FORUME të cilat iu dhanë zë KOMUNITETEVE TË USHQIMIT, pika takimi dhe shkëmbimi.

Delegacioni shqiptar ishte i përbërë nga rreth 60 persona, pjesëmarrja e të cilëve u mundësua falë projektit **ESSEDRA – financiar nga Slow Food dhe BE – dhe “Bukë, Kripë e Zemër” – financiar nga Kooperacioni Italian për Zhvillim**. VIS Albania mundësoi pjesëmarrjen e një grupi të madh delegatësh në këtë event të rëndësishëm – kushtuar ushqimit të mirë, të pastër dhe të drejtë, me synimin për të përkrahur dhe për t’iu dhënë zë prodhuesve të vegjël, produkteve të tyre unike, e dijeve tradicionale të përcuara brez pas brezi.

**Pjesëmarrje:** kjo ishte me siguri fjala që përfaqësoi më së miri këtë edicion të Terra Madre Salone del Gusto 2016 – nën temën **TË DUAM TOKEN**, që u zhvillua në zemër të Torinos nga data 22-26 shtator. Të shumtë ishin personat që vizituan eventin, me kureshtjen për të njohur produktet e ardhura nga 141 vende të botës, të tërhequr e të mahnitur nga historitë e 7000 delegatëve, pjesë e këtij eventi madhështor, me pjesëmarrës nga anembanë bota. Forumet e Terra Madre panë praninë e vizitorëve të shumtë, të cilët ndoqën me kërshtëri dëshmitë e delegatëve të ndryshëm mbi tematikat që lidhen me ushqimin, duke sjellë përvojat e vendeve të tyre. Ky event u shoqërua nga produkte, realitete, situata sociale që në të përditshmen e gjithsecilit nuk janë të

njohura. Ajo që spikati ishte prania e madhe, e vetme në botë, e komunitetit të fermerëve, që dhanë një mesazh politik shumë të fortë për të ardhmen e planetit. Vëmendja drejt biodiversitetit dhe cilësisë së ushqimit është gjithnjë e më tepër një trashëgimi e përbashkët dhe e njohur. Për të gjithë këtë, një meritë të madhe ka Slow Food, i cili me veprimet dhe zgjedhjet kërkon të konfirmojë dhe të bëjë të njohur këtë pasuri agro-ushqimore.

Delegacioni shqiptar ishte i përbërë nga prodhues vendorë, të cilët janë edhe shtylla në të cilën mbështetet filozofia Slow Food. Gama e produkteve të tyre ishte e shumëllojshme. Ata u paraqitën me produkte vendore cilësore, që kanë ruajtur traditën dhe dijet e të parëve. Veriu i Shqipërisë, duke filluar nga skaji me i epërm Kelmendi, u prezantua me djathin Mishavinë – një presid Slow Food (produkt i mbrojtur), me nënproduktet e shëgës së egër dhe boronicës, me pijet me senza dhe thanë. Duke zbritur gjeografikisht në Hot, me djathërat e veçantë me erëza e fruta të thata të prodhuara nga Alp Milk Veleçik; nga Fishta me verën e prodhuar nga varieteti vendor Kallmet, me reçelin tepër të veçantë të manit, me bukën e fikut që shkonte më së miri në shije me djathërat e Veleçikut e me Mishavinën, që dallon për shijen e tij të fortë. Nga Puka, nuk mund të mungonin reçelrat cilësorë e tepër të shijshëm dhe salca e veçantë me kërpudha, që rriten më së miri në këtë territor e që janë të njohura në të gjithë Shqipërinë. Nga Elbasani vizitorët e shumë shijuan vajin e ullirit Valmi dhe ndalnin tek shafrani i prodhuar po në këtë krahinë. Nga duarartat dibrane nuk mund të mungonin jufkat, përfaqësuese të denja të kësaj zone. Përmeti me produktet e tij të jashtëzakonshme, prodhuar me aq dashuri e mjeshtëri, u ofroi vizitorëve shijimin e glikove të ndryshme, Presid Slow Food, bimë e erëza të shumëllojshme, rakinë përmetare të rrushit e manit, e patjetër verën e mirë që të linte shijen dhe aromën të bëra një me traditën përmetare. Korça e Pogradeci me fermerët e tyre, Shoqata Kombëtare “Prodhuesit e Verës Familjare”, Ferma Amalthia përçoi përvojën e saj në përgatitjen e djathërave unikë e tepër të veçantë, në mënyrën e



përpunimit dhe shijen e jashtëzakonshme dhe një përfaqësuese e Convivium Slow Food Tirana gatoi fërgesën tradicionale për vizitorët e shumtë të standës tonë. Chef-at e Aleancës Slow Food të Kuzhinierëve, të cilët sollën për të pranishmit në seksionin e Kuzhinës së Aleancës dhe të Live show Cooking gatesat e tyre tipike, të përgatitura me mjeshtëri me produktet e stinës, e që u lanë të pranishmëve shijen e veçantë shqiptare. Drejtues agro-turizmsh të suksesshëm, që përcollën përvojën e tyre shqiptare e që vunë theksin tek produktet vendore dhe tek bashkëpunimi i ngushtë me bujqit dhe blegtorët. Kur shefat e kuzhinës dhe fermerët bashkohen, binomi i suksesit dhe i qëndrueshmërisë është i garantuar. Eventit iu bashkuan edhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, anëtarë të konviumeve Slow Food në Shqipëri, udhërrëfyes e operatorë të zryave turistike në zona rurale, që punojnë fort për të nxjerrë në pah potencialet e zonave të tyre, të rinj që kanë vendosur të punojnë në vendin ku janë lindur e rritur, për t'u bërë promotorë të zhvillimit të zonës përmes turizmit të qëndrueshëm dhe vlerësimit të territorit e produkteve të tij.

**Chef Altin Prenga** – Convivium Slow Food Fishta – Mrizi i Zanave Fishtë – Shef kuzhine i Aleancës Slow Food të Kuzhinierëve (ASFK) përfaqësoi Shqipërinë në konferencën **“Kur shefat e kuzhinës janë në anën e fermerëve”**.

«Fermerë, artizanë, kuzhinierë, të gjithë së bashku, mund të ndërtojmë një histori të re në botë” (O. Roellinger).

U mbyll me këtë urim konferenca e mbajtur në teatrin Carignano, që pati të pranishëm në një debat emrat e mëdhenj të gastronomisë botërore, si: Michel Bras, Olivier Roellinger, Altin Prenga e Cristina Bowerman.

Altin Prenga, një chef i ri shqiptar, e ka ngritur restorantin e tij “Mrizi i Zanave” në Fishtë të Lezhës, mbi një koncept të lidhur ngushtësisht me territorin, duke e bazuar mbi një rrjet prej qindra furnizuesish me lëndë të parë vendore. Një vizion që e ka shtyrë të bëhet promotor i krijimit të Aleancës Slow Food të Kuzhinierëve, një aleancë që është mbështetur dhe përkrahur fortë që në fillimet e saj edhe nga VIS Albania e Slow Food. Tema e kësaj konference trajtoi përgjegjësitë e reja të kuzhinierëve karshi sfidave të së ardhmes, vështirësitë me të cilat përballeshin prodhuesit e vegjël, humbjes që po pëson biodiversiteti ushqimor. Historitë dhe rrugëtimet e këtyre katër chef-ave janë shumë të ndryshme. Por chef-i i lindur në kohën e komunizmit në Shqipëri, vend nga i cili u largua dhe më pas u kthye, kuzhinierja italiane që ka shëtitur botën dhe ka bërë të sajat mijëra përvoja, dhe dy gjigandët e gastronomisë franceze janë dakord të nënshkruajnë një akt akuzë kundër bujqësisë që ka humbur në garën për prodhueshmëri, të ndotur nga pesticide dhe herbicide, kundër një peshkimi që ka përfunduar në duart e flotave industriale, që shkretojnë shtretërit dhe prishin rezervat e peshkut në planet. Një situatë shumë serioze dhe e rëndë që nuk lejon vonesa por kërkon veprime konkrete.

Altin Prenga është një pikë referimi për 200 fermerë të vegjël në zonën e tij dhe është duke shndërruar një ish-kamp internimi në një laborator, ku të gjithë mund të prodhojnë produktet e tyre dhe t'i shesin ato në treg.

**Chef Sokol Prenga** – Përfaqësues i ASFK në Shqipëri ishte pjesë e Kuzhinës së Aleancës nën temën **“Gastronomia e re shqiptare”**, tërhoqi të pranishmit në një udhëtim në zbulim të produkteve e gatesave tipike shqiptare. Gatesa e veçantë me shijen e pangatërrueshme të shafranit e perimeve të stinës u përgatit në bashkëpunim me **chef Naim Bashmili**. Një mundësi unike për të njohur protagonistët e gastronomisë së re shqiptare, lindur nga këmbëngulja, vullneti dhe përlësia e një brezi të rinjsh shefash kuzhine që, shpesh të kthyer pas disa vitesh përvojë përtej kufijve, kanë rijetësuar kuzhinën vendase, duke e pasuruar me receta inovative, me produkte vendore të territorit. **Chef Sokol Prenga** na udhëhoqi në një udhëtim në zbulim të produkteve dhe gatesave tipike të tokës sonë. Sokoli është një nga shefat e kuzhinës më të rëndësishëm në Shqipëri, i angazhuar që në fillimet e tij për të promovuar territorin e tij përtej kufijve kombëtarë.

**Chef Vjollca Lame** – ASFK në Shqipëri – ishte pjesë e sesioneve live show cooking. **Drita Tanazi** ishte edhe flamurtarja për Shqipërinë, e përzgjedhur nga Slow Food për të mbajtur flamurin tonë në paradën e eventit. Djathi Mishavinë dhe çaji i malit ishin përzgjedhur si produktet që do të shkëmbeheshin me një tjetër produkt të një shteti pjesëmarrës.

Kelmendi, me dy përfaqësues të tij ishte pjesë e dy forumeve të organizuara përgjatë ditëve të eventit. **Drita Tanazi** – Convivium Slow Food “Sofra e Kelmendit” dhe presidente e konsorciumit **“Fryma e Kelmendit”** solli përvojën e saj në forumin **“Të jetosh malet”**, ndërsa **Lenadër Cekaj** - u foli të pranishmëve për presidin e djathit Mishavinë, të prodhuar nga nëna e tij e nga familjet e zonës, në forumin **“Të shpëtojmë biodiversitetin e Ballkanit”**.







## “Të jetosh malet” Bujqësi, blegtori, produkte malore

Malet ruajnë ende një pasuri dhe trashëgimi të jashtëzakonshme kulturash dhe prodhimesh, por kush jeton në këto zona duhet të përballojë, në të përditshmen e tij, shumë vështirësi. Cilat janë mënyrat për të mbrojtur ata që zgjedhin të jetojnë në male dhe për të promovuar punën e brezave të rinj, që investojnë në të ardhmen e tyre në këto territore të vështira? Drita Tanazi përcolli përvojën dhe të përditshmen e saj, në një nga zonat më të thella e të bekuara me bukuri natyrore, në Kelmendin me tradita të ruajtura nga brezi në brez, me njerëz mikpritës e bujar, duke nxjerrë në pah e duke ndarë me të pranishmit veçantitë dhe potencialitetet që ka zona, si për sa i përket jetesës në male, por edhe për vlerat e produkteve vendore. “Prej vitit 2009, VIS Albania është e pranishme në Veri të Shqipërisë me projekte që synojnë zhvillimin socio-ekonomik të zonës, me në fokus përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve të Kelmendit dhe Shkrelit përmes vlerësimin të territorit dhe potencialeve natyrore e njerëzore, zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe promovimit të produkteve vendore, thesare të vërteta gastronomike e që ruajnë ende traditën e të parëve. Që në këtë vit mënyra e jetesës në këto zona ka ndryshuar shumë, nga një zonë që çdo ditë po “zbrazej” nga emigrimi, u kthye në një zonë nga e cila të rinjtë i kthyen sytë, pasi ju është kthyer ajo shpresë se “në male jetohet”. Edhe unë përpara disa vitesh kisha idenë që nëse do të më jepej rasti, e para gjë që do të bëja me jetën time, ishte të emigroja. Por sot kam krejt një ide tjetër, kam idenë që jeta më e qetë dhe e plotësuar bëhet në vendin tim, vlerat t’i jep vetëm vendi yt, e si unë tashmë, për fat, e mendojnë edhe të rinjtë e tjerë të moshës time. Qysh prej vitit 2011, VIS Albania filloi kontaktet e para me Slow Food, e cila angazhohet t’i rijapë vlerë ushqimit duke respektuar atë që e prodhon, në harmoni me mjedisin dhe ekosistemet, falë dijeve dhe traditave vendore. Bashkëpunimi mes VIS Albania dhe Slow Food i dha edhe më shumë rëndësi zonave dhe produkteve tona, duke i promovuar ato së pari në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, falë pjesëmarrjes në evente të ndryshme të Slow Food. Ajo që na bën të ndihemi krenar është se në më pak se 4 vite, kemi arritur të bëjmë identifikimin e një sërë produktesh, të cilat sot janë pjesë e katalogut të “Arkës së Shijes”, në të cilin nga Kelmendi kemi këto produkte: lëngun e shegës, mishin e thatë, mishin e skuqur, kaçimakun, bukën e misrit, troftën e egër të



Cemit, djathin Mishavinë, mazën e çapërs dhe jardunin. Në këto dy vitet e fundit u punua edhe për produktet në rrezik zhdukjeje, i cili në zonën tonë ishte djathi Mishavinë, djathë ky që këtë vit ka marrë titullin “Presid Slow Food” që do të thotë “produkt në mbrojtje”. Të flas për vendin tim, nuk arrij ta bëj në një kohë kaq të shkurtër, sepse nuk më mjafton t’i them të gjitha. Por ju bëj ftesë të gjithëve të vini e ta vizitoni Kelmendin, në Veri të Shqipërisë, sepse vetëm duke e vizituar do të arrini të kuptoni se çfarë bukurie Zoti i ka falur kësaj zone, sa cilësore janë produktet e veçanta të kësaj zone dhe se sa shumë po punohet për këtë zonë”.

## “Të shpëtojmë biodiversitetin e Ballkanit” Arka e shijes – Presidet Slow Food në Ballkan & Evropë

Në Ballkan një rrjet komunitetesh ushqimi ka identifikuar 200 produkte për t’u shpëtuar (varietete bimore, frutash e perimesh, racash dhe ushqimesh të përpunuara, të cilat janë pjesë e “Arkës së Shijes” katalogut të produkteve që rrezikojnë të zhduken, ka krijuar 6 preside (produkte të mbrojtura) dhe po eksploron potencialitete të reja, si turizmi rural. Janë rezultatet e 4 viteve punë, të realizuara falë projektit ESSEDRA (Environmentally Sustainable Socio-Economic Development of Rural Areas), financiar nga BE. Ky rrugëtim në mbrojtje të biodiversitetit dhe të dijeve vendore, u përcoll edhe nga Lenadër Çekaj, i cili shpjegoi që: “Gjatë tre viteve të fundit, prodhuesit





e djathit Mishavinë, së bashku me VIS Albania dhe me mbështetjen e Slow Food kanë punuar për të vlerësuar një produkt karakteristik, që prodhohet në dy fshatra të Veriut të Shqipërisë, dhe që gjatë viteve të fundit pak nga pak po zhdukej. Mbrojtja dhe mbajtja gjallë e traditës për prodhimin e këtij djathi të veçantë, është mundësuar përmes aftësisimit të drejtpërdrejtë të prodhuesve, si për sa i përket procesit të prodhimit ashtu edhe normave higjienike. Është punuar edhe për ta bërë më të dallueshëm dhe të njohur në treg dhe për t'i ndërgjegjësuar prodhuesit se çfarë do të thotë Slow Food dhe se sa kjo filozofi është e pranishme në të përditshmen e tyre. VIS e Slow Food kanë ndihmuar mamanë time dhe të gjitha gratë e Lepushës dhe Vermoshit për të përmirësuar punën e tyre dhe për ta vlerësuar, për të bërë të mundur vazhdimësinë e këtij produkti të veçantë edhe për brezat e ardhshëm. Duke vepruar kështu, edhe banorët e tjerë të Kelmendit kanë

filluar t'u japin rëndësinë e duhur dhe për të vlerësuar më shumë produktet tradicionale, të cilat një herë e një kohë perceptoheshin si të varfra."





# Klinika Dentare **Toti & Gurakuqi**

Eksperiencë



Profesionalizëm

Besueshmëri

• Mbi 20-vjet eksperiencë në Implantologji orale (metoda me mbjellje të dhëmbëve).

• Ortodonci (me aparate fikse dhe të lëvizshme) me mjek të specializuar të fushës.  
• Si dhe të gjitha shërbimet e tjera dentare.

*Rikthejmë buzëqeshjen tuaj...*



## *Rikthejmë buzëqeshjen tuaj!*

Ortodonci me aparate fikse dhe të lëvizshme, me mjekë të specializuar të fushës


Mbi 20 vjet eksperiencë ne Implantologji orale

(metoda me mbjellje të dhëmbëve)

Të gjitha shërbimet dentare me materiale cilësore dhe jetëgjata

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha" nr 81, Tiranë, Albania  
Tel.1: +355 4 2258 429; Tel. 2: +355 4 2249 494  
email: [almirogurakuqi@hotmail.com](mailto:almirogurakuqi@hotmail.com); [www.toti-gurakuqi.al](http://www.toti-gurakuqi.al)





**Maj 2016 - Maj 2017**

Thesare te Fjetura – Sleeping Treasures. Ekspozitë me ikona e objekte të tjerë, publikuar për herë të parë nga QKM Berat, që u atribohen mjeshtërvë ikonografë Onufri, Nikolla, Qiprioti, Çetiri dhe autorëve të tjerë anonimë, të realizuara gjatë shekullit XVI – XIX për kishat e qytetit të Beratit dhe Kalasë.



**17 Tetor - 12 Dhjetor**

Edicioni i katërt o Festivalit Ndërkombëtar Pianodrom vjen me Ditën Ndërkombëtare të Sonatave. Në datat 2, 3, 4, 5, 6, 8 dhe 12 Dhjetor në Universitetin e Arteve dhe në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, në Tiranë.

**8 Dhjetor**

E ratifikuar nga Parlamenti që në vitin 2010, Dita Kombëtare e Rinisë ka hyrë në kalendarin e festave zyrtare në Shqipëri.

**3 Tetor - Dhjetor**



Multi-Languages Cafe', mundësia që të gjithë të praktikojnë gjuhët e huaja të preferuara, që nga 3 Tetori kthehet te Qendra Rinore në Tiranë, çdo të Hënë: Anglisht, Italisht, Frengjisht, Gjermanisht, Spanjisht, Greqisht, Rusisht, Turqisht, Arabisht dhe Shqip.

**25 Dhjetor**

Krishtlindjet



**Gjatë gjithë vitit**

Pas përirimit të godinës së re në të cilën janë ekspozuar për herë të parë 250 ikona, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar në Korçë po kthehet në një nga qendrat muzeore më të rëndësishme të Shqipërisë e më gjerë. Fondi i tij ka mbi 8000 objekte kulturi e arti (ndër të cilat 6500 janë ikona) nga mesjeta e hershme deri në fillim të shek. XX, të autorëve anonimë dhe të tjerë të mirënjohur (rreth 10 mjeshttra te ikonografisë) si: Onu-



fri, Onufër Qiprioti, mësues Kostandini, Jeromonaku, Shpataraku, Selenicasi, vëllezërit Zografi etj.

**Dhjetor**

Albumi "Ismail Kadare dhe editimet" do të paraqesë të skanuara dhe të pajisura me shënime bibliografike kopertinat e të gjitha botimeve të para të Kadaresë në shqip, të cilat kanë dalë nga vëmendja e publikut për shkak të largesës kohore, por edhe kopertina të librave të përkthyer në gjuhë të huaja.



Promovimi i albumit do të bëhet në mjesditet e Bibliotekës Kombëtare, bashkëshoqëruar me një ekspozitë të shumë botimeve në gjuhë të huaja të autorit që gjenden aktualisht në Bibliotekën Kombëtare. Po ashtu, nga marrëveshja e bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë së Gjirokastrës për ri-jetëzimin e Qendrës "Shtëpia Kadare" do të zhvillohen aktivitete të tjera.

**1 Janar 2017**

Viti i Ri



**Festa e Gjelit të Detit**

"Takohe mi shtëpi në Cakran, aty ku do t'i vendosim kuroren e mbretit të shpendëve, Gjelit të Detit, këtij suksesi të fermerëve cakranjotë!"

Në vazhdim të Turit Etnokulturor të Bashkisë Fier



**Janar 2017**

Projekti më i rëndësishëm në kuadër të promovimit të vendit tonë është përfaqësimi i **Shqipërisë në Panairin e Shtutgartit si vend partner**, status ky i cili do të lejojë që vendosja në panair të jetë qëndrore dhe sytë të jenë të drejtuar drejt vendit tonë. Kjo për turizmin shqiptar do të thotë më shumë vizibilitet në tregun europian ose edhe më gjerë.





# Tirana old fashion

## Ripërtërihet Shtëpia Begeja

**Irena Kanani**  
Photo: Aurel Duka ©

E njihni rrugën e Dibrës? Është ajo rruga e famshme që djemtë e dikurshëm të Tironës i thërrisnin Broduej. Në fakt rruga e Dibrës është një prej rrugëve ende karakteristike në Tiranën e sulmuar nga kaosi i metropolit, ku mund të gjesh më shumë shtëpi të vjetra dhe bashkë me rrugët e Durrësit e të Kavajës apo edhe rrugën "Hoxha Tasim" ose "Kont Urani", mund të kthehen në një ansambël të mrekullueshëm të shtëpive të dikurshme, duke u kthyer në atraksion turistik të padiskutueshëm, për shkak të kërkesës së lartë të turistëve për të njohur identitetin e dikurshëm të kryeqytetit. Por shumica e këtyre shtëpive ose janë të braktisura e të rrënuara, ose janë tjetërsuar nga pamundësia financiare për t'i sjellë në formën e tyre të dikurshme.

Si do të dukeshin këto shtëpi nëse restauroheshin duke truejtur traditën?

Ja, sic duket tani shtëpia e Familjes Begeja, një prej familjeve më të vjetra të Tiranës, me një traditë të vjetër në biznes, qysh







prej vitit 1900 e me një trashëgimi të patundshme nga e cila spikasin edhe disa ndërtesa të vjetra tiranase. Njëra prej tyre sapo ka dalë në dritë sërish duke fituar një joshje akoma më të madhe prej shkëlqimit të detajeve.

Xhimi Begeja na thotë që kishte kohë që donte të risillte në jetë bukurinë e dikurshme të shtëpisë së madhe Begeja. Mirëpo nuk është kaq e thjeshtë ti risjellësh në jetë këto shtëpi, shumica e të cilave kanë konflikte të thella pronësie, pamundësi të mëdha financiare apo edhe njëmijë arsye të tjera për shkak të të cilave restaurimi mbetet një sfidë e vështirë. Mund të ishte zgjidhje e mirë një nxitje nga shteti me subvencionime ose me kredi të buta e afatgjata, ose me ndihmën e fondacioneve të shumta që lëvrojnë fushën e ripërtëritjes së trashëgimisë kulturore në Shqipëri. Mirëpo ai zgjodhi ta restauronte vetë shtëpinë e vjetër të familjesë madhe, për dy arsye kryesore; e para sepse sipas Xhimit, burri që është burrë, e rregullon vetë çatinë e shtëpisë së tij dhe e dyta, sepse u bënë u bënë 70 vjet qëkur dera e kësaj shtëpie u mbyll nga komunizmi, që e rrënoi familjen Begeja, duke vrarë edhe njërin prej djemve të familjes, Ymerin, vetëm 19 vjeç, histori pas së cilës nisi kalvari i gjatë i burgjeve dhe internimeve. Kishte ardhur koha që kjo shtëpi të rilindte. Shpresojmë që kjo të ndodhë në të ardhmen edhe me shtëpitë e tjera të familjes Begeja.

Në fakt në shpresojmë shumë që kjo të ndodhë edhe me shtëpitë e tjera të familjeve të vjetra tiranase, ose "tironce" siç u pëlqen atyre, sepse do të shtonin një vlerë të madhe në turizmin e trashëgimisë kulturore, duke nxjerrë në pah identitetin dhe duke u dhënë turistëve më shumë arsye për të vizituar Tiranën. Ato mund të ktheheshin në hostele ose hotele të vogla familjare dhe shëmbuj të tillë ka dhe kanë rezultuar të suksesshëm. Ruatja e elementëve të dikurshëm zgjon më shumë kureshtje tek të huajt sesa ofrimi i luksit ose standarteve të larta. Pikërisht përvoja ose prekja nga afër e këtyre elementeve, do t' u jepte atyre kënaqësinë jo vetëm të njohjes por edhe të shijimit të një periudhe të caktuar, që në këtë rast i përket shekullit të kaluar ose edhe dy shekujve të kaluar e më herët.

Le t' i urojmë Shtëpisë Begeja një jetë të dytë sa më të gjatë, e pastë sa më shumë shoqe që e ndjekin në ripërtëritjen e saj.

Ai zgjodhi ta restauronte vetë shtëpinë e vjetër të familjes së madhe, sepse sipas Xhimit, burri që është burrë, e rregullon vetë çatinë e shtëpisë së tij.







**Bledar KAÇIU**  
Administratori i TID KRUJA



Albanian-American  
Development Foundation



Zona për Zhvillimin e Turizmit  
KRUJË



# ***Në Krujë e bukur*** ***të Skënderbeut, Muzeve,*** ***e pazarit karakteristik***








Kruja është një tarracë natyrore, rrëzë malit të Krujës nga ku pamja e saj shtrihet në brigjet e Adriatikut. Shumë pranë Tiranës, Kruja mbetet një atraksion që nuk duhet humbur nisur nga ato që të ofron qyteti. Trashëgimia kulturore e ndërthurur me bukuritë natyrore të shoqërojnë kudo në Krujë.

Tek ngjitesh për në qytet pylli i pishave dhe ajri i pastër të ftojnë këndshëm në një vizitë plot mbresa. Me të arritur në qytet destinacioni kryesor është Kalaja e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Rrugës për në kala kalojmë nga Pazari i Vjetër që daton fillimet e tij në Shek XV, tashmë i restauruar nga Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim, duke ruajtur vlerat dhe traditat krutane.

Në Pazar mund të shikosh se si artizanët punojnë në mënyrë artizanale në prodhimin e qilimave, sixhadeve, kostumeve popullore, qelesheve, qëndistarive të ndryshme, punimeve të drurit, bakrit dhe alabastrës, riparime argjendarie, orëndreqës etj, tradita familjare që ruhen brez pas brezi. Duke hyrë në Pazar shikon punimet prej druri të Z. Muharrem Mefajës. Ecën dhe takohesh me Z. Ndrëçim Guni, ulur në cep të dyqanit, që është në fazën përfundimtare të prodhimit të një qelesheje. Bëhemi kuriozë dhe futemi të vizitojmë punishten e tij. Na tregon që është një zanat që e trashëgon prej katër brezash. Duke zbritur më tej na bën përshtypje një punishte argjendarie, ku takojmë Z. Hamdi Elbasani që na tregon për profesionin dhe objektet që po restauron në atë moment.

Tek zbret në kalldrëm shikon kostumet popullore të qëndisura nga Znj. Lindita







Herri, Znj. Diana Vena, Znj. Mimoza Berushi dhe Znj. Elida Çela. Bisedojmë me to dhe dëgjojmë tek na shpjegojnë interesin që tregojnë për të tilla kostume veçanërisht shqiptarët e Kosovës. Duke parë nëpër dyqane shikon Znj. Vjollca Dollaku dhe Mimoza Berushi që qendisin dhe qepin mbulesa, çentro, këllëfë jastekësh etj. Ato na tregojnë kërkesën që kanë për të tilla produkte turistët të huaj që preferojnë diçka simbolike "Made In Kruja" si kujtim. Gjatë gjithë pazarit shikon qilimpunese si Znj. Arjana Cerhozi, Znj. Vjollca Haxhiu, Znj Sulltane Mezini, Znj Dallandyshe Tabaku, Znj. Dëshira Maja etj. të cilat kanë një eksperiencë mbi tridhjetë vjeçare, nga koha e ish-Ndërmarrjes Artisike. Për të bërë një m<sup>2</sup> qilim nga një artizane duhen shtatë ditë të plota pune.

Mahnitesh, dhe të duket sikur kthehesh prapa në kohë kur futesh tek dyqanet e z. Fatos Hoxhës, Z. Altin Veselit apo të Z. Ardian Bërberit ku gjen antikuare të shekullit të shkuar por jo vetëm. Të tillë biznese shërbejnë si "show room-e" të historisë tonë nisur nga mobiljet e paçmueshme, veglat e punës, apo suveniret, të gjitha punime dore. Nuk kishte si të mungonte në këtë Pazar edhe një piktor, Z. Skënder Rroshi. Në sallonin e tij bien në sy piktura që tregojnë për betejat e zhvilluara nga Skënderbeu. Në dalje të Pazarit dhe vazhdimit të rrugës për në Kala, shikon në vitrina suvenire prej bakri, punuar nga Z. Ilir Bërhami. Gjatë bisedës artizani na shpjegon proceset e punës. Dalim nga "Derexhiku" siç e quajnë krutanët Pazarin e Vjetër, vërtet mbresëlënëse e ngjitemi në kala. Tek Porta e Kalasë, po të kthesh kokën, shikon një pamje të mrekullueshme të qytetit. Me të hyrë në Kala surprizohesh nga madhështia e Muzeut Historik Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Në pavionet e tij tregohet historia jonë kombëtare ndër shekulle.

Fare pranë Muzeut të Skënderbeut, brenda lagjes së kështjellës, e cila është e banuar, ndodhet Muzeu Etnografik i Qytetit, shtëpi e kohës, ndërtuar më 1764 nga Fisi i Toptanëve. Këtu paraqiten jetesa shqiptare në epokë të ndryshme, histori të ndryshme, dëshmi të gjalla të zhvillimeve që kanë shoqëruar këto troje.

Por një vizitë në Krujë nuk mund të mbyllet këtu. Në Krujë mund të vizitohen Mali i Krujës, vend piktoresk me panoramë mahnitëse të pjesës veriore të Ultësirës Perëndimore, Parku Kombëtar i Qafështamës ku gjendet dhe kroi i Nënës Mbretëreshë shumë i frekuentuar nga mjaft pushues të apasionuar pas turizmit malor, Qytetin e Albanopolisit, i vendosur në fshatin Zgërdhesh ndërtuar nga Fisi ilir i Albanëve etj.

Turizmi shihet nga banorët si një mundësi reale zhvillimi dhe rritja e promovimit të kësaj zone me trashëgimi kulturore dhe bukuri natyrore do të sjellë një vlerësim të potencialeve turistike të saj, me qëllim mbajtjen e tregut të synuar dhe tërheqjen e turistëve të rinj.





# TË JETOSH MALET

Eksploroni shpellat në Parkun Natyror Rajonal të Shkrelit dhe shtigjet me biçikletë malore në Malësi të Madhe



Turizmi i ecjes në natyrë dhe i speleologjisë në Shqipëri ka fituar popullaritet gjatë viteve të fundit, duke tërhequr turistë nga e gjithë bota. Shpellat janë një nga atraksionet më shumë të vizituara nga turistët e pasionuar pas ecjes në natyrë dhe studiuesit e shpellave (speleologët). Shpellat mbartin një biodiversitet të pasur dhe të rrezikuar. Ato kanë brenda tyre thesare gjeologjike të mahnitshme, por të brishta.

VIS Albania në kuadër të projektit “Bukë, Kripë e Zemër”, të financuar nga Kooperacioni Italian realizoi një studim dhe inventarizim të shpellave në Parkun Natyror Rajonal të Shkrelit, i cili përfundoi në muajin tetor. Ky hulumtim u krye nga Dr. Philippe Théou, ekspert në këtë fushë, i cili evidentoi shpellat që gjenden në këtë park dhe përpiloi një plan veprimesh, për t’u vënë nga zbatim nga Bashkia Malësi e Madhe dhe nga aktorët e ndryshëm që veprojnë në zonë. Duke qenë se disa shpella janë ligjrisht të mbrojtura si Zona të Mbrojtura të kategorisë III, të cilësuar si Monumente Natyre dhe habitate të mbrojtura sipas direktivave të BE-së, nevojitet një ndërgjegjësim i popullatës vendase, agjencive turistike dhe turistëve në mënyrë që t’i mbrojmë ato dhe biodiversitetin brenda tyre. Për këtë Administratat e Zonave të Mbrojtura dhe Autoritetet duhet të identifikojnë dhe të promovojnë shpella specifike për turizëm dhe të tjera për të cilat duhen marrë masa për të mbrojtur biodiversitetin e tyre. 16 shpella janë identifikuar dhe për të bërë të mundur eksplorimin e tyre janë trajnuar udhërrëfyesit vendas, pasi ato duhen vizituar patjetër nën shoqërimin e tyre!

Parku Natyror Rajonal Shkrel është vendi i përkryer për të zbuluar dhe mësuar si të eksploroni shpella në një mënyrë të sigurtë! Eksploroni dhe aftësohuni së pari në shpella të lehta para se të provoni të eksploroni ato që janë më sfiduese, prej 40 metrash të thella. Shpellat më të bukura në Parkun Natyror Rajonal Shkrel janë: Shpella e Madhe në Bogë, Shpella e Pëllumbave dhe Shpella e Shtogut në Razëm, Shpella e Gurrës në Reç. Këto shpella

me bukuri të veçantë apo shpella të tjera në zonë, duhen vizituar patjetër në praninë e udhërrëfyesve vendas: për sigurinë tuaj dhe për të ruajtur biodiversitetin e tyre.


## **Turizmi me biçikleta malore në Malësi të Madhe – 12 shtigjet që mund të përshkoni tejpërtej Shqipërisë së Epërme**

Shqipëria, me territorin e saj malor, natyrën e paprekur dhe mikpritjen e pashoqe, është një nga vendet më interesante për t’u zbuluar. Një nga mënyrat për ta zbuluar atë dhe për të përjetuar një aventurë të veçantë është ajo e përshkimit të shtigjeve me biçikletë malore. Tashmë, 12 shtigje për biçikleta malore janë identifikuar dhe shenjuar në Malësi të Madhe, falë projektit B.K.Z., dhe janë realizuar nga Tobi Gessler - Ride Albania Mountain Biking. Turizmi me biçikleta malore është një mundësi e përkryer për turistët që dëshirojnë të zbulojnë një tokë të pasur me bukuri natyrore të shumta, me kulturë e tradita të ruajtura ende sot. Është kjo një mundësi e çmuar në ndihmë të komuniteteve rurale, të cilat janë shpesh të izoluar dhe të pafavorizuara për sa i përket gjendjes së tyre ekonomike, duke vënë në dispozicion të turistëve shërbimet dhe mikpritjen e tyre. Turizmi me biçikletë malore, shenjimi i shtigjeve e krijimi i itinerareve, përveçse do të rrisë të ardhurat në zonat e thella rurale do të mund të rrisë gjithashtu motivimin e popullsisë vendase dhe atë të turistëve, për të mbrojtur dhe për t’u kujdesur për mjedisin.

Itineraret me biçikleta malore në Malësi të Madhe janë gjysmë-ditore, ditore dhe dy ditore. Shtigjet lidhin fshatrat brenda për brenda Kelmendit dhe Shkrelit, e një itinerar i veçantë dy ditore do t’ju bëjë të shijoni të dyja zonat së bashku, duke u nisur nga Razma (Shkrel) deri në Vermosh (Kelmend).

Turizmi me biçikletë malore plotëson më së miri atë çfarë është bërë deri më tani në Malësi të Madhe. Ky lloj turizmi diversifikon ofertën e deritanishme, e cila





- Fat black and red lines:** Possible asphalt/gravel roads to access the area on bike; from Podgorica (middle left), Plav (upper right) and Theth (middle right)
- 1 Tamara - Nikc - Vukel - back (Full day)
  - 2 Lepushe - Bjeska Morina - Lepushe (Full day)
  - 3 Lepushe - Qafe Kurcun - Gropat e Selces - Lepushe (Half day)
  - 4 Qafe Bordolet - Lepushe Qe. - Lepushe Bud. - Canyon - Qafe Bordolet (Half day)
  - 5 Tamare - Broje - Tamare (Half day)
  - 6 Rrapsh - Bratosh - Vrith - Razem (Half day)
  - 7 Rec - Qafe Grade - Small lake - and back to Rec (Half day)
  - 8 Rec - Qafe Grade - Rrapsh - and back to Rec (Full day)
  - 9 Lepushe - Greben - Vermosh (Half day)
  - 10 Razem - Fushe Zeze - Rrapsh (Full day)
  - 11 Vermosh - Vellopeje - end of valley - Vermosh (Full day)
  - 12 Two-day tour Razem - Tamare - Vermosh (Multi day)

ka qenë e pasur me shtigje të ecjes malore, atraksione të shumta natyrore e kulturore të identifikuar e promovuara, si shpella, kanione, ujëvara, legjenda e histori të lidhura ngushtësisht me njerëzit dhe territorin, veshje tradicionale e një gastronomi unike bazuar në dije të lashta e produkte vendore.

Malësia e Madhe – një tokë ku do të mund të përjetoni aventurën, të përfshiheni në natyrën e egër që të lë pa frymë, mes miteve dhe legjendave, të rrethuar nga vendasit krenarë për traditat dhe mikpritjen e tyre. Toka ku përmes përshkimit me biçikletë malore do t’ju bëjë të shijoni e përjetoni aventurën e fundit të Evropës.

## TURIZMI DIMËROR

Qysh në fillimet e pranisë së saj në Malësi të Madhe, ajo çka ka synuar VIS përmes projekteve të miratuara, është të bëjë të mundur që kjo zonë të mund të ofrojë një turizëm gjithëvjeter. Aktivitetet kanë ardhur gjithnjë e në rritje duke diversifikuar ofertën turistike e duke vlerësuar atë çka ofron territori, në potenciale jo vetëm natyrore e kulturore, por edhe njerëzore, duke krijuar kështu një sinergji që të mund të sillte një zhvillim të qëndrueshëm e jetëgjatë në zonë.

Së fundi, për t’iu ofruar turistëve mundësinë e përjetimit të një turizmi dimëror, disa bujtina në Kelmend kanë instaluar sistemin e ngrohjes me kaldaja. Kjo është bërë e mundur në bashkëpunim mes projektit BKZ dhe vetë pronarëve të bujtinave, duke bashkë-financuar kështu instalimin e këtyre kaldajave, për t’u ofruar turistëve një shërbim cilësor edhe gjatë muajve të bardhë të dimrit. Kjo do të bëjë të mundur që përveç mikpritjes dhe ngrohtësisë që të ofrojnë gjithmonë banorët e kësaj zone, vizitorët të mund të shijojnë një shkëputje nga rutina e përditshme në një mjedis të ngrohtë e të rehatshëm, duke përjetuar kështu edhe bardhësinë e muajve të dimrit, rreth një tryeze me gatesa të ngrohta, shoqëruar nga historitë e tingujt e magjishëm të çiftelisë e lahutës.

Të apasionuarit pas ecjeve në natyrë, do të mund të shijojnë ditëve me dëborë përshkimin e disa shtigjeve me ndihmën e rratheve të dëborës, të ofruara nga bujtinat ku do të akomodohen dhe të shoqëruar nga mikpritësit apo udhërrëfyesit vendas.







# Thethi, kreshniku i bukur i Alpeve

S`di pse më vjen në mend një krahasim i tillë por kur ndërmendem për udhëtimet e bëra në Alpe, Valbona më përngjet me një vajzë të bukur e lozonjare si Orët e Malit që freskohet mes stërkalave të bruzta të burimit të saj, kurse Thethi më duket si një djalë hijerëndë i hijshëm e i ashpër, si kreshnikët e Eposit, që nuk mund t`i latosh aq kollaj por që edhe e ke të pamundur t`i rezistosh....





## Flora Xhemani Baba

Kur merr rrugën për të bërë një udhëtim në Theth, natyrisht që ke përpara shumë bukuri të tjera natyrore, ku është e pamundur të mos ndalesh një copë herë, ashtu siç, për të shijuar një pjatë të parë gatuar me mjeshtëri nga një artist kuzhine, duhet së pari të provosh njëherë antipastat. Ndoshta krahasimi është i pashijshëm por duhet të kihet një ide sado e zbehtë, se çfarë është Thethi, në krahasim me të gjithë segmentin natyror që haset rrugës për tek Ai, gjithmonë e kemi fjalën këtu për ata që ende s'kanë qenë asnjëherë në Theth.

Sot, rruga nga Kopluku nëpër Luginën e Bogës e deri në Qafë Thorë, është shtruar dhe gjarpërimi i asfaltit të zi përmes të kuqes portokalle të aheveve, blireve, e pemëve të tjera që formojnë peisazhin vjeshtor këtyre anëve, duket si një fjongo e bukur. Pak pa shkuar në Qafë, kanë ndërtuar edhe një ballkon të bukur me xham (pse të mos ishte vetëm me dru?) për të shijuar panoramën që hapet sa të ha syri dhe të mbush gjoksin me ajër e me kënaqësi po aq të pamatë sa shtrirja e luginës. Ndonëse rrugën e ke bërë me lëvizje koke njëqindetëdhjetëgradëshe, për të mos humbur asnjë gjeth të ndezur e asnjë pamje magjike në të dyja krahët, e kupton pak më vonë se gjithçka ke parë deri tani, ka qenë vetëm një aperitiv, për festën e mëvonshme të syve e të mendjes.

E kur më në fund lemë pas metrat e fundit të asfaltit të zi dhe ngjitemi aty në sheshpushimin ku kanë zënë vend tabelat e bujtinave të Thethit e ku të zotët e bujtinave presin zakonisht



grupet e turistëve, pamja ndryshon kryekëput; jo vetëm rruga, që fillon e ashpërsohet nga çakulli por edhe çfarë ti sheh para syve. Tufa të mëdha resh të bardha përzier me mjegull të dendur, mbulojnë me xhelozë malet e veshura me bimësi të përzier pishë e zezë përherë e blertë dhe ahe tashmë të portokallta, duke u lënë jashtë tek-tuk vetëm majat.

Dramatike! Kjo bukuri duhet ta ketë shushatur edhe Edit Durhamin kur kalonte këndej pari, sepse dihet, natyra është e përjetshme dhe peisazhi do ketë qenë po ky, një ëndërr e mjegullt, e pakapshme, ndjellëse, tronditëse, që në fakt nuk di ç'është t'i vësh por që e ndjen se si ta merr frymën e tek-tuk të bën të lëshosh vetëm pasthirrma. Një bukuri tronditëse me të cilën nuk mund veçse të biesh





Vila Gjeçaj, në qendër të Thethit



në dashuri me shikim të parë, të dytë, të njëqindtë. S`di pse më vjen në mend një krahasim i tillë por kur ndërmendem për udhëtimet e bëra në Alpe, Valbona më përngjet me një vajzë të bukur e lozonjare si Orët e Malit që freskohet mes stërkalave të bruzta të burimit të saj, kurse Thethi më duket si një djalë hijerëndë i hijshëm e i ashpër, si kreshnikët e Eposit, që nuk mund t`i latosh aq kollaj por që edhe e ke të pamundur t`i rezistosh....

Ja dhe djemtë e grupit Discover Albania. Valbonë, Theth, Dhërmi, Lurë, Prizren, Bogë, Rugovë.... Kudo që të shkosh e të kudogjendur. Është kënaqësi e madhe

tek sheh se sa të papërtuar janë këta djem e vajza për të udhëhequr të tjerët nëpër shtigjet e Shqipërisë, në çdo stinë e në çdo situatë atmosferike. Besojmë se me njerëz të tillë të pasionuar, turizmi do të bëhet. Ja edhe tani, rrugës për tek Ujvara e Grunasit, takojmë Ismailin, pikërisht në urën e bukur me skelet hekuri, lyer me të kuqe, që kanë mundësuar çekët, për të lehtësuar kalimin për tek shtegu i Ujvarës.

Kemi folur kaq e kaq herë për Thethin dhe duket sikur nuk ke më se çfarë të thuash, e, është në njëfarë mënyre kështu, sepse përcaktorët e gjuhës shqipe janë të kufizuar, me gjithë








larminë e saj të pashoqe. Por sidoqoftë ka gjithmonë diçka për të thënë, bie fjala, se si Kulla e Gjeçajve këtë herë na priti si një nuse me petka të reja, por jo vetëm petkat por e gjitha e rinuar, sipas stilit e traditës së kullave shekullore. Petriti, djali i familjes së Gjeçajve, Babë Ndocit e Nana Lules, thotë se investimi është marramendës, për familje me të ardhura mesatare modeste siç janë ata që merren me turizëm bujtinash. Mirëpo duhet, nëse don të bësh turizëm të mirë. Sepse tjetër gjë është të ruash traditën e tjetër të ofrosh cilësinë. E nëse ai këmbëngul se për të përballuar cilësisht shtimin e fluksit që për fat të

mirë ka qenë vazhdimisht në rritje, Nana Lule nuk pranon kurrsesi që turistët të hanë diçka që nuk e ka gatuar dora e saj. Në mos po, le të vijë kush të dojë t'i japë një dorë për t'i përgatitur a ndihmuar në kuzhinë por jo të lërë në duar të dikujt tjetër saçin, apo mazën, gatimet në dukje të thjeshta por që sekretin e kanë pikërisht tek dora e saj. Kjo na gëzon pa masë kur e dëgjojmë, e shpresojmë se rezistenca do të jetë e gjatë, për shkak se fluksi i madh sjell gjithmonë rrjedhje, sidomos në cilësi. Madje sidoqë thethjanët mërziën, edhe ne ashtu si të huajt, mendojmë se ato 12 kilometra rrugë nuk duhen asfaltuar, përdryshe do t'i prishin bukurinë e ashpër Thethit. Ata që do vijnë për ta shijuar këtë bukuri duhet të lodhen. E nëse nuk duan të lodhen le të mos vijnë. Thethi do sy për të parë, zemër për të ndier, e këmbë të forta për ta shëtitur cep më cep. Thethi është shpirti i Alpeve, ka qenë aty gjithmonë, e ka hyrë herët në listën e turistëve që e dashurojnë.

**A, se mos harrojmë. Do dhe dritë. Atë po. E ka patur çentralin e tij edhe atëherë kur edhe qytetet e jo më fshatrat nuk e kishin. E sot, mëkat i madh, gdhin ditët e freskëta e netët e ftohta që kanë nevojë për ngrohtësi, nën dritën e qiriut ose të një lllampe që nuk ia kalon atij.**






# VJESHITË

## *Përmetare*

*Shijoni magjinë e stinës më të bukur,  
në qytetin e të gjitha stinëve*







Stina ka ndryshuar jemi në vjeshtë, në periudhën më me shumë ngjyra të vitit, me tonalitete të ngrohta që veshin peizazhin përreth nesh ku natyra është unike. Temperaturat bien, klima është mes butësisë dhe freskisë, rrëmuja e verës përfundon dhe vjen momenti për një udhëtim vjeshtor. Në fakt, pushimet e vjeshtës janë ideale për ata që kanë nevojë të qetësohen mes ushqimit të mirë dhe të shëndetshëm, shëtitjeve, natyrës dhe kulturës.

Nëse dëshironi ose keni marrë një ftesë për të vizituar qytetin e Përmetit në stinën e vjeshtës, mos refuzoni. Çfarë ofron Përmeti? Ajër të pastër, shëtitje në natyrë, kulturë, gastronomi, mikpritje... Këto t'i falin bujarisht pa të kërkuar asnjë gjë në këmbim. Qyteti i Përmetit është sinonim i një qyteti me një mikpritje të rrallë, qytet i luleve, i këngëve popullore, lirike me saze, qytet i verës, rakisë, ushqimeve tradicionale dhe glikove tipike si ajo e arrës, kumbullës, kajsisë etj. Atë që Noli e tha fare thjeshtë e bukur vite më parë: "Do të hash e të bësh qejf/ Sofrën shtruar si për mbret/ pastërtore e për hyqmet/ të tillë gjen veç në Përmet". Megjithëse një qytet i vogël, aty i gjen të gjitha. Sofrën e mbushur plot, butet me verë dhe qytetarë dashamirës, të gatshëm në çdo moment të flasin për historinë e tyre. Gjithë treva e tij është kulturëdashëse.



## Mikpritja virtyt i familjeve Përmetare

Traditat janë pjesë e rëndësishme e një komuniteti, janë tregues të cilësive dhe kulturës të një populli. Mikpritja është një nga vlerat kulturore që karakterizon komunitetin e Përmetit dhe një vlerë kulturore që vishet me një cipë hyjnore duke pasur një rëndësi të veçantë. Miku respektohet, vlerësohet si edhe nderohet, për vetë rolin e rëndësishëm që mbart. Kjo vlerë në ditët e sotme shikohet në zbeheje të saj në zonat urbane ku vetë jeta intensive, zhvillimi, veprimtaria, mundësitë zgjedhëse bëjnë që këto lidhje të jenë më të dobëta dhe më të zbehta por e kundërta ndodh në familjet përmetare ku mikpritja është e theksuar dhe hyjnore. Siç shkruan dhe Ismail Kadare "Përpekja për të shndërruar në një gjysëmhyjini njeriun më të zakonshëm mjafton që ai të trokiste në shtëpi". Edhe Edit Durham shkruan "Ligjet e mikpritjes janë më të forta se armët". Vlerat kulturore janë tepër të rëndësishme për komunitetin Përmetar, janë tregues të kulturës, personalitetit, identitetit të tyre. Ngrohtësia dhe mikpritja janë virtyte të trashëguara brez pas brezi që i karakterizojnë familjet Përmetare akoma dhe në ditët e sotme. Vizitorët kanë mundësi të shijojnë bukuritë e fshatrave karakteristike në gur të rrethit të Përmetit. Në këto fshatra, të vendosur në kontekste piktoreske, tashmë është i mundur qëndrimi në shtëpitë pritëse ku vizitorët shijojnë mikpritjen, ushqimet tradicionale lokale dhe jetën e përditshme të fshatit. Fshatrat karakteristike që mund të vizitohen janë: Bënjë, Ogdunan, Delvinë, Trebozisht, Strëmbec i vjetër, Kaludh i vjetër, Biovizhdë, Leusë, Lipë, Frashër, Kosovë, Ogren, Buhal, Kajcë, Limar, Mbrezhdan, Katundishtë, etj.. Spikat mënyra e ndërtimit të shtëpive, kalldrëmeve, sokakëve, teqetë dhe kishat shekullore ndër të cilat mund të përmendim: Teqja e Frashërit, Teqja e Alipostivanit, Kisha me piktura murale Shën Maria e Leusës, Kisha me piktura murale Shën Ilia e Buhalit, Kisha Shën Mariae Kosinës, Kisha Shën Maria e Bënjës, Kisha me piktura murale Shën Maria e Peratit etj., të cilat e bëjnë rrethin e Përmetit të lakmueshëm dhe me interes të lartë

turistik për vizitorët e vendit dhe ata të huaj.

## Ushqimet tradicionale përmetare

Të njohura ndërkombëtarisht për shijet e tyre të veçanta, shumëllojshmërinë e recetave dhe produkteve unike bio me kilometër zero, mund të shijohen dhe konsumohen në restorantet tradicionale por edhe në shtëpitë pritëse të hapura së fundmi. Në periudhën e vjeshtës janë të shumta gatimet vendase që vizitorët zgjedhin të shijojnë të bëra nga duart e nënave përmetare. Gjithashtu nuk mungojnë ndër preferencat e tyre edhe byrekët e ndryshëm, mesniku, gjella me arra, supa me thërime e kaposh fshati, etj.; fruta të thata si kumbulla, thana, vadhëza, ftonj, xinxife, arra, lajthi, bajame, mollë, shegë, fiq, etj.; turshitë, verat dhe rakitë e mirënjohura të varieteteve të ndryshme, çajrat natyralë të vargmalit Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërkë.

## Konvivium Slow Food Përmet.

Nuk mund të mungojnë, si atraksione dimërore të rëndësishme edhe eventet e **Konviviumit Slow Food Përmet**, i dyti i krijuar në Shqipëri në vitin 2012. Ai lindi si dëshirë e disa bizneseve (që veprojnë në fushën e turizmit & produkteve tipike) dhe disa individëve të komunitetit përmetar të cilët janë mbështetës të parimeve të "Slow Food International". Anëtarët e Konviviumit veprojnë vullnetarisht në pjesëmarrjen dhe organizimin e shumë aktiviteteve për promovimin, mbështetjen dhe mbrojtjen e identitetit të gatimeve tradicionale përmetare; prodhimeve, produkteve & farave vendase bio; racave shtazore autoktone; në mbrojtje të natyrës, lumenjve, pyjeve, biodiversitetit dhe ekosistemit të rrethit të Përmetit. Këto realizohen nëpërmjet pjesëmarrjes në EVENTE (darka, bankete, kokteile me produkte tipike përmetare), në PANAIRES (kombëtare-Tiranë, Gjirokastër, Shkodër, Durrës, Elbasan, Vlorë, Berat dhe ndërkombëtare - Milano Expo, Torino, Dubrovnik, Pistoia, Sofie, Puglia) duke promovuar produktet tipike përmetare si: salcë në shakull, djathë dhie, dele, kaçkavall dele - glikotë e arrës, patëllxhanit, shalqinit, fikut të egër, kajsisë, qershisë, kumbullës, portokallit,





fikut shëngjinës, nerënxës, domates së vogël jeshile - preveade thane, ftoi - verë Debinë (varietet rrushit autokton përmetar), verë Shesh i Zi (varietet rrushit autokton shqiptar), verë Trëndafili, Merlot, Riesling - raki Mani, Moskati, Dëllinje, Thane, Manaferrë, Mare, Rrushit, Rigoni - mjaltë Mare, Pylë, Shumëlulësh - reçel ftoi, kumbulle, qershie, fiku - komposto ftoi. Glikoja Përmetare me shijet unike që përpunimi i frutave dhe perimeve ofron, tashmë është edhe **Presidio Slow Food prej 2 vitesh**. Një mënyrë tjetër është marrja pjesë në TAKIME, KONFERENCA ndërkombëtare ku diskutohen dhe studiohen në nivel botëror praktikat më të mira në mbrojtje të farave vendase, racave shtazore autoktone, biodiversitetit dhe ekosistemit. Këto praktika përcillen më pas edhe në komunitetin lokal në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i filozofisë të të ushqyerit shëndetshëm.

Organizohen gjithashtu edhe **CELEBRIME** të tilla si **"Dita e Tokës Nënë" (Terra Madre Day)** që mbahet çdo vit më datë 10 Dhjetor. Në Dhjetor të 2016 "Konviumi Slow Food Përmet" do të organizojë me ndihmën logjistike të organizatës Cesvi "Ditën e Tokës Nënë", aktivitet i cili bën pjesë edhe në kalendarin e Ministrisë të Bujqësisë, e cila e shpalli Dhjetorin si muajin e Bujqësisë Shqiptare. Celebrimi do të ketë si temë kryesore recetat tradicionale të guzhinës Përmetare. Larmia e kuzhinës Përmetare dhe teknikat e përgatitjes së produkteve tipike do të jenë në vëmendjen e të ftuarve ku do të bashkohen me komunitetin lokal për të festuar këtë ditë. Në event do të marrin pjesë banorët e qytetit dhe fshatrat e rrethit por edhe të interesuar nga e gjithë Shqipëria.

Slow Food Përmet organizon këto evente në mbrojtje të traditës lokale dhe produkteve tipike bio. Përmeti mori pjesë këtë vit në skenën ndërkombëtare të eventit të rëndësishëm "Terra Madre Torino 2016" iniciativë e Slow Food. Përmeti u paraqit me 69 varietete produktesh dhe kjo u bë e mundur falë organizatës Cesvi e cila vendosi në dispozicion stafin e tij dhe ofroi mbështetje financiare. Interesi për të provuar dhe blerë produktet Përmetare ishte shumë i lartë. Ishte një sukses i vërtetë dhe sodisfaksion i madh gjithashtu! Stendi i Përmetit u vizitua nga

shumë banorë të Torinos, emigrantë Shqiptarë, delegatë të vendeve të tjera të botës dhe turistë! Vizitorët mbetën të kënaqur dhe entuziastë për gastronominë përmetare dhe ishin të sigurt që Shqipëria është një vend për t'u rekomanduar tek miqtë dhe të afërmit e tyre për ta vizituar... Ky okazion ishte i shkëlqyer për një trevë kaq të vogël si Përmeti dhe kërkonte një angazhim shumë të madh qoftë në fazën përgatitore por edhe gjatë zhvillimit të eventit.

### Konsorciumi Pro Përmet

Është krijuar në vitin 2010 në kuadër të projektit "Vlerësimi turistik-ambiental i zonës së Përmetit dhe i produkteve tipike të tij" këtë shoqëri prodhuesish agrourbimorë, biznese që operojnë në sektorin e turizmit të pritjes dhe akomodimit, si dhe subjekte me aktivitet artizanal që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin rrethit të Përmetit. Anëtarë e saj janë të angazhuar kryesisht në promovimin territorial, zhvillimin e turizmit nëpërmjet promovimit të produkteve tipike agrourbimorë dhe artizanale, zhvillimin e strukturave të pritjes dhe akomodimit, në ruajtjen e ambientit etj. Qëllimi i Konsorciumit është ai i promovimit të përbashkët të aktiviteteve të mbështetura në traditën dhe kulturën e rrethit të Përmetit duke përballuar me sukses konkurrencën si dhe duke rritur kapacitetin dhe aftësinë për të ofruar shërbime turistike komode dhe me cilësi të lartë. Aktualisht, pas 6 vitesh nga krijimi i tij, Konsorciumi falë aktiviteteve të shumta që ka zhvilluar dhe aktivitete të shumta ku ka marrë pjesë, përfaqëson një markë rajonale të konsoliduar dhe rezultatet e tij janë të shprehura konkretisht në rritjen çdo vit të numrit të vizitorëve dhe turistëve vendas dhe të huaj si dhe në të njëjtën kohë dhe në rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të konsorciumit për të ofruar një shërbim cilësor dhe të plotë duke bërë që qëndrimi i turistëve dhe vizitorëve të jetë më i gjatë në kohë.

Shijoni kontrastin e thellë midis të bukurës, qetësisë, kulturës argëtimit e pushimit në Përmet. Ia vlen! Provojeni dhe do të shihni se ka arsye të shumta për ta provuar përsëri....

**KONTAKTE:**  
SHOQATA PRO PËRMET  
Pro Përmet  
You Tube: Pro Permet  
pro.permet@gmail.com  
[www.visitpermet.org](http://www.visitpermet.org)

### KONVIVIU SLOW FOOD PËRMET

Slow Food Permet-Albania  
slowfoodpermet.al@gmail.com  
You Tube: Slow Food Permet  
[www.slowfood.com](http://www.slowfood.com)  
[www.terramadre.info](http://www.terramadre.info)  
tel: +355 (0)69 4617965

### Cesvi Albania

Cesvi Albania  
You Tube: Cesvi Albania  
cesvi.albania@gmail.com  
Tel: +355 (0)81323725  
[www.cesvi.org](http://www.cesvi.org)  
[www.cesvi.eu](http://www.cesvi.eu)

### RAFTING VJOSA ALBANIA OUTDOORS SPORT

Rafting Vjosa Albania  
e-mail: raftingvjosa@gmail.com  
Ahmet Berzani, tel: +355 (0)69 2778215

### ZIT - ZYRA E INFORMACIONIT TURISTIK

Qendra Kulturore Multifunksionale  
Shëtitorja Odise Paskali  
Ora e hapjes: çdo ditë nga ora 8.00 - 18.00  
Tel. +355 (0) 81320015







### **Te Stela Beergarden**

Ushqim i përzgjedhur që shijohet përsosmërisht me birrat e freskëta të prodhuara dy hapa më tej. Çdo të premte e të shtunë, në skenë zbresin artistët më në zë të skenës shqiptare.



### **Te Stela Poolbar**

Pishinë e hapur e kombinuar për fëmijë e të rritur me kapacitet prej 200 vendesh. Gjatë netëve verore në këto ambiente organizohen festa të ndryshme tematike.

### **Te Stela Evente**

Për mysafirët tanë në udhëtim biznesi, Te Stela Evente ofron ambiente dhe facilitete për takime pune, mbledhje, trajnime e konferenca.



### **Te Stela Sport Center**

Struktura sportive e Te Stela Resort përfshin dy pishina të mbyllura gjysmëolimpike ku ofrohen sauna e banjo turke, mësimet kurativ e sportiv, gjimnastikë aerobike, masazhe relaksuese e terapeutike.

### **Te Stela Hotel**

Te Stela Hotel, një oaz i vogël qetësie. Me kapacitet 100 dhoma, me pamje mbi pishinë dhe ndriçim të bollshëm natyral. Hotel i relaksit dhe i shërbimit special.



Vetëm 7 km nga aeroporti, 6 km nga qendra e Tiranës dhe 200 m nga QTU (Qendra Tregtare Univers), Te Stela Resort, Autostrada Tiranë - Durrës, km 7. Cel. 067 20 33 309; info@testela.al; www.testela.al; facebook.com/StelaResort



Gjirokastra është thesari turistik e kulturor i turizmit tonë, vulosur nga UNESCO dhe pëlqyer nga bota mbarë. Por sa pak e shijojmë natyrën e saj të mrekullueshme! Sa pak dimë për shtigjet e bukura, përzier magjishëm me arkitekturë mesjetare, tempuj shpirtërorë e qytete antike.... Pa dyshim që për bukuritë e fshehura të Gjirokastrës ju kemi folur kaq e kaq herë sepse është misioni ynë por është krejtësisht tjetër gjë t`i shijosh ato nga afër. Dhe e dini se si? Duke kalëruar! Ka ardhur koha të shijoni Vjeshtën e Gjirokastrës në shoqërinë e kuajve fisnikë e të magjishëm të Caravan Riding Centre Albania. Dhe jo vetëm vjeshtën. Çdo stinë është e magjishme nëpër natyrën e saj, sidomos nëse e shijoni duke kalëruar.

Flora Xhemani Baba

# Koha për kalërim nëpër Gjirokastrën e blertë





Kishim kohë që donim të bënim një udhëtim më kalë nëpër Gjirokastër, qyshse Kristina Fidhi na pat ftuar që të na organizonte një ditë të tillë me kuajt e saj të mrekullueshëm. Ajo bashkë me Aurelin e Ilirin, organizojnë prej vitesh tashmë dy itinerare interesante që të lejojnë të njohësh fshatrat e mrekullueshëm e plot histori të Gjirokastrës, duke ecur mbi gjurmët e karvaneve tregtare të mesjetës apo ato të mbretërve ilirë.

Dhe dita për këtë udhëtim erdhi më në fund në tetor, një muaj i cili na krijon një periudhë qetësie mes rrëmujës së çmendur të verës e projekteve të reja të dimrit, kohë kur ne realizojmë udhëtimet e vjeshtës për revistën Travel. Një kafe e shpejtë në Gjirokastër dhe drejt e për rrugë, fillimisht do shkonim të merrnim kuajt.

E vendosur në pesiazhin e kodrinuar përballë Gjirokastrës, stalla e kuajve, që ishte gjyhan ta quaje kështu, rrethuar me atë gardhin e bukur me listela, ishte një relaitet që fare kollaj mund ta zhvendosje për diku në ndonjë fermë jashtë Shqipërisë, nga ato që zakonisht i shohim nëpër filma. Njëzet e tre kuajt e Caravan Riding Centre ishin shpërndarë nëpër kodra e kullotnin të qetë, disa prej tyre loznin me njëri-tjetrin nëpër oborin e stallës, ata që do të udhëtonin me ne, prisnin të kashaiseshin (sa qejf i madh ishte të kashaisje kuajt!), qentë e resortit na pritën gjithë gëzim e macet ngroheshin në diell.

Nuk e di pse ne njerëzit jemi treguar kaq budallenj dhe e kemi lejuar veten të na vërë teknologjia përfund dhe të na skallëvrojë deri në atë pikë sa të harrojmë këto gëzime të vogla të jetës, që të mbushin aq shumë e të bëjnë të ndjehesh aq mirë. Kjo natyrë paqësore, që shërbente njëqind herë më shumë se seancat e jogës apo çfarëdo lloj terapie qetësuse të ketë shpikur njerëzimi, duke harruar se terapitë janë aty, i ka shpikur natyra që në fillimet e saj.

Unë nuk isha ngjitur asnjëherë në kalë dhe kisha frikë se mos nuk do arrija ta shijoja këtë udhëtim rishtar. Mirëpo Kristina na tha se sekretin më i madh është të krijosh kontakt të brendshëm me kalin, që ai të kuptojë se e do, e të të dojë edhe ai. Pastaj gjithçka tjetër i lihet rrjedhës së natyrshme por edhe vetësigurisë e kontrollit të situatës. Je ti që i ke frenat në dorë Çarli, Xhengo, Ajër, Ermioni, Oniva....

Interesantë, apo jo? Janë emrat e disa prej kuajve, ata me të cilët do të udhëtojmë. Mua më besuan tek Ermioni. Është e qetë, nuk e lë në baltë kalorësin fillestar, nuk të hedh, kupton lëvizjet e tua dhe përshtatet. Të tjerët ishin të gjithë kalorës të stërvitur, Sofia, Kristina, Aureli, madje edhe Koli, që ishte rritur duke i kalëruar jo me frerë por nga jelet, kuajt e kohëve të fëmijërisë.

Nisemi. Do të shkojmë në Gjino Fshat, meqë kemi fillestarë me vete dhe duhet të zgjedhim një itinerar të shkurtër. Kuajt duan të vrapojnë me galop por unë e mbaj fort Ermionin që don të vrapojë pas tyre, sepse nuk di të kalëroj. Ajo e kupton dhe qetësohet.

Çdo udhëtim e ka një aventurë, të vogël apo të madhe. Aventura jonë ishin të pëlliturat e një gomari, që çobani për drejt nuk e kishte lidhur por e kishte lënë të kulloste i qetë në lëndinë, ndërsa vetë shullëhej në diell duke ruajtur delet. Mirëpo kuajt u trembën nga të pëlliturat e gomarit e zunë të hidhnin shqelma. Ermioni u ngrit kas përjetë dhe mua më ngriu gjaku. Nuk kisha frikë mos vritesha por kisha frikë mos bija. Që në udhëtimin e parë kështu? S'kishte lezet! U bëra njësh me qafën e saj dhe teksa l thërrisja të qetësohej, për pak sa nuk rashë. Por u mbajta fort e ajo më në fund u qetësua, pasi edhe Aureli e kishtë dëbuar gomarin. U qetësua. Dhe nuk më hodhi. I fërkova qafën e mbushur me djersë dhe më në fund vazhduam rrugën. Uh, shpëtuam!

Mbresëlënëse, tha Krisitna, je kalorësja e parë që nuk bie, e kontrollove kalin me një siguri që nganjëherë nuk e kanë as kalorësit e stërvitur. Epo kjo ndodh sepse ne i duam shumë kafshët dhe besoj se ato e kuptojnë këtë.

Nuk e dimë sa prej jush e kanë patur fatin të shijojnë panoramën e Gjirokastrës përballë, por jo thjesht në rrugë kur kalojnë





me makinë por lart, në lëndinat e mrekullueshme të Lunxhërisë, ku stinët përzihen natyrshëm e ku ne që menduam se do gjejmë vjeshtën e shtruar këmbëkryq, pamë me admirim se ato ishin të mbushura me luledele dhe qumështore! Çfarë spektakli natyror! Lëndinat e mbushura me gjethet e thara të rrepeve e të arrave, dhe në mes tyre nxjerrin kokën luledelet!

Pushimin e bëjmë pikërisht nën hijen e arrave që rriten për qejf të tyre në lëndinë. Ato nuk janë të askujt e janë të të gjithëve njëkohësisht kështu që edhe neve përpigemi të gjejmë pjesën tonë. "I kanë mbledhur çobanët, nuk besoj të ketë më tani ndonjë kokërr" thotë Aureli. Por ja që nuk qenka kështu. Ne gjetëm plot. Shumica ishin të kalbura por edhe të mira kishte sa të duash.

Çlodhemi një copë herë e kuajt gjithashtu, madje kanë qejf të rrokullisen nëpër lëndinë por Kristina nuk i le të hallakaten sepse prishin pajisjet, që kanë kushtuar një djall e gjysmë [eh, cilësia kushton sepse kalorësit që vijnë për të bërë turet e Gjirokastres, i kanë standartet të larta, deri tek niveli i katërt]

Meqë rrugës nuk ecnim dot me galop, Sofia, Aureli dhe Koli, u hipën kuajve dhe bënë dy xhiro të gjata fund e krye lëndinës. Kuajt u shkrijuan, e nga gëzimi hingëllinin fort sa dëgjohej në gjithë lëndinën.

Kthehemi. Edhe njëherë përmes luledeleve e deleve, arrave e shkurreve, burimeve e shtigjeve ku patkojtë kërcasin mbi gurë, vjeshtës e pranverës bashkë. Para nesh shfaqen gardhet e bukura të oborrit të stallës, ku kuajt e tjerë shëtisin të qetë. Kam edhe një provë të fundit. T`i zbres si duhet Ermionit, pa u rrezuar. Them se do ia dal, Tani u bëmë shoqe.

Kur u futëm në stallë, secili me kalin e vet, Aureli na tha se duhet t`i ushqejmë, kështu kali jo vetëm që kënaqet, sepse e meriton pas lodhjes nga udhëtimi por është pjesë e forcimit të miqësisë dhe ai nuk të harron më.

Mbaruam. Pasi kemi lënë kuajt, u hipim makinave dhe zbresim poshtë në fshat, ku pijmë nga një kafe. A duhet ta përsërisim këtë përvojë? Patjetër. Por duhet ta provojnë edhe të tjerët. Ne nuk i aplikojmë këto udhëtime për shqiptarët sepse përgjithësisht nuk ka shqiptarë që dinë të kalërojnë dhe përveç kësaj ndjehemi përgjegjës nëse ata dëmtohen nga kalërimi. Epo, ka gjithmonë një herë të parë, dhe ju jeni ata që duhet t`ua mësoni kalërimin atyre që nuk dinë por që duan shumë ta provojnë këtë që provuam ne sot.

Njeriu jeton e punon çdo ditë nën një stres e intensitet jete, që nuk të lejon më të shijosh kënaqësitë e vogla, gjendjen pranë natyrës, piknikun apo edhe plot mundësi të tjera qetësimi e që në të përdishmen moderne metropolitane i thonë relax. Por duhet patjetër të shkëputeni për të provuar kënaqësi të tilla.

Faleminderit Kristina e Aurel, për këtë udhëtim të magjishëm, faleminderit Sofia për spektaklin e bukur mbi kalë, faleminderit dhe ti Ermioni, që nuk më le në baltë. Një ditë si kjo, vlen sa një jetë.

**Gjirokastrë, tetor 2016**





# Albania in Adventure Travel World Summit 2016

## Blerina Ago

With 3 million lakes, 300.000 glaciers, dozens of vast mountain ranges, over 100 native languages and millions of acres of protected park land, Alaska was big enough to host the 2016 Adventure Travel World Summit from 19-22 September 2016. More than 850 delegates representing 65 countries promoted their touristic offer and interacted with each other regarding sustainable tourism issues and the world trend of adventure tourism. Blerina Ago from Albanian Rafting Federation represented Albania through the innovative project Albanian Adventure Resort in Adventure Travel World Summit 2016:



### ALBANIAN ADVENTURE — RESORT —

I am Blerina and I come from Albania, a small European country in the Western Balkans. Europe has always been an amazing continent to travel just for the pleasure of it and that is how what we all now call the tourism business started. Nearly 200 years ago, Lord Byron, one of the best travel writers of history, or the equivalent of today's' millennial hipster blogger, decided to take a risk and not only do the "Grand Tour" but extend his travel to Albania hoping for an exotic adventure. Indeed he wasn't disappointed. To him we were this enigmatic land of the eagles he had heard of from the Turkish Imperial court, but when he first set foot in the country he was surprised to find some of the most picturesque landscapes he had ever seen, majestic mountains, and the extraordinary character of men and women. Two centuries have passed, but to your surprise Albania hasn't changed that much. Is it a curse or maybe it is a blessing? I would definitely say it is a blessing, because we still





have the same wilderness and mystery Lord Byron describes in his novels. People in remote villages are just as surprised to see visitors as they were back in those days, greeting them with the same guest rituals by opening their houses, treating them with the same honor and respect. Albanian hospitality is so much praised for. That same centuries old motto which best describes Albanian hospitality "Buke e kripe e zemer", literally means "Bread, salt and a kind heart" and shows exactly the values of the Albanian spirit: all that I have which might not be much...I will share it with my guest who honored my house with his presence. We have been fortunate enough to have welcomed many tourists and travelers from around the world over the past 10 years; and every single time we ask them "Why Albania?" their candid response is somehow the same, "It's different, it's diverse, it's like time travelling". Travelers that choose Albania as a destination are well-experienced travelers that have been around Europe and the world, have seen all the nuances of tourism but have chosen to be travelers and are addicted to having "the experience". Just as Lord Byron, centuries later they have the same drive, they come to Albania because they want something different and also because they consider themselves different from mainstream tourists. They come to Albania because they want to switch off from the impeccable order of Switzerland or Finland, because they are tired of the metropolitan fast pace of London or Berlin and because they want to escape the endless tourist lines of Rome and Paris. They keep coming back to Albania because, we make sure our visitors know how important they are to us, that they are our guests, our friends and

that they can ask us anything - like why our men kiss while greeting each other, or politics and corruption, to how much we earn, or to why our grandma is force-feeding them - we are "super-chill".... we don't mind...we love chatting. They love to see how Muslims and Christians honor and marry each other and how the tiny country of a tiny lady, Saint Teresa of Calcutta, but just like her with a big enough heart, welcomed many Jews during WWII. Albania is the last unexplored destination in Europe, offering almost everything nature, culture and heritage can offer, and just like the country's many archeological sites we want to be discovered carefully, bit by bit, while preserving what has been passed on to us. That is why we have chosen to develop adventure tourism responsibly, while having our visitors involved just as much in the preservation of our resources. I want to present to you a short video of our latest initiative the Albanian Adventure Resort. It is a short story of transformation and what the future looks like in terms of recycling big, and by that I don't mean just recycling non-degradable materials but I mean recycling old military buildings which represent a troubled time in the Albanian history, the time of isolation and dictatorship. The story describes the transformation of a military base that once represented defense and paranoia into an outdoor fun park, open to everyone, whose sole purpose is to bring people together through sports and nature and ultimately make them happy.







# Turizmi

## Hungarezët: Se prisnim Shqipërinë të na befasonte kaq shumë, duhet një linjë direkte

Rudina HOXHA

TIRANA –Shqipëria është zbulimi më i bukur, më interesant dhe më surprisive për turistët hungarezë këtë vit ndërsa ajo ofron për ta pikërisht çfarë atyre u mungon: detin, malet, sportin e rafting por edhe ushqimin e freskët bio, sidomos ushqimet e detit. Por i vetmi problem është ri-vendosja e një linje direkte fluturimi midis Tiranës dhe Budapestit që mund ti shkurtojë distancat për ta.

Ky është mendimi i njëgrupi prej 15 operatorësh turistikë hungarezë, të udhëhequr nga Dr. Erdei Balint, President i Shoqatës së Agjensive Hungareze të Udhëtimit, në fund të një turi 5 ditor në Shqipëri. Durrësi, Shkoder, Berati, Kruja, Vlora, Saranda e Gjirokastra ishin disa nga destinacionet e vizituara prej tyre duke ofruar për ta një peisazh të shumëllojshëm. Të befasuar nga Shqipëria për të cilën nuk kanë informacion sa duhet, përfaqësuesit e operatorëve turistikë hungarezë po mendojnë mënyrat se si ta bëjnë vendin tone një destinacion të shitshëm për hungarezët ndërsa këta të fundit preferojnë aktualisht Kroacinë për shkak se është shumë pranë tyre.

“Kaluam 5 ditë fantastike në Shqipëri. Kështu ishte për të gjithë. Nuk ka shumë informacion për Shqipërinë në Hungari. Ne e denim që ishte një vend që shtrihej në pjesën jugore të Europës. Mikpritje fantastike, njerëz shumë të këndshëm dhe miqësorë ndërsa na shërbeu kudo një staf i kualifikuar, si shoferi i autobuzit, guida që ishte shumë i mprehtë apo stafi i hoteleve ku qëndruam,” thotë Balint.

Hungaria nuk ka det, shton ai, as male të larta. Për ne Hungarezët, është fantastike të shohim det. Aktualisht, Kroacia është shumë popullore për Hungarezët sepse është pranë nesh.



Mbetet destinacioni ynë i parë. Por Shqipëria nuk është shumë larg nga ne. Opsioni do të ishte për ne nëse do të kishte një fluturim direkt midis Tiranës dhe Budapestit. Jam i sigurtë se një linjë direkte fluturimi midis dy vendeve do ti jape një shtyrje të madhe.

Në fakt, autoritetet përkatëse të Shqipërisë dhe Hungarisë po studjojnë mundësinë e vendosjes së linjës sajrore me kosto të ulët Wizzair për të mbuluar udhëtimet midis Budapestit dhe Tiranës dhe anasjelltas.

*“Jam i sigurtë se Shqipëria do të kthehet në një të ardhme të afërt në një destinacion të zhvilluar shumë shpejt jo vetëm për Hungarinë por për të gjithë të huajt nga vendet e tjera,” nënvizon Balint.*

Mbas këtij udhëtimit, lind natyrshëm pyetja: Kush janë hapat pasues? Shumë agjensi udhëtimi hungarezë e kanë tashmë produktin final dhe është një product i mirë.

Por Si mund ta shesim atë? Duhet promovim dhe një linjë direkte midis dy vendeve tona,” nënvizon Presidenti i Shoqatës së Agjensive Hungareze të Udhëtimit.

Nga ana tjetër, Attila Hajdu, drejtues i agjensisë turistike – Sta Travel - mendon se një infrastrukturë më e zhvilluar dhe vendosja e një linje direkte midis dy vendeve tona do të largonte rrezikun e ndalimit të Hungarezëve në Kroaci apo Mal të Zi. “Nëse hungarezët nisen me makinë për të ardhur në Shqipëri, mbetet rreziku që ata të qëndrojnë në Kroaci apo Mal të Zi si destinacione më të afërta,” thotë Hajdu.

lidhje e dukshme midis dy vendeve tona ishte Konjaku “Skëndërbeg” që gjendej në dyqanet e Hungarisë. Por sot, ka shumë më shumë dhe më shumë se sa ne prisnim,” thotë Hajdu.

Sipas tij, edhe pse madhësia e vendit nuk është e madhe, ai ka male të mëdha që e bëjnë vendin të duket i madh. “Ju keni një natyrë të shumëllojshme. Në zonat e ulëta keni toka bujqësore ndërsa nëpër male, një fauna dhe florë të shumëllojshme. Gjithashtu keni edhe plazhet të cilat ne nuk i kemi në Hungari,” thotë Hajdu.

Hungarezi është befasuar nga bukuria e veçantë e Beratit dhe Gjirokastrës porse ka edhe një këshillë. “Do të ishte mirë të mos lejohej aq shumë trafik dhe lëvizje makinash midis rrugëve karakteristike tradicionale në këto vende sepse godinat dhe ndërtesat aty pranë janë të ekspozuara ndaj rrezikut,” thotë ai.



Edhe përfaqësuesja e Theo Tours Ltd. është e befasuar. “Hera ime e parë në Shqipëri dhe kam rënë në dashuri me vendin tuaj. Më pëlqen kaq shumë peisazhi juaj. Është i mrekullueshëm. Ushqimi fantastik dhe shërbimi nëpër hotele mjaft i mirë. Programi që ne ndoqëm ishte shumë i pasur. Ajo që mbetet tani është thjesht të punojmë lidhur me detajet e gjetjes së një rruge më të shkurtër dhe më pak të kushtueshme për të ardhur në Shqipëri,” nënvizion ajo.

Sipas saj, vendi karakterizohet nga një kombinim i të vjetrës me modernen. “I jep një aromë autentike këtij vendi. Uroj ta ruani këtë aromë sepse kjo është Shqipëria,” përfundon ajo.







### Egerin Braçe

Guidë në Klubin "Discover Albania"

Fotot: Adis Shera © Klubi "Discover Albania"



**Gjithçka nisi me një telefonatë të Ismailit** vetëm një natë përpara: "Çfarë do bësh këtë fundjavë?". Kaq mjafton! Egerini është kurdoherë gati. Asnjë plan, asnjë përgatitje, të ndihmuar vetëm nga ndonjë ditë ekstra pushim nga puna e përditshme për shkak feste dhe aventura fillon. Në fakt ideja në ndryshim nga itinerari është shume e qartë, ngarko bicikletat në makinë dhe shëtit Ballkanin. Për të tjerat nisemi njëherë pastaj shohim e bëjmë. **Ne jemi guida të Klubit "Discover Albania"** dhe guidat e Klubit dinë t'i dalin zot çdo situatë. Nëpër çanta nuk mungon asgjë, sepse një guidë është gjithmonë gati, duke filluar me rrobat për çdo situatë dhe duke përfunduar te veglat për biçikletën. Dy gjëra këto që u treguan të domosdoshme gjatë udhëtimit tonë. Makina është e mbushur plot e përplot, biçikletat janë bërë fije-fije në mënyrë që me vështirësi të sigurohet vendi për tre pasagjerë.

Kjo sepse destinacioni i parë është Ohri ku rastësisht ndodhet një miku ynë i cili edhe ai është gjithmonë gati për aventura të tilla. Adisi me dronin e tij do bëjë të mundur që këto dite të mbeten gjatë në kujtesën tonë. Patjetër që të jesh buzë liqenit të Pogradecit dhe të mos bësh një xhiro me biçikletë nuk do të kishte kuptim. Edhe pse plani gjatë rrugës është bërë për të fjetur në Prishtinë, 400 km larg na Tirana, nuk mund t'i rezistonim këtij tundimi. Prandaj Adisi ka dalë në Qafë Thanë dhe është gati për të marrë makinën dhe për të na ndjekur hap pas hapi kudo nga do shkojmë. Zbritja nga Qafë Thana na siguron adrenalinën e duhur me kthesat e saj gjarpërushe ndërsa segmenti për në Pogradec e më tutje, Tushemisht, ofron relaksim e garantuar nga Liqeni i Dritës. Një përshëndetje me teto Ollgën dhe shkojmë për të kaluar për herë të parë kufirin mbi biçikleta, tashmë edhe pak na ka mbetur për në Shën Naum ku plotësojmë 32 kilometrat tona të para. Qetësia e tij na çlodh





# Rreth e qark Ballkanit... me biçikletë



dhe jemi gati për të vazhduar rrugën.

Prishtina na ofron tjetër profil, një qytet i mbushur plot me rini dhe me club-et që vlojnë nën tingujt e muzikës, por ne pavarësisht se nuk mund t'ia mohojmë vetes të drejtën për pak argëtim, duhet të jemi të freskët për ditët në vazhdim, na pret rrugë e gjatë.

**Dita e dytë** na çon në drejtim të Pejës ku çmenduria fillon me miqtë tanë aty, që na mundësojnë të bëjmë zip line, përpara se të marrim rrugën drejt Malit të Zi. Këtë radhë kalojmë doganën kosovare dhe shkojmë deri në qafë të Malit të Zhlebit, ku ndodhemi 1800 m mbi nivelin e detit dhe lëshohemi për në fshatin më të afërt, të quajtur Rozhajë. Shpejt hovin na e ndalon dogana malazeze e cila tregohet shumë e kujdesshme ndaj të gjitha pajisjeve që kemi me vete.

Rruga është pak e lagur nga shiu por asgjë për t'u shqetesuar, madje një pyll i dendur dhe gjelbërim pa fund na shoqëron në këtë zbritje deri në qytezën alpine të Rozhajës ku rruga merr një malore të lehtë por shumë

të përballueshme. Tashmë dritës së diellit pak nga pak po i vjen fundi ndaj e mbyllim me 29 km për sot. Pasi ngarkojmë përsëri biçikletat nisemi drejt zonës mjaft të njohur shqiptare të Plavës dhe Gucisë. Përsëri si në Prishtinë, edhe këtu nuk mund të mungonte një përshëndetje e shpejtë me jetën e natës, kjo edhe për shkak se në hotelin tonë zhvillohet një dasëm. Ç`rastësi e bukur!

**Udhëtimi i ditës së tretë** mund të themi me plot gojën që është edhe më piktoresku. Nisja bëhet nga Plava dhe duke përshkruar gjithë bregun e liqenit të Plavës, arrijmë në Guci, për nga ku nisemi në drejtim të fshatit Vuthaj. Rrugës ndalojmë dhe freskohemi të krojet Ali Pashë Gucisë dora vetë, ku rastësisht na kap syri një kotele të vogël e cila qëndronte sipër rrjedhës së ujit. Fatmirësisht dashuria jo vetëm për natyrën por edhe për kafshët, që na karakterizon të gjithëve ne çdunat dhe gocat e Klubit, na





shtyn të shkojmë ta shpëtojmë. Po çfarë mrekullie vumë re aty! Kotelja po qëndronte aty jo se nuk kalonte dot por sepse motra e saj kishte rënë në ujë dhe nuk po dilte dot. E vogël sa me s`ka por instiktet e saj shfaqen kur në tentativë për të mbrojtur motrën, lëshon një klithmë e cila presupozohet se do të na frikësojë. Pasi i bashkojmë motrat e vogla dhe bëjme fotot e rastit, i drejtohem i Ujëvarës së Gerlës, e cila është me të vërtetë mbreselënëse. Ky vend të "detyron" ta ngresh dronin dhe Adisi nuk pret më shumë po hap valixhen dhe fluturimi mbi ujëvarë ndiqet me vëmendje nga të gjithë ne. Tashmë rrugës së shtruar i ka ardhur fundi dhe është momenti për t`i shfrytëzuar në maksimum mountainbike-t tona. Drejtimin e kemi marrë për tek Syri i Kaltër i Skafkacit, por pak më tej dallohen Alpet Shqiptare, ato të Malësisë së Thethit. Metrat e fundit që të zbresin te Syri janë të shtruara me dërrasa, të cilat për shkak të lagështirës janë të rrëshqitshme. Por ashtu siç thuhet rëndom nëpër filma me aksion, ne "Rrezik" kemi emrin e pagëzimit dhe mbi të gjitha edhe për të rënë duhet aftësi më vete.

Pasi kthehem përsëri në Guci, këtë radhë kthehem në të majtë në drejtim të kufirit Shqiptar. Tashmë kjo është hera e tretë që e kalojmë kufirin mbi biçikleta dhe ja tek jemi kthyer përsëri në Shqipëri pasi kemi përshkuar tre vende të tjera si Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi. Por aventura jonë nuk mund të mbyllet me kaq. Rrugës për në Vermosh, Kanioni i Bashkimit, i cili kalohet nëpërmjet një ure me dërrasa, është një pikë tjetër ku ia vlen të ndalosh. Këtë ditë e mbyllim me 46 km dhe akomodohemi në prej bujtinave, aq mikpritëse të Vermoshit, ku dhe ushqimi është shumë i shijshëm, me produkte natyrale alpehe. Në lokalitë e fshatit përshtypje të bën se si miqtë respektohen dhe sajdisen nga të gjithë.

**Dita e katërt** është edhe më e vështira, nisja bëhet nga Tamara, nga ku




fillojmë zbritjen në një rrugë të pashtuar në të cilën bicikletat ia kalojnë edhe makinave dhe kur rruga e re e saposhtuar fillon na jep mundësinë të arrijmë shpejtësi marramendëse prej 70 km/h. Pasi kalojmë Selcën dhe Tamarën, përpara nesh shfaqen Leqet e Hotit. Leqet e Hotit nuk janë për këdo, vetëm kur i sheh nga poshte të vjen ndërmend t`i zbresësh biçikletës dhe t`i hipësh makinës. Por jo ne! Për ne vërtet ka rëndësi rruga, por ka rëndësi edhe të arrih në majë. Këto 60 minuta për të përshkuar 6 km ngjitje janë një sfidë me vetveten, një sfidë fizike por edhe psikologjike.





Për ture në të gjitha stinët:  
To book tours in every season:



KLUBI "DISCOVER ALBANIA"

Te.: +355696583870

+355 69 40 40 333

info@discoveralbanianow.com

www.discoveralbanianow.com



Në këtë rrugë gjarperuese syte i kemi gjithmonë për nga maja dhe me mendje jemi duke i bërë "countdoën" kthesave. Sytë e njerëzve brenda makinave që na kalojnë pranë janë plot habi, dikush të jep zemër, dikush të ofron të mbahesh të makina e dikush të flet në anglisht duke kujtuar se je turist i huaj. Por ne do ia dalim vetë, ndihma e vetme që ne duam është uji, në mënyrë që mos të "djemim motorr". Dhe ja ku shfaqet maja, këmbët nuk i ndiejmë më dhe fryma po na merret por një britmë e fuqishme na del nga shpirti në momentin që e arrijmë atë. Kjo nuk është shprehje patetike por një ndjesi e provuar vërtet, duhet të jeni edhe ju në të njetin pozicion që të kuptoni për çfarë po flasim. Kur shohim majnë, forcat na ripërtërihen, harrojmë ç' kemi kaluar dhe tashmë papritur biçikleta është në ajër mbi kokë duke pozuar në ballkonin panoramik, për ta bërë të pavdekshme këtë arritje. Dhe si për të zëvendësuar shampanjën që përdoret në raste të tilla, fillon papritur fillon breshëri, një breshër aq i vrullshëm sa të vret. Por ne as kjo nuk mund të na ndalojë dhe ashtu siç jemi të lagur e të bërë qull, vazhdojmë zbritjen për në Han të Hotit, ku e mbyllim ditën e katërt dhe të fundit pasi kemi përshkuar 54 km. **Në këto katër dite kemi pedalar 161 km në 4 vende të ndryshme**, kemi sfiduar veten, kemi shijuar natyrën e mrekullueshme, kemi takuar njerëz të rinj e kemi kaluar mire në shoqëri. **Një aventure kjo që do të mbahet mend gjatë e, të cilës, kur ta përsërisim për të tjerët, për ata që do guxojnë, do t'i referohemi si Bike Tour i Ballkanit.**





# The Mysterious South... put in the lenses of international visitors

Mountain bikers rolling down the hill

*Albania's southern coast [the Riviera and the hinterland] stands for extraordinary nature combined with cultural heritage and overwhelming sceneries of the Ionian Sea. The wonderful landscapes, also due to differences in altitudes of over 1500 meters, combined with the rich variety of habitats and the archaeological heritage from Illyrian, Greek, Roman and Ottoman rules make the southern coast – this recently discovered and yet unspoiled destination -an important region for the national economy.*

## The International Press and Tour Operators trip...

In June 2016 a group of German journalists and tour operators visited the South, to not only enjoy the amazing landscape choreography where the sea and the mountains meet in a perfect harmony, but to see the treasures of a prominent cultural and architectural heritage, and cherish

the culinary specialties as well. The Mysterious South presents a variety of enjoyable experiences; it offers the opportunity to hike and bike from the mountain toward the sea, visit some highlights of architectural and culture heritage, swim and taste the delicious and tasteful local products, even within a day, if one likes...





## Hiking & Mountain Biking

The trip was quite colorful, including a series of diverse activities every day. The journalists and tour operators hiked in different locations, from Kudhës to upper Qeparo, and through the village, they walked down the scenic coastal trail to Gjipe beach; they visited cultural heritage attractions in the old villages of Dhërmi and Himara. In addition, they lived the extremely exciting experience of biking - rolling down the hills - from Pilur, which is widely known as 'the balcony over the coast', to Himara....

## Culinary Tourism

Delicious local products and good cuisine accompanied the journalists and tour operators during their entire trip. They tasted sea food and had the delicious local products of Qeparo [the olives and their oil, the beautiful lemon, the dried and season fruits, fresh vegetables, local wine and yogurt drink], enjoyed the traditionally cooked food from Kuç [traditional corn bread, the fresh goat cheese-shtalpe- and sheep butter, arapash -traditional corn flour cream with cheese], drank the "strong" drink of raki, and not to forget the homemade ice-cream of goat milk. The meal the visitors had in every place they went to was local, contextual, cooked in traditional ways ... but cured with the modern / contemporary touch, aiming to give the real Taste of the South!

## Culture Tours in Himara region

Each and every village of Himara/Albania is a jewel; while all the villages together, along the coast and in the hinterland, present a huge potential for the sustainable tourism development. During their trip in the South the journalists visited walking through the old town of Dhërmi, visiting one of the oldest churches, the St. Many Church and talked to the local inhabitants. They also visited Himara Castle, Old Qeparo and the Villa of Ali Pasha in Qeparo, while the Castle of Ali Pasha in Porto Palermo, a very important cultural asset, became

the venue for the Market Forum on June 10<sup>th</sup>.

Last but not least, they had the opportunity to listen to one of the most identifiable cultural elements maintained by residents of Himarë, Pilur and the whole region, the Iso-polyphonic singing categorized as a part of UNESCO's "intangible cultural heritage" in 2005.

Since some time now, 15 Himara Villages finally have their own guide booklets aiming to present and promote their values and attract culture travelers. A professional photographer captured the most unique and identifying features of the villages, while a scholar/historian described them from their roots and history, to the setting, urban fabric, architecture and economic activities... The images and words were put together to present a teaser of this beautiful, still undiscovered place which reserves stories and culture assets...

## Facts

The International Press & Tour Operators' Trip in Albania was made possible with the support of GIZ, on behalf of the German Government, through the "Integrated Sustainable Development of the Southern Coastal Region" programme, in collaboration with NTA (National Tourism Agency), Municipality of Himara, Ministry of Urban Development, National Territorial Planning Agency, Ministry of Culture, and other stakeholders. The programme aims to improve the conditions for the rural population in the region to profit from the sustainable developments of tourism.

The journalists are already writing articles in international newspapers and magazines about the Mysterious South as a destination offering remarkable experiences, while tour operators are including this region in their offers for 2017 and onwards.

*Text & Photography:*

*'Integrated Sustainable Development of the Southern Coastal Region' programme team/GIZ*





# Jugu i mistershëm...

## prej këndvështrimit të vizitorëve ndërkombëtarë

Qeparo fshat

*Brigjet jugore të Shqipërisë [Riviera dhe zonat e thella] paraqesin një natyrë të jashtëzakonshme e ndërthurur me pasuritë kulturore dhe fushëpamje fantastike të detit Jon. Peizazhet e mrekullueshme, edhe për shkak të ndryshimit në lartësi që shkon deri në 1500 metra mbi nivelin e detit, ndërthurur me një shumëllojshmëri vendbanimesh dhe trashëgimisë arkeologjike prej periudhave Ilirike, Greke, Romake dhe sundimit Osman e bëjnë bregun jugor-këtë destinacion së zbuluar rishtazi por ende të paprekur-një rajon tepër të rëndësishëm për ekonominë kombëtare.*

### Brugëtimi i Shtypit Ndërkombëtar dhe Operatorëve Turistikë

Në Qershor të 2016 një grup gazetarësh dhe operatorësh turistikë gjermanë vizituan Jugun, jo vetëm për të shijuar kompozimin mahnitës të peizazhit ku deti e vargjet malore

takohen në harmoni të përkyrer, por për të vështruar thesaret e një pasurie të spikatur kulturore e arkitekturore si dhe për të mbajtur gjallë specialitetet gastronomike. Jugu i Mistershëm paraqet një shumëllojshmëri eksperiencash të pëlqyeshme; ofron mundësinë për të bërë ecje e çiklizëm malor që prej malit drejt detit, të





vizitosh pika më interesante të pasurisë kulturore dhe arkitekturore, të notosh dhe të shijosh produktet lokale mjaft të shijshme, edhe brenda ditës nëse ndokush dëshiron...

### Ecje dhe çiklizëm malor

Udhëtimi ishte mjaft i gjallë, duke përfshirë një sërë aktivitete të shumëllojshme çdo ditë. Gazetarët dhe operatorët turistikë përshkruan në këmbë vendndodhje të ndryshme, që prej Kudhësit drejt Qeparoit dhe përmes fshatrave, ecën teposhtë shtegut piktoresk bregdetar drejt plazhit të Gjipe-së; ata vizituan atraksionet e trashëgimisë kulturore në fshatrat e vjetër të Dhërmiut dhe Himarës. Po ashtu, ata përjetuan eksperiencën tepër emocionuese të çiklizmit malor-duke u rrokullisur teposhtë kodrave-prej Pilurit, i cili njihet gjerësisht si “ballkoni mbi breg” drejt Himarës...

### Turizmi Kulinar

Produkte lokale tepër të shijshme dhe kuzhinë e mirë i shoqëruan gazetarët dhe operatorët turistikë përgjatë gjithë udhëtimit të tyre. Ata shijuan ushqimin e detit dhe patën mundësi të provonin produktet lokale të Qeparoit (ullinjtë e vajin e tyre, limonët e mrekullueshëm, frutat sezonale e të thata, perime të freskëta, vera vendase si dhe dhallë), shijuan ushqimin e gatuar në metoda tradicionale të Kuçit (bukë misri tradicionale, djathë të freskët dhie-shtalpe-dhe gjalpë delesh, arapash-miell misri tradicional me djathë), pinë pijen e fortë të rakisë, e mos të harrojmë akulloren e bërë në shtëpi prej qumështit të dhisë. Vaktet që udhëtarët patën në çdo vend që përshkruan ishin lokale e të gatuar në metoda tradicionale por të kuruara me një prekje bashkëkohore, me qëllimin për të dhënë shijen e vërtetë të Jugut!

### Turet Kulturore në rajonin e Himarës

Gjithsecili prej fshatrave të Himarës/Shqipërisë është një xhevahir; ndërsa tërë fshatrat bashkë, përgjatë bregut dhe në zonat e thella, paraqesin mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Përgjatë udhëtimit të tyre në jug, gazetarët përshkruan në këmbë fshatin e vjetër të Dhërmiut, duke vizituar një prej kishave më të vjetra, Kishën e Shën

Mërisë dhe biseduan me banorët vendas. Ata gjithashtu vizituan Kalanë e Himarës, Qeparoin e vjetër dhe vilën e Ali Pashait në Qeparo, ndërkohë që Kështjella e Ali Pashës në Porto Palermo, një pasuri kulturore me shumë vlera u kthye në vendngjarjen e Forumit të Pazarit më 10 qershor. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja ata patën mundësi të degjonin një prej elementëve më karakteristike identifikues të ruajtur prej banorëve të Himarës, Pilurit e të gjithë rajonit, kënga iso-polifonike e kategorizuar si pjesë e “pasurive kulturore shiptërore” të UNESCO në 2005.

Që prej disa kohësh, 15 fshatra të Himarës kanë guidat e tyre, me qëllimin për të paraqitur e promovuar vlerat si dhe për të joshur udhëtarët kulturorë. Një fotograf profesionist arriti të kapë tiparet më të veçanta e identifikuese të fshatrave, ndërkohë që një historian i përshkroi ato që prej rrënjëve e historisë e deri tek vendndodhja, indi ubran, arkitektura dhe aktivitetet ekonomike. Imazhet e teksteve janë pranëvënë për të paraqitur një ngacmim për këtë vend të bukur por ende të pazbuluar i cili rezervon histori e pasuri kulturore.

### Fakte

Udhëtimi i shtypit ndërkombëtar dhe operatorëve turistikë në Shqipëri u mundësua falë mbështetjes së Qeverisë Gjermane, përmes programit “Zhvillimi i Integruar i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor në bashkëpunim me AKT (Agjencia Kombëtare e Turizmit), Bashkinë e Himarës, Ministrinë e Zhvillimit Urban, Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Ministrinë e Kulturës si dhe palëve të tjera të interesuara. Ky program ka për qëllim të përmirësojë kushtet e popullsisë rurale në rajon për të përfutur prej zhvillimeve të qëndrueshme të turizmit. Gazetarët janë tashmë duke shkruar artikuj në gazeta e revista ndërkombëtare mbi Jugun e Mistershëm si një destinacion që ofron eksperiencë të jashtëzakonshme, ndërkohë që operatorët turistikë po e përfshijnë rajonin në ofertat e tyre për 2017-ën e më tej.

*Tekst & Fotografi:  
Ekipi i Projektit “Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm  
i Rajonit Bregdetar Jugor” /GIZ*





# Fation Plaku

## alpinisti fotograf i majave të larta



Kur në vitin jo aq të largët 2012, një grup alpinistësh shqiptarë pushtuan majën më të lartë të botës, Everestin, për të valëvitur atje flamurin shqiptar në vigjilje të 100-vjetorit të Pavarësisë, midis guximtarëve ishte edhe Fation Plaku. Asokohe, ky grup alpinistësh fitoi simpatinë e të gjithëve, dha intervista nëpër media (vetë Fationi dha një intervistë për revistën Travel) e u ftuan nëpër emisione televizive. E megjithatë, atëhere nuk flitej aq shumë për Fation Plakun, sa flitet sot.

Nëse jeni lundruer të internetit dhe përdorues të rrjeteve sociale, sidomos Facebook e Instagram, është e vështirë të mos e keni hasur një foto të Fation Plakut. Foto nga ato që i sheh njëherë e të nguliten në mendje, që nuk i ngatërron dot me të tjera, ndonëse sot interneti është mbushur plot me foto nga Shqipëria, të bukura e të zakonshme, të rastësishme e të bëra me kujdes, në çdo cep të Shqipërisë. Por Fationi është bërë tashmë edhe personazh i zakonshëm i programeve televizive që trajtojnë temat e turizmit, fotografisë, udhëtimit në natyrë apo sporteve ekstreme.

Në fakt, udhëtimet, ecjet në natyrë dhe eksplorimi apo zbulimi i vendeve të reja, ka qenë pasion i hershëm që ashtu siç na thotë edhe vetë Fationi, ka njëzet vjet që e ndjek nga pas dhe i "vjedh" kursimet. Por vitet e fundit në listën e pasioneve hyri edhe fotografia dhe të gjitha pasionet e tjera të

tij u bënë më të dukshme me dokumentimin nëpër fotografitë, që sot nuk i numëron dot më, se sa mijëra janë bërë. Dhe "hajdut" i kursimeve u bë edhe aparati fotografik bashkë me të gjithë aksesorët e tij, mundësisht të fjalës së fundit apo edhe të gjitha shpikjet që sot zëvendësojnë çdo ditë njëra-tjetrën për të thyer kufijtë e mënyrave të fotografimit.

Dhe që nga momenti që Fationi mori aparatën në dorë, Shqipëria u bë më e dukshme, më e pranishme, madje "bombarduese" në botën e internetit. Dhe jo me foto dosido, por me imazhe që pak ose aspak ishin shfaqur më parë, për arsye e thjeshtë se shkrepeshin nëpër vende të pashkelura ose fare pak të zbuluara deri atëherë. Me "selfiet" e famshme tashmë të kthyer në modë, shumica e internetasve nxirrin kryesisht fytyrën, e shumta pjatën e ushqimit nëpër tavolinat e restoranteve. Kurse pas kurrizit të Fation Plakut filluan të shfaqeshin majat e maleve të Shqipërisë që nuk ishin parë gjer atëhere, guvat e thella poshtë shkëmbinjve të Kanioneve të Osunit e Lengaricës, shpellat ujore e nënujore të gjireve të Vlorës, plazhet e virgjëra të Karaburunit, kamanaret e kishave të humbura e siteve arkeologjike të pashkelura...

Dhe kur Shqipëria gradualisht u zvogëlua e të fshehtat e saj më të shumta e pikat më ekstreme ishin thujse zbuluar, i erdhi radha Kosovës. Sigurisht edhe atje, majave më të larta e udhëtimit ekstreme.

Por pushtimi i majave të larta nuk është një sport që ushtrohet vetëm në Shqipëri. Dihet që majat më të larta ndodhen nëpër botë. Everestin e pushtuam të parin që në vigjilje të 100-vjetorit të Pavarësisë. Mirëpo flamuri i shqiptar ishte shumë i bukur dhe ishte mëkat të mos e valëvisje edhe nëpër ca maja të tjera. Kështu njëra pas tjetrës nën këmbët e Fationit u "nënshtruan" edhe Tibeti, Akonkagua, Elbrusi, Kilimanxharo...

E ndonëse i pëlqen fort të pushtojë majat, ekploron em po aq dëshirë edhe guvat, shpellat, luginat e thella të lumenjve rrjedhat e ashpra, ecjet e vështira. Gjithçka që të jep adrenalinë është e pëlqyeshme për të dhe eksperimenti me sportet ekstreme luhet vazhdimisht mes alpinizmit, ngjitjeve të vështira, surf-it, rafting, përkshimit të rrymave të egra me kajak, e sërish i kthehet majave.

Sot ai vetë nuk e ka idenë se sa foto ka shkrepur. U bënë tashmë ca vite të mira që bredh me aparat në krahë, dhe ndonëse pasioni i kushton goxha, mes udhëtimit dhe blerjes së pajisjeve të teknologjisë, nuk ka ndër mend





të heqë dorë. Madje e ka mbledhur mendjen të botojë edhe një album me fotot më të bukura që ka bërë deri tani. Kjo sepse shpeshherë ia përdorin pa leje dhe kjo e mërzit, sidomos kur ndodh edhe me institucionet shtetërore ose kompani të mëdha që mund të paguajnë. Por sot është epoka e internetit dhe në një vend si Shqipëria është misioni i pamundur të ruash të drejtën e autorit. Ndërkohë misionet e tjera, të udhëtimeve dhe fotografisë, do të vazhdojnë edhe për një kohë shuumë të gjatë....



**Faton Plaku ka lindur në Tiranë 09 Dhjetor 1975, është diplomuar në shkencë politico-administrative. Ka ngjitur me sukses 4 majat më të larta të 4 kontinente Everestin 8848m, Tibet, Kinë, Aconcaguan 6962m, Argjentine, Elbrusin 5642m. Rusi dhe Kilimanjaron 5895m. Tanzani, Afrikë.**

## **Majat që ka ngjitur Në Shqipëri dhe Kosovë**

**Jezerca 2694 m, Alpe  
Korabin 2753 m, Dibër  
Radohima, Alpe  
Gjallica, 2489m, Kukës  
Koritniku, Kukës  
Shkëlzeni, Tropojë  
Maja e Shtyllës, Tropojë  
Vajusha, Kelmend, Lëpushë  
Rosini, Tropojë  
Maja e Hekurave, Dragobi, Tropojë  
Çardaku, Bogë, Malësi e Madhe  
Tomorri 2416m, Berat  
Ostrovica, Korçë  
Gramozi, 2525 m, Ersekë  
Këndrevica 2122 m, Kurvelesh  
Nemerçka 2485m, Përmet  
Dajti 1612 m, Tiranë  
Mali me Gropa 1827 m, Tiranë  
Mali i Snoit, Bizë. Tiranë  
Valamara 2373m, Grabove, Gramsh  
Maja Pusit, Mali i Thatë 2288m, Pogradec  
Maja e Qorres 2018m, Vlorë  
Mali Çikes 2048m, Llogora, Vlorë  
Mali i Buretos, Gjirokastrë  
Mali i Dhëmbelit 2050 m, Përmet  
Mali i Fagut, Tiranë  
Mali i Bukanikut, Elbasan  
Mali Polis, Elbasan  
Mali i Shebenikut, Librazhd  
Mali Gjeravicës 2656 m, Junik, Kosovë  
Mali i Bistrës, Kosovë**



# Zgjidh pesë nga aventurat më të mira shqiptare

## Dillon Thompson

Shqipëria, e cila shtrihet në bregdetin Adriatik të Gadishullit Ballkanik në Europën Juglindore, është pak më e madhe se sa Massachusetts. "Vendi është shumë i vogël, por shumë i larmishëm", - thotë Auron Tare, udhëheqësi i Ekspeditës sonë, një agjenci shqiptare që ofron udhëtime në vend. "Brenda një ore ju mund të gjendeni në vende krejtësisht të ndryshme."

Por kuptimi më i gjerë i Tares është ky: ky vend i vogël arrin të të befasojë menjëherë. Që nga Alpet shqiptare të veriut, bregdetit të gjerë në perëndim dhe zonës rurale në brendësi, është i lehtë shijimi i të gjitha peizazheve, pa udhëtuar gjatë.

Tare ka qenë i përfshirë në turizmin shqiptar që kur kjo industri filloi të lulëzojë – ai madje ndihmoi në krijimin e Sitit të parë Trashëgimi Botërore UNESCO - dhe kompania e tij ka drejtuar ekspedita që prej 22 vitesh. Në vitin 2014 Tare u zgjodh për të drejtuar Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të Shqipërisë dhe gruaja e tij Nancy mori kontrollin e operacionit, duke vazhduar misionin e kompanisë për të treguar diversitetin e vendit nëpërmjet autenticitetit të vet, eksperiencat e veçanta në llojin e vet.

Udhëtimet e Ekspeditës mishërojnë shpirtin e larmisë së Shqipërisë në mënyrë të përkryer, duke organizuar ekskursione në monumentet historike, mrekullitë natyrore dhe destinacionet kulturore në të gjithë rajonin. Webfaqja e kompanisë aktualisht liston më shumë se 20 ture në dispozicion, por ne na pëlqyen pesë.

## 1. Udhëtimi me kalë i Lord Bajronit

Në gjurmët e poetit legjendar anglez, që më 1809 udhëtoi mbi kalë nëpër Shqipëri. Gjurmëve të Lord Bajronit nuk e teproni me luks. Si shpjegon Tare, "Lord Bajroni" ishte ekspedita e parë me guidë për kompaninë e tij, meqënëse ishte kryesisht për turistë aventurë, të cilët nisën të ndërmarrin udhëtimet e para të gjata në Shqipëri gjatë periudhës post-komuniste të më të viteve 1990.

Pjesëmarrësit në guidë kalojnë tetë ditë dhe nëntë netë të alternuara mes tendave të kampingjeve dhe Hotel Çajupit në Gjirokastrë, i cili në fakt, shërben si bazë për ekspeditën. Gjatë ditës, guidat prijnë përmes gjurmëve të famshme të Bajronit, duke kaluar nëpër manastire, kështjella dhe site historike.

## 2. Via Egnatia

Me fillim në brigjet e Adriatikut dhe duke u shtrirë përgjatë gjithë rrugës së bregdetit Egje të Greqisë, ekspedita e Via Egnatia ndjek udhën e lashtë romake me të njëjtin emër. Me prijësin e vet perandorak, gjurma ishte rruga më e populllore midis Romës dhe Konstandinopojës, që do të thotë se turistët në të vërtetë ecin në gjurmët e figurave të tilla, si: Bruti, Mark Antoni dhe Ciceroni, po ashtu sikurse ata udhëtonin nga Durrësi i Shqipërisë drejt Selanikut të Greqisë.





Via Egnatia është një guide ideale, duke u ofruar vizitorëve mrekullitë natyrore të tre vendeve shumë të veçanta - Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë, me ndalesa në rrënojat fqinje, kishat dhe Liqenin e Ohrit të lashtë dhe mahnitës të mbrojtur UNESCO. Megjithatë, Tare gjen tiparin më të fortë të udhëtimit, që për shkak të ecjes tetë ditore nëpër fshatrat autentike e zemërbardë të Gadishullit të Ballkanit, ofron një pamje relativisht të paprekur të kulturës lokale.

### 3. Shqipëria e Veriut

Si një vend që ende po përpiqet të bëjë një emër të vetin në tregun botëror të turizmit, Shqipëria e ka vënë theksin sidomos te mikpritja. "Vizitorët vijnë dhe shohin se sa mikpritës, të ngrohtë dhe të qetë janë njerëzit" - thotë Tare. "Në përgjithësi ata kthehen në shtëpitë e tyre me një ndjenjë të mirë." Prurja e vizitorëve në majën më veriore të vendit, aty ku Alpet shqiptare rriten ashpër mes peisazheve të gjelbra, ekskursioni në Shqipërinë Veriore është para së gjithash kurimi i një atmosfere miqësore. Pushuesit kalojnë katër netë në bujtina malore, duke zgjedhur ushqime tradicionale dhe duke eksploruar thellësitë e Parkut Kombëtar të Valbonës.

### 4. Parku Kombëtar i Butrintit

Butrinti, i quajtur shpesh "Troja e vogël" për rrënojat e tij greke të ruajtura me kujdes, është bërë destinacioni më i vizituar në Shqipëri. Lidhjet e Tares me të janë të ngushta - si Siti i parë i Trashëgimisë Botërore UNESCO, ky është vendi që ai vetë ndihmoi të zhvillohet në ditët e para të turizmit shqiptar. Aktualisht, Ekspedita ofron shëtitje njëditore në koloninë antike greke, duke i

dhënë vizitorit mundësinë të shkelë mbi këto rrënoja: amfiteatrot, harqet dhe muret e paprekura - ndërsa ecën nëpër peisazhet idilike të Parkut Kombëtar përreth. Përveç kësaj, Butrinti është vetëm 45 minuta larg nga pika e fillimit të turneut, në qytetin bregdetar të Sarandës, kështu që qëndrimi i shkurtër nuk merret me shumë nxitim.

### 5. Udhëtimi me temë komunizmin

Megjithëse nuk gërrmon në rrënojat e vjetra të mijëvjeçarit apo gjetjen e pasazheve të figurave të çuditshme, udhëtimi me temë komunizmin kthehet mbrapa në një kohë shumë më të vonë dhe interesante në historinë e Shqipërisë. Ekspedita tetë-ditore eksploron efektet arkitektonike, bujqësore, intelektuale dhe kulturore të regjimit komunist të shekullit të 20 të vendit.

Udhëtim mbulon pothuajse të gjithë vendin dhe ndalet në disa nga pikat më kryesore të udhëtimeve të tjera të Ekspeditave në Butrint e Gjirokastrë dhe përfshirë këtu edhe kryeqytetin Tiranë. Ndalesat e veçanta përfshijnë Galerinë Kombëtare e Arteve, Muzeun Historik Kombëtar, si dhe lagjen e ish-diktatorit Enver Hoxha.





*You can almost  
hear the evening fall...*




**RESORT MAVROVO**

· HOTEL BISTRA · HOTEL LODGE · HOTEL SPORT ·  
[www.bistra.com](http://www.bistra.com) [www.skimavrovo.com](http://www.skimavrovo.com)

*Welcome*





# Restaurant "PARAJSA E SHARRIT" (Sharri)



## Jeni lodhur nga zhurma e qytetit? Dëshironi t'i jepni vetes një pushim të këndshëm? Do të donit që të ndjeni freskinë e natyrës dhe të relaksoni veten tuaj?

Restaurant "PARAJSA E SHARRIT" është vendi ideal për ju. Hapësira malore, bukuritë natyrore, uji i ftohtë i Sharrit, pastërtia e ajrit, shërbimi profesional, mikpritja, janë karakteristikat që qëndrimin tuaj këtu do t'ua bëjnë të paharrueshëm dhe të veçantë dhe do të ndjeheni sikur jeni në parajsë.

Restaurant "PARAJSA E SHARRIT" ofron meny të pasur ushqimore edhe atë: peshk, ushqim tradicional, të gjitha llojet e ushqimeve në skarrë, pije freskuese etj.

E veçanta e këtij restoranti qëndron në mundësinë e organizimit të solemniteteve, takime të ndryshme biznesi, mirëpremt delegacione qeveritare, vizita të nga personalitete të shquara, si ato vendas edhe ato të jashtëm si dhe mikëpritje të ngrohtë për të gjithë klientët.

**Adresa: Lisec, Tetove  
Pronar Mazllam Hasani**

**070256 627**





# TURIZMI FETAR,

## miliona turistë e miliardë dollarë

Turizmi fetar, njohur ndryshe edhe si turizmi i besimit është udhëtimi individual apo në grup i njerëzve për qëllime pelegrinazhi, misionare ose kohë të lirë drejt qyteteve apo vendeve të tjera të shenjta. Më masivi i këtij lloji është pelegrinazhi i përvitshëm i Haxhit në Mekë të Arabisë Saudite, ndërsa në Shqipëri dallojnë pelegrinazhi në Kishën e Shna Ndout në Laç dhe ai në Malin e Tomorit në Berat.


Disa praktika të tjera të turizmit fetar janë udhëtimi me kroçerë për në vende fetare, kryqëzatat, konventat dhe mitingjet fetare, vizitat dhe qëndrimet në manastire, kampingjet në site fetare etj.

Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO), në të gjithë botën, mbi 330 milionë njerëz udhëtojnë për turizëm fetar gjatë një viti. Vetëm në Amerikën Veriore, ky lloj turizmi llogaritet se gjeneron mbi 10 miliardë dollarë të ardhura. Qytetet dhe vendet më të frekuentuara nga turizmi fetar janë Meka, Medina, Qerbelaja, Jeruzalemi, Varanasi etj.

\*\*\*

*Edhe Shqipëria ka ofertën e saj të turizmit fetar, e që shfrytëzohet kryesisht nga turizmi i brendshëm. Megjithatë Kisha Katolike e Shna Ndout në Laç dhe Tyrbja e Abaz Aliut në Malin e Tomorit në Berat gravitojnë më shumë se destinacionet tjera fetare në Shqipëri. Të dhëna jozyrtare flasin për një fluks prej mbi 200 mijë vizitorësh në vit, në secilën prej këtyre dy destinacioneve dhe një pjesë e konsiderueshme e këtij numri mendohet se janë turistë nga jashtë Shqipërisë. Vetëm në 3-mujorin e parë të 2016, shifrat flasin për një rritje prej 58% të turizmit fetar në Shqipëri, derisa dihet se të dy destinacionet e mësipërme e kanë pikun e frekuentimit në muajt Qershor dhe Gusht, që u përkasin tremujorëve të dytë dhe të tretë.*

Ndërkaq, në mesin e destinacioneve fetare të ofruara



nga agjencitë turistike shqiptare përmes paketave 7-8 ditore me çmim rreth 470 euro për person, janë edhe Kruja, Shkodra, Durrësi, Berati, Korça, Përmeti e Voskopoja.

**Përveç paketave incoming, agjencitë turistike shqiptare ofrojnë edhe paketa outgoing për turizëm fetar drejt destinacioneve të njohura në Ballkan e më gjerë. Përfaqësues të njëjës prej këtyre kompanive, "Vau i Dejës Travel" me seli në Shkodër, thonë se këto ture organizohen prej vitesh. Turet më të frekuentuara janë ata për në Medjugore të Bosnje-Hercegovinës, në Lourdes të Francës, në Padova dhe Romës të Italisë, në Jeruzalem të Izraelit etj.**

Turizmi fetar preferohet kryesisht nga moshë e mesme dhe e tretë, por drejt destinacioneve fetare në Shqipëri, nuk mungojnë as moshat e reja.





## sanatur **fotoğraf & video çekimi**

\*\*\*

Me një popullsi prej mbi 500 mijë banorësh, qyteti Shanliurfa (Şanlıurfa) në Turqi, njohur edhe si "Qyteti i Pejgamberëve" është i katërti në botë në turizmin fetar. I njohur në lashtësi me emrin Edessa, ai besohet se ruan gjurmët e disa profetëve islamë, si Ibrahim, Ejjubi, Musa dhe Shuajbi.

Sipas agjencisë turke të lajmeve Anadolu Agency, qyteti mbipopullohet sidomos gjatë muajve Rexhep, Shaban dhe Ramazan, përkatësisht muajt e shtatë, të tetë dhe

të nëntë të kalendarit islamik.

Përveç kafesë karakteristike në lokalet pranë kalasë së Urfas, turistët mund të kryejnë një udhëtim të vërtetë në histori, përmes vizitës në çarshinë e vjetër të qytetit, por edhe në Vendin e Durimit (Sabik Makami), ku pranohet se ka qëndruar profeti Ejjub. Në këtë rajon është hapur edhe universiteti i parë islam, ai i Harranit.



- \* Organizojmë Ture religjioze  
**Lourdes, Padova, Medjugorje dhe Rome**
- \* Ticketing
- \* Hotel Reservations
- \* Vacation Packages
- \* Guide (in Theth-Valbone-Vermosh)



TRAVEL AROUND

THE WORLD



Adresa:

Bulevardi Skenderbeu (pranë postës),  
Shkodër



Tel: +35522255773

Mob: +355662020555/+355667070730


E-mail: [vaudejestravel@yahoo.com](mailto:vaudejestravel@yahoo.com)

Web: [www.vaudejestravel.com](http://www.vaudejestravel.com)






# LLOGORA TOURIST VILLAGE




**Llogora National Park, Vlore, Albania**  
**Tel.: +355693344400; e-mail: info@llogora.com**  
**www.llogora.com**

Fshati Turistik Llogora ndodhet në zemer të Parkut Kombëtar Llogora. Ajo ka një sipërfaqe prej 1.2 ha. Në brëndësi të saj ndodhen 16 vila druri, hotel 4 katësh me pishinë të brëndshme, Beer Club, Tavernë, Restorant, Bar, fushë basketbolli, sallë konferencash dhe 2 salla të vogla të cilat mund të përdoren për festa të vogla familjare ose mbledhje.

Në stinën e verës kur temperaturat janë të larta në qytetet e tjera të shqipërisë, në Llogora temperatura gjatë ditës është 10 gradë Celcius më e ulët, ndërsa gjatë natës arrijnë 10-12 gradë Celcius. Kjo ju jep një freski gjatë gjithë ditës dhe një gjumë të ëmbël gjatë natës. Ndërsa në periudhën e dimrit Fshati Turistik Llogora mbulohet nga dëbora. Në brëndësi të territorit tonë shetisin të lirë drera dhe sorkadhe të cilat ju bejnë pushimet tuaja akoma më magjike.



 **Llogora Tourist Village**



# made in albania

# travel supplement



ARKA E SHIJES NE SHQIPERI  
THE ARK OF TASTE IN ALBANIA  
L'ARCA DEL GUSTO IN ALBANIA





HISTORI SUKSESI

# UKA FARM, AGROTURIZMI QE LINDI NGA SHKENCA











Puna ka filluar me mobilimin dhe drenimin e terrenit me metoda dhe praktika tradicionale, natyrale. Për rreth 10 vjet janë mbjellë kultura që kanë synuar rritjen e pjellorisë së tokës pa përdorur herbicide, plehra azotike apo sintetike, por vetëm plehrim të gjelbër dhe organik. Ndërhyrjet me pesticide sintetike janë zëvendësuar me ato botanike dhe minerale, të regjistruara për prodhim organik, shumë prej të cilave prodhohen në fermë. Për rjedhojë, prodhimi është i ulët në sasi, por me vlera të larta cilësore e shëndetsore.

## KANTINA

Ferma ka një "bërthamë" ekonomike, kantinën dhe restorantin. Flori, njeri nga djemtë e Prof. Ukës, ka mbaruar studimet e larta në UBT për Vreshtari Enologji dhe është kualifikuar për prodhimin e verës në Udine (ITALI). Ai ndjek dhe po çon më tej zhvillimin e fermës drejt agroturizmit.

Në vitin 2005 ai ka realizuar prodhimin e parë të verës "UKA". Qëllim kryesor është prodhimi i verërave të kuqe nga kultivarë autoktonë shqiptarë, si Kallmet, Shesh i Bardhë, Shesh i Zi, Mavrud, si edhe prodhimi i verës së bardhë nga kultivari unik Cerujë, me origjinë të hershme nga disa fshatra të rrethit të Matit. Më vonë, u pasurua me kultivarë ndërkombëtarë si Merlot dhe Cabernet Sauvignon. Vera, rreth 10.000 shishe në vit, shërbehet e gjitha në restorantin e ndërtuar brenda mjedisit të fermës.

## FERMA "UKA"

Është krijuar në vitin 1996, rreth 8 km pranë Tiranës, në fshatin Laknas, nga Prof. Assoc. Dr. Rexhep Uka. Ferma është ndërtuar tërësisht mbi parimet e Prodhimit të Integruar (PI) dhe mbështetet në Praktikën e Mira Bujqësore (PMB). Aty ndërthuren, gjithashtu, prodhimi organik, biodiversiteti i lartë, permakultura, biodinamika, si edhe zbatime të kontrollit biologjik të dëmtuesve. Qëllimi dhe filozofia, që në zanafillë, është krijimi i një ferme pilot, shumëfunktionale, eksperimentale, agroturistike, por edhe qendër didaktike e kërkimore- shkencore për praktikën profesionale të studentëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Synohet që brenda pak vitesh të ndërtohet edhe një kopësht botanik dhe mjekësor.

Ferma ka një sipërfaqe rreth 2 ha ku kultivohen pothuajse të gjitha kulturat drufutrore dhe perimore, por edhe ato medicinale e zbukurose, me një gamë të pasur kultivarësh të vendit dhe të huaja. Mbizotërojnë vreshti, ulliri, molla, si edhe të gjitha kulturat bërthamore (kumbull, pjeshkë, kajsi, etj.). Ferma disponon një germplazmë shumë të pasur, duke përfshirë edhe specie të rralla e në zhdukje, që tashmë janë në rrugë përmirësimi për prodhim fare, si speci i veçantë me emrin e fshatit LAKNAS, etj.

Shumë studentë, nën drejtimin e Prof. R. Ukës kanë mbrojtur diplomën me tematikë bionominë dhe entomofaunën e specieve të dëmshme e të dobishme të zonës, si edhe të atyre invazive.







## RESTORANTI "UKA FARM"

Ka ardhur si rjedhojë e natyrshme e zhvillimit të fermës dhe ka filluar në vitin 2014 si një biznes familjar. Produktet e freskëta integrale dhe organike të prodhuara aty përbëjnë bazën e menisë për një eksperiencë të vërtetë farm-to-table. Ndërthurja e ekuilibruar e kuzhinës tradicionale shqiptare me teknikat e gatimit italian janë formula ku bazohet restoranti. Tashmë, i hapur prej 3 vitesh, është kthyer në një nga pikat më të frekuentuara të Tiranës. Suksesi i restorantit "Uka Farm" është përmendur, ndër të tjera, edhe në guidën e gazetës prestigjioze 'The New York Times' dhe në kanalën televiziv gjerman 'Arte'. Për pjesën e restorantit është kujdesur djali i madh, Arbri, i cili ka studiuar Menaxhim Hotelerie në Zvicër. Djali tjetër, Bori, është arkitekt, ai është hartuesi dhe zbatuesi i projektit të restorantit, i cili, është ndërtuar me materiale natyrale dhe estetishtë në harmoni të plotë me mjedisin, klimën dhe fizionominë e fermës. Vlera e shtuar, është filozofia ekonomike e



fermës. Mbjelljet me prodhimet e tyre bëhen të gjitha në funksion të restorantit. Sot, gati 80% e tyre prodhohet në fermë dhe synohet që, brenda dy vjetësh, gjithshka që shërbehet në restorant, të jetë prodhim bio dhe integral i fermës. Për momentin, pjesa tjetër e lëndës së parë për kuzhinën sigurohet nga produkte të freskëta shqiptare të certifikuara nga zona të ndryshme të Shqipërisë, duke promovuar në këtë mënyrë prodhimet më të mira e të shëndetshme shqiptare.







# Dita e Agrobiodiversitetit në Reç

## një demonstrim i modelit të turizmit rural dhe të eksperiencave

Turizmi rural ndonëse mjaft i përhapur në Europë dhe ndonëse i përfolur shumë në Shqipëri, është një produkt i ri turistik në vendin tonë.

Karakteristika e këtij produkti - shijimi i ambientit dhe jetesës rurale kërkon një cilësi dhe kompleksitet më të madh në organizimin e ofertës dhe shërbimeve krahasuar me të zakonshmen e asaj që ofrohet deri tani në vend në turizmin e natyrës por me një mundësi përfitimi më të madhe ekonomike.

Nëse në turizmin e natyrës kemi disa dimensione kryesore : aktivitete në natyrë me pak ose më shumë aventurë dhe vështirësi fizike, relaks në natyrë apo ndjekje e interesit të veçantë si të mësuarit mbi natyrën apo vëzhgimi i jetës së egër dhe ku baza e shërbimeve dhe infrastrukturës është natyra me shumë pak ndërhyrje të njeriut, produkti i turizmit rural zhvillohet dhe në një përfshirje të aktiviteteve të jetesës rurale ku dhe mikpritja, predispozicioni për ndërvperim, cilësia apo autenticiteti janë elemente shtesë në ofertë dhe experience.

Sot turistët gjithnjë e më tepër po kërkojnë eksperiencë. Më shumë se ambientet dhe sajaset komferte , më shumë se atraksionet apo zbavitjet e programuara e të përsëritura, më shumë se fotot - detyrim për t'i pasur, eksperiencat e jetës reale janë ato çfarë po i shtynë njerëzit për të udhëtuar.

Një nivel më i pasuruar i turizmit është turizmi i eksperiencave i cili vlen dhe për turizmin rural. Angazhimi në disa përfshirje i turistëve si aktiviteti fizik, pasurimi me informacion, me njohuri, ndërvprimi, aktivizimi emocional në ambientin dhe jetën e destinacionit janë disa karakteristika të turizmit të eksperiencave.

Në numrat e mëparshëm të revistës janë trajtuar temat si agrobiodiversiteti , pjesë e turizmit rural edhe e turizmit të eksperiencave. Pikërisht aktiviteti Dita e Agrobiodiversitetit në Parkun Rajonal Shkrel, organizuar nga projekti i Bashkëpunimit Gjerman GIZ, Ruajtja e Agrobiodiversitetit në Shqipërinë Rurale ( CABRA ) në fundin e Tetorit, me një kompleks aktiviteteesh me qendër panairin e vlerave të agrobiodiversitetit në pyllin e gështenjave në Reç, ishte një demonstrim se si mund të ofrohet e organizohet oferta e turizmit rural në dimensionin e turizmit të eksperiencave .







Pikërisht vendi i përzgjedhur, fshati Reç, me vlerat e agrobiodiversitetit që zotëron, ka elementet përfaqësues të ofertës së turizmit natyror dhe rural: pylli i gështenjave, frutat e gatshme në mbledhje e sipër të gështenjës, fshati me peisazhin dhe jetesën rurale, aksesin i volitshëm në një distancë rreth 30-35 minuta nga Shkodra me 2 km e fundit tashmë të asfaltuara, dhe mundësia për aktivitete për disa segmente dhe grupmosha të vizitorëve.

Ky aktivitet shfaq disa komponentë: si në shumë panaire kishte prezantim të vlerave, të promovimit dhe ndërgjegjësimit, u ofruan mundësi të shkëmbimit midis aktorëve - ekspertë dhe fermerë, administratë publike dhe projekte donatorësh, si nga zona e parkut dhe nga zona të tjera të Alpeve, mundësoi një pikë takimi midis ofruesve të produkteve - në këtë rast të turizmit dhe produkteve të zonës dhe konsumatorëve - turistëve potenciale, nga Shkodra dhe Tirana, vizitorëve frekuentues të restoranteve të pikës turistike.

Prezantimet nga kryetari i bashkisë Malësi e Madhe z. Tonin Marinaj, drejtuesi i projektit CABRA dr. Ralf Peveling, moderatori i aktivitetit z. Luan Dervishej, specialistët e ministrisë së mjedisit, drejtuesit e drejtorisë rajonale të bujqësisë Shkodër dhe Bankës gjenetike pranë Universitetit Bujqësor, adresuan promovimin e vlerave të parqeve natyrore si mundësi për ruajtjen e biodiversitetit dhe mjedisit, ruajtjen e vlerave të trashëgimisë bujqësore-agrobiodiversitetit, promovimin e vlerave të produkteve autoktone për ushqyerjen më të mirë të popullatës

dhe konsumatorëve, përfitimin ekonomik të zonës nëpërmjet turizmit dhe shitjes së produkteve natyrore dhe bujqësore, dhe rëndësinë e ndërlidhjes së këtyre elementëve së bashku.

Në ambientin e panairit krahas materialeve informuese dhe promovionale për turizmin në Parkun Natyror Shkrel si broshura, përfshirë dhe revistën Albanian Travel me artikuj të veçantë për parkun e Shkrelit, mund të gjeje fletëpalosje për vlerat e biodiversitetit si parku rajonal, shpella, burimet turistike si dhe kishte demonstrime të përdorimit të energjisë së pastër si ndriçimi me panele fotovoltaike dhe pajisje demonstrative për depozitimin e mbeturinave.

Promovimi edhe i produkteve të zonës demonstroi disa elemente inovative për praktikën ekzistuese të marketingut të produkteve bujqësore në fshat si organizimi i shitjeve të produkteve nëpërmjet panairëve dhe tregjeve të fundjavës të fermerëve në destinacionet rurale turistike si pjesë e konceptit të zinxhirit të shkurtër të vlerës, ku konsumatori vjen direkt të blejë tek fermeri, paketimit estetik dhe etiketimit të disa produkteve si gështenjat, djathi, fasulet, reçeli, lajthijat, çajrat, mjalti, lëngjet e frutave, model që pasqyron vlerat dhe origjinën rajonale siç është etiketimi që po zë terren dhe në Europë me emërtimin - produkt maresh, i shoqëruar bashkë dhe me etiketën apo informacionin narrativ duke i komunikuar konsumatorit për veçanësinë e origjinës, vlerave, kultivimit apo përpunimit të produktit.

Oferta e turizmit rural u prezantua në dy dimensione: nëpërmjet promovimit dhe interpretimit të vlerave të agrobiodiversitetit gjatë panairit dhe organizimit të turit të gështenjave për një grup vizitorësh potencialë.



## Promovim i vlerave dhe produkteve të agrobiodiversitetit

Në panair, ekspertët e blegtorisë Z.Atif Dema dhe znj.Fatmira Sula me angazhimin e fermerëve të spikatur të zonës që janë dhe konservuesit në terren të këtyre vlerave si Bejto Hasmekaj, Rezart Jacaj, Gëzim Meta etj, por dhe në prezencë të kolegëve të tyre si Deda nga Thethi, Kola, Flamuri nga Valbona, Pjetri nga Lekbibaj kishin sjellur për demonstrim dhe prezantuan dhe vlerat e racave autokotone të të imtave si dhia e zezë Capore e Drabogisë, Dhia e kuqe e Hasit, delet Bardhokë dhe ajo në zhdukje Shkodrane vlera të cilat jo vetëm u shijuan duke i soditur për bukurinë e tyre por dhe u shpjeguan se si dhe pse ruajtja e pastërtisë gjenetike sjell rritje të produktivitetit dhe cilësisë së tufave dhe të produkteve të tyre

Ne panair këto vlera mund të shiheshin të materializuara dhe në produktet e përpunuara si djathi i përgatitur nga baxhoja e kooperativës Reçi Prodhimtar.

Ekspertët e Institutit të Resurseve Gjenetike, pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës, prof. Fetah Elezi dhe prof. Sokrat Jani promovuan vlerat e frutave dhe bimëve autokotone të arave, duke prezantuar punën e bankës gjenetike në bashkëpunim me projektin CABRA për konservimin jo vetëm ex-situ dhe in-situ, shpjeguan punën për restaurimin e farërave të bimëve autokotone të zonës së Alpeve dhe aktivitetet në proces për shpërndarjen e tyre tek fermerët e zonës që janë ruajtësit dhe kultivuesit në terren të këtyre pasurive.

Në panair u ekspozuan dhe u interpretuan vlerat e frutave të zonës si vesa-vodhëza dhe gështenjat, si dhe produkteve tipike dhe të veçanta si misri i Reçit, domatet tip çerri dhe fasulja.

FOTO SEKSION 2





## Turi i gështenjave

Oferta turistike me turin e gështenjave dhe drekën në restorantin e improvizuar në natyrë

Si një ofertë e turizmit rural dhe të eksperiencave, krahas aktivitetit informues dhe edukativ mbi vlerat e agrobiodiversitetit dhe produkteve, në territorin e panairit u prezantuan dhe bizneset e tjera të zonës së parkut Shkrel si hotelet Natyral Razma Resort dhe Kulla e Artë nga Razma, të cilët krahas dy restoranteve pranë gështenjave, ofruan ushqimin në natyrë në dy variacione për pjesëmarrësit në panair: catering-bufe dhe me tavolina ulur në grupe dhe me meny, të vendosura poshtë gështenjave dhe pranë aktivitetit, me muzikë me instrumentist në sfond dhe me kavalete pikturash të natyrës duke ofruar një larmi të produkteve dhe gatimeve por dhe një atmosferë të veçantë të shijimit të ushqimit.

Turi i gështenjave i shenjuar tashmë në terren dhe në harta u ofrua në formë të organizuar me Ervinin, guidë profesionale për një grup miks të vizitorëve potencialë, nga Shkodra dhe Tirana, vendas dhe ndërkombëtarë, të moshave të ndryshme, përfshirë dhe fëmijë.

Grupi i vizitorëve, krahas ecjes fizike për rreth dy orë në një terren të moderuar kodrinor, shijoi peisazhin e veçantë, të veshur me ngjyrat e vjeshtës, ecjen përmes pemëve monumentale, përmbi tapetin e gjethëve dhe me lëvozhgat e frutave, pasuroi fotografitë me peisazhin e fshatit me mullarët, kopshtet, gardhet, shpendët e kafshët shtëpiake.

Mbledhja e gështenjave, gjetja e kërpudhave, provat mbi gomar, komunikimi me banorët e fshatit ishin eksperiencia aktive dhe mbresëlënëse për të gjithë







*“Hajd”* dalim  
**nga Myzeqeja!**



# Tetor 2016 Maj 2017



**BASHKIA  
FIER**

Është projekti më i madh i promovimit të trashëgimisë kulturore i Bashkisë Fier për vitin në vazhdim 2016 dhe përfundon në muajin Maj 2017. Ai është konceptuar si një tur etnokulturor që do të shkojë në të 10-të njësitë administrative të Bashkisë dhe në çdonjërin prej tyre do të promovojë vlerat më të spikatura kulturore, arsimore, natyrore dhe historike dhe do të ringjallë gjithë trashëgiminë etnokulturore të tyre. Ai do të zhvillohet në formën e panairove dhe demonstrimit të ritualeve të çdo njësie përmes një feste të vërtetë, e cila nuk do të i ngjajë tjetrës. Në muajin maj 2017, në një vend të zgjedhur të Bashkisë Fier, do të zhvillohet super panairi i trashëgimisë “Hajd dalim nga Myzeqeja”, ku Njësitë Administrative të Bashkisë do të prezantohen me produktet dhe resurset më të mira të tyre.

Bashkia Fier nëpërmjet projektit “Hajd dalim nga Myzeqeja”, përveç promovimit të trashëgimisë etnokulturore të shkëlqyer të trevës së Myzeqesë, kërkon të bëjë një ftesë të madhe publike gjithë shqiptarëve dhe jo vetëm, që të vijnë në Myzeqe pasi ajo ofron një turizëm brilant kulturor, historik, fetar dhe natyror!

**Nga Adriana Mile**  
Drejtoreshë e Arsimit, Rinisë dhe Komuniteteve  
Bashkia Fier

# SOFRA MYZEQARE ETNOKULTURORE





## Libofsha

Vetëm pak metra në të hyrë të Fierit, në të djathtë, aty ku kalon by pass-i i Fierit, një rrugë dytësore plot dredha të fton drejt qendrës Libofshë. Është një rrugë e gjatë gati 14 km, herë e shtruar e herë e dëmtuar, herë e drejtë dhe herë me dredha.

Tek kalon nëpër të, të përpin një ndjenjë qetësie dhe paqeje, thua sikur rreth e rrotull nuk ka frymë njeriu. Rrallë sheh banorë në të, rrallë i sheh edhe nëpër lokalet e pakta përgjatë rrugës. Por ekzistencën e tyre e shikon pash më pash në të dy anët e rrugës, tek ngastrat e punuara aq bukur e me aq merak siç dinë vetëm libofsharakët.

Në hyrje të qendrës Libofshë një parullë "Libofsha, djepi i kulturës dhe traditës" të fton për një ngjarje jo të zakonit të zonës.

## Libofsha, djepi i traditës dhe kulturës!

Qendra e Libofshës nuk kishte qënë kurrë më e bukur se ajo ditë fillim nëntori. Bashkia Fier, për të parën herë pas 20 e ca vitesh, pikërisht në vendin ku dikur ishte Shtëpia e Kulturës e njohur në të gjithë Libofshën, organizoi panairin e madh të trashëgmisë kulturore të Njësisë Libofshë në kuadër të turit etnokulturor "Hajd dalim nga Myzeqeja".

Projekti, i cili do të përfshijë të 10 Njësitë Administrative të Bashkisë Fier, jo pa qëllim nisi në Libofshë. Libofsha është një zonë me traditë të kulluar myzeqare dhe ku Myzeqeja shfaqet në të gjithë dimensionet e saj.

Ajo është djepi i kulturës dhe traditës myzeqare, djepi i shkollës së parë shqipe në të gjithë Myzeqenë (gusht 1908), është vendi i kishave ndër më të bukurat dhe më të vjetrat në Myzeqe (Kisha e Shën Kozmait dhe ajo e Shën Gjergjit), vendi ku njerëzit nuk heqin dorë nga Zoti në të dy botët (të gjitha kishat janë pranë varreve të fshatrave), vendi ku i gjenë të gjitha, detin,



tokën, lumin, pyjet, Zotin, është vendi ku njerëzit nuk mburret kurrë, vendi ku zakonet, folklori, historia ruhen si djali i vetëm dhe e gjithë pasuria shpirtërore e zonës në sënduqet e nënave libofsharake.

Aty miqtë dhe vizitorët i presin pa fjalë dhe me tabakanë plot. Për mikun ata të nxjerrin gjithë shtëpinë!

## Kulinaria myzeqare në Libofshë

### Trashëgimia e jetesës dhe bashkëjetesës myzeqare.

Panairi "Hajd dalim nga Myzeqeja" në Libofshë solli gjithçka nga kulinaria myzeqare: gjithë gatimet e zonës duke filluar nga tavat e famshme myzeqare me bibë, përseshin me gjel deti, tavën me rosnica, tavën me peshk, byrekun me lakra, tavën me oriz, yshmerin, bonbonet me qumësht si në asnjë vend tjetër, gjithçka që shtron një sofër myzeqare. Ate ditë nxënësit e shkollave "Anastas Laska", "Jovan Ndreko" dhe nga fshati Agim, kishin nxjerrë gjithë shtëpinë për mysafirët dhe miqtë e Libofshës.

Në Libofshë asgjë nuk është zhdukur, asnjë nuk ka humbur. Në atë panair gjeje gjithë Myzeqenë dhe myzeqarët e qindra viteve më parë; aty vizitorët i qerasnin me një tabaka bakri të bukur që mbante një histori 100 vjeçare. Të ftonin në një kasolle me kashtë (improvizim i një shtëpie myzeqare) ku ishte ulur hijerëndë dhe kapadai beu i fshatit i rrethuar me gjithë të mirat në sofër, teksa i bënte karshillëk gruaja që tirte lesh me furkë dhe "yzmetqarja" që rrihte qumshin në tundës, aty në panair të ftonin të uleshe këmbëkryq në një sofër të thjeshtë ku buka e mistrit dhe copat e djathit ta bënin me sy si në atë kohë, siç thonë myzeqarët. Në panair i gjeje të gjitha veglat më të rëndësishme të punës së myzeqareve libofsharake: tezgjahun, krëhërin, tundësin, qypat prej balte, deri tek rrota e madhe e qerres që të kujtonte myzeqarin Pilo Shpiragu tek "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxës, mullinjtë e dikurshëm të kafesë, feneri ndriçues, qypat e famshëm, të cilët përdorshin dundur nga banorët e Libofshës për turshitë dhe bulmetin.

Një festival më vete përbënin në panair veshjet myzeqare të grave dhe burrave libofsharakë që nga futa, papucet, shamia e kokës, fustanet dhe veshja tipike e burrave dhe grave të Myzeqesë, qilimat, rrugicat e qëndisura.

Ata janë duarët dhe bujarë të Zoti, si ata nuk ka në të gjithë Myzeqenë!

## Folklori

Një pjesë e rëndësishme e projektit etnokulturor "Hajd dalim nga Myzeqeja" në Libofshë ishte promovimi i ritualeve folklorike të zonës. Aty nuk mungoi as lindja, as dasma dhe as gëzimi i familjes myzeqare libofsharake.

Vizitorët e shumtë shijuan ritualin e dasmës myzeqare, që përbën në vetvete një institucion unikal folklorik i cili ruhet me fanatizëm edhe sot e kësaj dite në të gjithë Libofshën e mbarë Myzeqenë. E famshmja kënga e qepës së shamisë, apo e mollëve të fatit, ninulla me djep ishin pjesa më e rëndësishme ritualit të





interpretuar pa përrjashtuar vallen dyshe myzeqare të grave dhe të burrave.

### **Pasuritë natyrore të Libofshës. Kurora e Lumit të Vjetër Seman**

Vetëm 4 km larg qendrës së Libofshës, në fshatin Alibejas ndodhet një nga perlat natyrore të zonës dhe gjithë Myzeqesë, Kurora e Lumit të vjetër të Semanit, shpallur monument natyre.

Përveç banorëve të zonës, askush nuk e di se aty në Libofshë, në fshatin Alibeaj, Kurora e lumit të vjetër Seman përbën një nga perlat natyrore të Myzeqesë dhe jo vetëm. Për të shkuar aty, të duhet të ecësh në një rrugë të sapo ndërtuar nga Bashkia Fier, Agim-Asturkas dhe më pas në një rrugë të zakonshme fshati. Kurora e lumit të vjetër Seman (pyll masiv) ka marrë emrin prej formës që ka duke i qëndruar si kurorë në të gjithë gjatësinë e tij lumit të vjetër Seman që përshkon zonën e Libofshës dhe ka një sipërfaqe 44 ha. Pylli i Kurorës është një muze i gjallë, me drurë karakteristike e biodiversitet të lartë. Bimët barishtore të tipit të lianeve që ngjiten në plepat e lartë, bashkëshoqërimi dhe dendësia e shumë llojeve bimore, dihatjet e faunes së egër, e sidomos bretkosave dhe gjinkallave, të japin ndjesinë e një "xhungle" të vogël mesdhetare.

Kurora e Lumit të vjetër Seman përbën një destinacion të padiskutueshëm turistik!

### **Trashëgimia fetare**

Libofsha është vendi i kryqit. Aty ndodhen plot 6 kisha, ku më të famshmet Kisha e Kozmait dhe ajo e Shën Gjergjit janë shpallur monumente kulture. Ato janë plot histori dhe vlera të jashtëzakonshme arkitekturore. Manastiri dhe Kisha e Shën Kozmait u ndërtuan në vitet 1814-1815 me porosinë dhe ndihmën e Ali Pashë Tepelenës për nder të shenjtorit Kozma Etolit.

Në çdo 24 gusht, kjo kishë mbledhë gjithë ortodoksinë e Myzeqesë dhe libofsharakët në mbarë botën në një peligrinazh të vërtetë në nderim të ditës së shenjtit Kozma. Ndërsa kisha e Shën Gjergjit, është ndërtuar në vitin 1776 dhe është një kryevepër e zografëve në brendi të saj. Që të gjitha kishat në zonën e Libofshës janë ndërtuar pranë varrezave të fshatrave, sikur duan të tregojnë se në këtë vend, banorët nuk jetojnë dot pa Zotin në të dyja botët.

Në të gjithë Myzeqenë, nuk ka qaq shumë kisha sa në Libofshë.

### **Bashkia Fier**

Kryetari i Bashkisë Fier, z. Armando Subashi thotë se projekti "Hajd dalim nga Myzeqeja" është i pari në llojin e tij prej dhjetra vitesh, që është vënë në zbatim nga stafi i tij. Bashkia Fier do t'i kthehet fuqishëm ruajtjes së trashëgimisë dhe promovimit të vlerave më të mira etnokulturore të trevës së Myzeqesë. "E nisëm me Libofshën se ajo është Myzeqeja në të gjithë përmasat e saj. Do të vazhdojmë kështu në çdo njësi, duke promovuar fuqishëm çdo traditë etnokulturore, historike dhe çdo pasuri natyrore.






# Festa e Ullirit

ripërtëritja e një  
tradite antike

Ilirjan Gjika

Fotot: Iglj Pustina & Thoma Goga ©



## Reportazh nga Roskoveci

*Të premten e 28 tetorit 2016, Bashkia Roskovec, organizoi "Festën e Ullirit" si ripërtëritje të një tradite të vjetër. Dhe jo pa qëllim sepse organizimi i një eventit të tillë kishte disa arsye të forta, për të cilat njerëzit e mençur dhe me vizion që drejtojnë këtë njësi të qeverisjes vendore këmbëngulën për ta "festuar".*

**"Festa e Ullirit" u organizua pranë kishës 700 vjeçare të Shën Kollit në Kurjan, një monument kulture me shumë vlera.** Pikërisht këtu, në praninë e medias dhe të të ftuarve nga gjithë vendi, u zhvillua panairi i prodhimeve të kësaj bime të bekuar. Po kështu, kryetarja e bashkisë znj. Majlinda Bufi, si përfaqësuese e zgjedhur e komunitetit vendor së bashku me miqtë pjesëmarrës, mbolli në mënyrë ceremoniale disa rrënjë ulliri, duke i shtuar bllokut frutor të kësaj njësie, ullirin më të ri. Më pas të pranishmit kaluan momente të bukura në koncertin e organizuar enkas për këtë rast.

Ndërkohë që i gjithë ky aktivitet u zhvillua në Kurjan, në oborrin e monumentit të njohur, pranë ullinjeve të tij shekullorë, ku tradita e vjetër e panairëve mesjetarë do të vijojë si bashkëjetesë e ekonomisë bujqësore me vlerat kulturore. Por cilat janë arsyet e organizimit të "Festës së Ullirit"? Nëse do t'i rendisnim me radhë ato, do të theksonim se Roskoveci, si pjesë përbërëse e rajonit të Fierit ka një traditë të vjetër dhe shekullorë në kultivimin e kësaj kulture. I

njohur për vlerat e tij ushqyese, kuruese dhe për më tepër ekonomike, për ullirin është treguar kujdes i veçantë qysh në antikitet. Në veprën e tij "Gjeografia", të shkruar në shekullin e I-rë P.K., Straboni, kur përshkruan Ilirinë shkruan se "Ky vend i ngrohtë dhe frytdhënës është plot me ullishta dhe vreshta". Kështu edhe Roskoveci si një vendbanim antik i vendosur përgjatë degës jugore të rrugës Egnatia, në kurrizin kodrinor të fushës Ilire (Myzeqesë) e ka kultivuar këtë kulturë qysh në këtë periudhë. Gjetjet e amforave të vajit në vendbanimet fqinje të Apolonisë, Margëllçit (Patosit), Antipatreas (Beratit), Dimalit, apo Bylisit, tregojnë qartazi faktin se edhe ky vendbanim ndodhej brenda hartës së "zonës së ullirit". Gjithashtu edhe qenia si qytet-stacion i njërës prej arterieve të Vijës Egnatia, të çon te mendimi se nëpërmjet kësaj rruge kanë kaluar në shekuj me mijëra amfora nga vaji i kësaj bime "të bekuar".

Ndërkohë që ulliri dhe vaji i tij kanë qenë dy prej artikujve më të vjetër të treguar në tregun e famshëm të Roskovecit. Sipas Rregjistrat Kadastror të Sanxhakut të Vlorës në vitin 1570, ulliri kultivohej në të gjithë zonën kodrinore të Mallakastrës, një pjesë të së cilës e përfshin





Foto: Thoma Goga ©



Foto: Igli Pustina ©

sot në territorin e saj edhe Bashkia Roskovec. Bile në këtë zonë ai renditej i dyti për nga prodhimi pas drithërave të bukës, duke njohur mirë jo vetëm teknologjinë e përgatitjes së tij për ngrënie por edhe për prodhimin e vajit (T. Sadiku, 2009)

Ndërsa sot në territorin e Bashkisë Roskovec vihet re se tradita vijon përsëri fuqishëm. Sipas statistikave këtu kultivohen rreth 450 000 rrënjë ullinj, të cilët përveç zonës kodrinore që e ka traditë brez pas brezi, ulliri ka nisur të mbillet me shumicë edhe në zonën e ulët fushore. Pikërisht edhe ky aktivitet, kjo festë zhvillohet për të promovuar një nga artikujt bazë të ekonomisë vendase.



Foto: Thoma Goga ©





Foto: Iglj Pustina ©

Foto: Iglj Pustina ©

Kjo kulturë përdoret gjerësisht në fushën e kulinarisë si ulli kokër për tavolinë, si dhe për të prodhuar vaj, që shfrytëzohet për gatime të ndryshme dhe përgatitjen e sallatave. Për këtë qëllim brenda territorit të kësaj bashkie janë specializuar një sërë zonash që shquhen për kultivimin dhe prodhimin e tij, nga të cilat mund të përmendim ato: Kurjanit, Velmishit, Luarit, Vidhishtës, Ngjeqarit, Vloshit, etj.

Por ulliri është më tepër se një bimë e çmuar apo artikull ekonomik në Roskovecin. Ai përbën një nga simbolikat dalluese të tij. Mjafton që t'i hedhësh një sy emblemës së kësaj bashkie dhe do të vësh re, se shqyti i saj është vendosur brenda një kurore degësh ulliri. Pra rrënjët e saj të thella janë më të thella në histori.

Ndëkohë së fundmi mund të themi, se pas rikthimit në identitet si rezultat i reformës së re administrative territoriale, me konceptimin e ri gjeografik, me një sërë investimesh në infrastrukturë, që po ia ndryshojnë pamjen e ekologjisë urbane, Roskoveci, po ecën me hapa të shpejtë në rrugën e zhvillimit. Krijimit i Festës së Qytetit si një traditë festimesh të përvitshme, vendosja e veprave të artit modern në sheshet dhe rrugët e tij, ruajtja dhe promovimi i vlerave të kulturës materiale, zhvillimi i aktivitete të shumta kulturore, artistike dhe sportive, tregojnë se nën drejtimin njerëzve vizionarë edhe këtu ka nisur të ndryshojë cilësia e jetës. Dhe në këtë aspekt edhe organizimi i një eventit kuptimplotë siç është "Festa e Ullirit" është një tjetër vlerë e shtuar mbi të gjitha në dobi të komunitetit vendor.







Foto: Igli Pustina ©



Foto: Thoma Goga ©



Foto: Igli Pustina ©



Foto: Thoma Goga ©



Foto: Thoma Goga ©





# Ferma Ekosociale “Ana e Malit”, risia e agroturizmit Shqiptar

 **Kastriot Faci**  
The Door, Albania

**Ferma Eco-Sociale Ana e Malit** është një sipërmarrje sociale, e cila synon të ketë ndikim të dyfishtë, ndikim në mjedis dhe social. Ajo afron më afër njerëzit me natyrën, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve social-kulturore në natyrë dhe punësimin e personave me aftësi të ulëta kontraktimi. Është një nga tre projektet fituese në konkursin Ileve të Gjelbërta, konkurs i përvitshëm i organizuar nga Partnerët Shqipëri. Falë angazhimit së organizatës The Door dhe të partnerëve të saj, unë nuk jam i vetëm në këtë projekt. Për më shumë ju ftoj të lexoni dhe të njiheni me këtë fermë, e cila është e para në llojin e saj në vendin tonë.

Ka qenë viti 2012, kur unë me ftesë nga Ruzhdi Poda, mësues në pension dhe Isa Meti, aktivist kulturor, pata vizituar për herë të parë të gjithë fshatrat e Anës së Malit. Atëherë nuk e kisha menduar që do ta dashuroja kaq shumë këtë zonë, e cila shquhet për bukuritë natyrore, produktet bujqësore dhe njerëzit e saj shumë të mirë. Vetëm një vit më pas, mora angazhim për ngritjen e Fermës Eko-Sociale, pikërisht në një nga kodrat e kësaj zone, ku tashmë dalëngadalë ka marrë formë e po merr jetë çdo ditë Ferma Agroturistike Ekosociale.

Me distancë vetëm 2,2 km larg urës së Bunës, 7 km larg qendrës së qytetit të Shkodrës dhe 12 km larg pikës kufitare të Muriqanit me Malin e Zi, ferma është e arritshme për këdo, qoftë në këmbë, me biçikletë apo me makinë. Ajo kufizohet nga shtëpia e Malësorit, fshatin Zues dhe fshatin Xhaferaj.

Ferma ndodhet në zonën me peisazh të mbrojtur të lumit Buna në Bashkinë Shkodër, në njësinë administrative Ana e Malit. Shtrihet në një kodrinë argjilore, pjesë e një vargu kodrash, të quajtura Kodrat Magjype. Thuhet që dikur në kodra kanë banuar familje kovaçësh të ardhur nga Egjipti, ndaj quhen dhe Kodrat Magjype. Brinjë këtyre kodrave kalon një rrugë e vjetër

e ndërtuar nga Perandoria Austriake, e cila lidhte Shkodrën me Krajën, në Mal të Zi. Këtu në vitin 1967, ka filluar e saj ndërmarrja bujqësore “Perlat Rexhepi”, e vetmja fermë me shtirje në të gjithë zonën rreth qytetit të Shkodrës. Meqë kodrat klasifikoheshin si një tokë joprodhuese për drithërat, rreth vitit 1983 ato u mbollën masivisht me fidane ulliri me punë vullnetare. Vadtja bëhej me pompat që thithnin ujin nga lumi Buna dhe ullinjtë dhanë rendiment të lartë. Kujtoj që profesor Ahmet Osja më pat treguar, që një arsye më shumë për mbjelljen e kësaj kulture ishte që pikërisht mbi këtë zonë kalon paraleli i 42-të, këtu hëna ndriçon 2,2 herë më shumë. Pasi keni lënë asfaltin e marrë kthesën djathtas tek një tabelë e bërë nga një baraban kabllosh, ju duhet ecni për vetëm 200 m në rrugë rurale dhe ja, mbërritët. Parkingu kufizohet nga një bahçe të rrethuar mjeshtërisht me kallamë. Brenda saj janë tre ullinj, e pas tyre, një kënd lodrash, tre ndërtesa të ulëta, dhe një masiv pishash që ngjiten lart deri në kodër e që shoqërohen nga të tjerë ullinj. Fabiola, një qen i racës labrador me dy këlyshët e saj Ekon dhe Farma, janë tashmë duke ju mikpritur duke u hedhur e lehur nga gëzimi. Tre macet lozonjare, banore të fermës, gjithashtu ju shoqërojnë, por shpesh here më në distance dhe disi më indiferente për vizitën tuaj. Veranda e repartit të punës së ngritur nga blloqe betoni është mobiluar thjesht. Aty do të shikoni disa karrige Milingona të prodhuara me kofanet e makinave, materiale të ricikueshme. Tavolinat e stolat e tjerë gjithashtu janë prodhuar në fermë në të njëjtën mënyrë. Veranda përdoret për ushqim dhe veprimtari të tjera kreative. Reparti i punës tani për tani shërben si një magazinë për ruajtjen e shumë objekteve të grumbulluara, të cilat i përkasin të kaluarës



dhe në vetvete mbartin shumë histori interesante. Në fakt këtë hapësirë në të ardhmen e afërt ne synojmë ta përdorim për ngritjen e shërbimit të restorantit me gatime tradicionale të zonës së veriut të vendit tonë.

## Akomodimi

Le të ngjitemi në rrugën që të shpie tek një ndërtesë ne dukje druri, që është pagëzuar me emrin banesa sociale. Ajo shërben për akomodimin e 10 pushuesve. Dhomat të gjitha kanë akses në verandë dhe një strehë me kallama, që i shërben pushuesve për t'u mbrojtur nga rrezet e diellit. Nga veranda ju mund të shijoni panoramën dhe luginën e shegëve të buta, pyllit të ullinjve e drurëve të lisit në kodrat përballë dhe banesat e Shtëpisë së Malësorit. Në krahun e majtë të banesës sociale të bën kureshtar një shtëpizë e bukur me ngjyre të bardhë me me çati me tjegulla të vjetra marsejeze. Kjo është ish-stalla e fermës, e cila tani ju jep mundësinë e akomodimit. Është e pajisur me 10 shtretër duke i dhënë mundësinë pushuesve në grup, që jo vetëm të flenë, por dhe të argëtohen në verandën e saj. Kushtet që ne ofrojmë për akomodim në fermë janë modeste, kjo pasi ne dëshirojmë që klientët tanë të përjetojnë një përvojë ndryshe, diçka tjetër nga e përditshmja, e thjeshtë, e pastër, diçka që të plotëson nevojat bazë, me çmim të lirë dhe konkurues në treg. Ferma akomodon deri në 20 persona, grupe nxënësish, familje apo grupe shoqërore, që i pëlqejnë aktivitetet në natyrë. Ne kemi si target turistët e aventurës, ata që kryesisht udhëtojnë me biçikleta dhe u pëlqen të flenë shpeshherë jashtë, në çadra, në qiell të hapur, në hapësirat e kushtet që të ofron ferma. Këtu është mundësia e akomodimit falas, për ata që angazhohen me punë vullnetare, duke ndihmuar në punët e përditshme të fermës.

Një mur guri mbajtës ndan sheshin e akomodimit për çadrat me ish stallën dhe një shesh që përdoret nga

pushuesit për parking apo për të luajtur futboll e basketboll. Pak më lart është stalla, e cila është ndërtuar me materiale të riciklueshme. Aty jetojnë të gjithë kafshët e shpendët e fermës, përveç bletëve. Ato janë dele, dhi, pula, pata, gomerë, pëllumba, rika, pulhine. Ndërkohë gjatë shëtitjeve në fermë Ju mos u habitni nëse ndonjë lepur ju pret rrugën me shpejtësi. Breshkat janë më të shumta në numër se sa liriqët, të cilët janë banorë autoktonë në fermë. Kryesisht hutini, por dhe zogj të tjerë fluturojnë përmbi fermë, të parët për të rruftur ndonjë nga pëllumbat apo zogjtë e pulave e të tjerët për të shoqëruar me këngën e tyre juve gjatë të gjithë kohës që jeni këtu. Një shumëllojshmëri zogjsh të tjerë fluturojnë mbi qiell me destinacion lumin Buna, fushat përreth apo dhe në liqenin e Shkodrës.

**Shëtitjet në fermë** janë një atraksion më vete ndaj tabelat orientuese ju ndihmojnë të merrni rrugën për lart. Ndërsa jemi duke ecur, pas rreth 200 metrash, në të majtë dallojmë 27 koshere me bletë të rrethuara me një rrjetë me ngjyre jeshile. Vazhdojmë ecjen e kur mbërrim më lart në kodër, lexojmë një tabelë **"Ullinjtë e shpëtuar nga Zefi"**. Për t'ju shuar kureshtjen, ju tregoj historinë. Ishte marsi i vitit 1997, "gjatë krizës së piramidave", në një natë u prenë të gjithë ullinjtë për dru zjarri. U prenë nga disa persona, të quajtur "banorët e pallateve". Këta janë banorë jo autoktonë, të ardhur nga zonat e përmytura të hidrocentralit të Fierzës. Të 37 ullinjtë janë dëshmitarët e kësaj ndodhie të pazakontë. Ne i kemi pagëzuar me emrin e Zefit, në nder të aktit të bërë nga Zef Vata, njëri prej banorëve të Shtëpisë së Malësorit. Ai i ka mbrojtur këta ullinj nga prerja prej disa banorëve të pashpresë e të mërzitur nga sistemi komunist.

Ndërkohë ne vazhdojmë ecjen në këmbë dhe kalojmë përmes një fushe volejboli ku shtyllat e saj janë të bëra me drurë. Pas pak metrash na shfaqet madhërishtëm një amfiteatr, i cili shtrihet në kodër. Forma e tij është si në kohët e teatrit antik. Është ngritur me gurët natyralë të grumbulluar me karrocë me kalë në zonë e pa përdorur asnjë kovë llaç, kudo mbizotëron ngjyra jeshile, ajri i pastër, ndaj dhe e kemi pagëzuar me emrin **"Amfiteatri Natyror"**.





## Atraksionet e Fermës

Ngjitje në Malin e Taraboshit si dhe në fshatrat e sipërm të Anës së Malit si Muriq, Krebaj, Kravar e në fshatin kufitar të Vithgarit.

Çiklizëm malor në rrugët e shtigjet e zonës.

Plazh në lumin Buna, aty mund të shkoni me biçikletë apo në këmbë.

Akomodimi me çadra në natyrë të hapur, organizimi i grilave familjare.

Shëtitje me gomar, kujdesi ndaj kafshëve, shpendëve dhe bimësisë së fermës.

Vizite në muzeun e historiko-etnografik, pranë gjimnazit Oblikë, muzeut të ngritur nga Ruzhdi Poda dhe Isa Meti.

Shëtitje me varkë, skafe dhe anije në lumejt Buna e Drin dhe në Liqenin e Shkodrës me mjetet e ludrimit të menaxhuara nga "Vëllezërit VATAKSI".



## Atraksionet të tjera Me Biçiklete

Shëtitje dhe Vizitë në Kalanë Rozafa.

Shëtitje buze Liqenit të Shkodrës, Shirokë dhe Zogaj.

Shëtitje brigjeve dhe rrugëve në krah të lumejve Buna, Drini dhe Kir.

Shëtitje me biçikletë në rrugën e biçikletave "Jetoje Lumin" në zonën e Dajçit.


Shëtitje me bicikletë në qytetin e Shkodrës, vizitë në muzeun e fotografisë MARUBI, Muzeun Historik, Xhaminë e Plumbit, Muzeun e Kujtesës, Kishën Katedrale të Shën Shtjefnit etj.



## Disa nga aktivitetet e planifikuara në fermë gjatë vitit 2017

Muaji	Festa	Info
Janar	Marshimi i përvitshëm për në Tarabosh- edicioni i 6-të	Fundjaven e dytë e Janarit me pjesëmarrjen e grupeve rinore nga vendi ynë, Kosova dhe Mali i zi.
Mars	Hapja e sezonit turistik	Organizimi i vizitave për vogelushët e kopshteve dhe nxënësve të shkollave.
Prill	Java e peshkut të kublës	Gatimi i peshkut të kublës
Prill	Lojra Popullore Fest- edicioni 9-të	Me pjesëmarrjen e trupave rinore nga vendi ynë dhe nga vendet fqinjë.
Qershor	Festimi i festës së fëmijëve	Me pjesëmarrjen e fëmijëve nga kopshtet e qytetit dhe të zonës përreth.
Korrik -Gusht	Kampingu i vullnetareve	Me pjesëmarrjen e të rinjve nga zona dhe vendi ynë, angazhimi me punë vullnetare.
Gusht	Festa e rinisë	Mbrëmje rinore
Shtator	Teater social	Shfaqje artiste të rinj, kllounë
Tetor	Festa e Shegës	Feste lokale dedikuar frutit të Shegës
Tetor	Java e Qefullit	Gatimi i peshkut te qefullit
Nentor	Festa e gjeshtenjes	Feste lokale dedikuar frutit te geshtenjes
Nentor	Java e Gjuçës	Gatimi i peshkut të Gjuçes
Dhjetor	Të fala nga Ferma	Me pjesëmarrjen e fëmijëve nga kopshtet e qytetit dhe të zonave Rurale të Bashkisë Shkodër.
Dhjetor	Java e pirjes së verës	Shërbehen verë dhe verë e ngrohte me ushqime të gatuar me produkte lokale.





Skena e tij është prej druri dhe hekuri me përmasat të bollshme që lejojnë performancën në grup. Ajo është mikpritëse për artistët e rinj si nga brenda ashtu dhe jashtë vendit tonë. Që prej tre vitesh në këtë skenë çdo vit realizohen veprimtari social kulturore dhe shërben si promotore e traditave tona, kulturës, paqes, teatrit social për rininë. Kapaciteti i amfiteatrit është deri në 5 mijë persona. Hapësira dhe skena e amfiteatrit shërbejnë gjithashtu për nxënësit e shkollave, vizitorë ditorë të fermës.



### Bimësia e fermës

Mikroklime e krijuar me erërat bregdetare dhe nga Mali i Taraboshit, ndihmojnë që zona të shquhet për prodhime të mira bujqësore, perimet dhe zarzavatet. Gjatë dy viteve të fundit fermës i janë shtuar 300 fidanë ulliri të rinj, të cilat janë mbjellë nga mbështetja e Swiss dhe Austrian Cooperation. Krahas tyre kemi mbjellë pemë frutore si limonë, portokalle, mandarina, dardha etj. Një masiv me pisha mbjellë nga ndërmarrja pyjore rreth 7 vjet më parë, përbën një pjesë të madhe të bimësisë së fermës. Ato po rrisin kurorën jeshile mbi banesën sociale, si dhe rrisin sigurinë e mbrojnë kodrën nga erozioni. Shegat dhe dardhat e egra, rrënjët e të cilave i kanë rezistuar sopatës së njerëzve dhe thatësisë së verës, tashmë e kanë rimarrë veten. Vilet po ashtu. Ato i rezistojnë thatësisë të vendosur pikërisht aty ku lagështira dëshmon prezencën saj, në brinjët e kondrës. Lulet e stinës të shumta lulëzojnë sipas radhës krahas bimëve medicinale e aromatike si sherebela, makthi dhe levando të mbjella së fundmi nga ne. Tashmë kemi mbërritur në majë të kodrës, aty ku tabela shënon "Sheshi Belvedere". Prej këtu ju mund të shijoni panoramën fantastike duke filluar që nga Mali i Cukalit, Guri i Zi, Ganjolla, Bërdica, fushat e Dajçit, kodrat Oblikës e në vazhdimin kodrat e malet përtej kufirit e deri në majën e Taraboshit.



Duke dashur t'ju lëmë kureshtarë për të ditur me shumë, këtu unë do të ndërpres rrëfimin tim, duke ju falenderuar që më "ndoqët" në këtë udhëtim imagjinar. Unë gjej rastin t'ju ftoj ju të na vizitoni në fermë, duke filluar nga pranvera, në mars të vitit 2017.





# *Aromë Berati*

**Një udhëtim mes dhjetëra gjërave fantastike**

*në Qytetin e Bardhë*







Përveçse është një nga qytetet më magjepsës të Shqipërisë dhe të Ballkanit, Berati është i njohur gjerësisht për traditën e tij unike në artizanat dhe mjeshhtërinë e të gatuarit.

Vizitoni qytetin magjik të Beratit dhe përjetoni disa nga atraksionet më të bukura të tij!

## Zbuloni çfarë do të ndodhë gjatë udhëtimit tuaj:

1. Ecje në lagjen e Mangalemit duke dëgjuar histori të lashta të Beratit
2. Ndalesë në një shtëpi të vjetër Mangalemit për të shijuar likerët ëmbëlsirat dhe shoqërinë e mjeshhtërive të gdhendjes së gurit
3. Vizitë në Muzeun Etnografik të Beratit
4. Vizitë në kalanë e Beratit, ecje përgjatë mureve të kështjellës dhe tregimi i legjendës së Goricës
5. Vizitë në Muzeun Onufri
6. Dreka me gatime tradicionale beratase pranë oxhakut kërcëllitës
7. Darkë dhe shijim vere në kantinën Çobo
8. Akomodimi në hotel Castle Park
9. Vizitë në malin e shenjtë të Tomorrit
10. Drekë në luginat përrallore të malit

**Koha e fillimit:** Ora 10:00

**Vendi i takimit:** Hotel Castle Park, Berat

**Kohëzgjatja totale e udhëtimit:** 2 ditë

Ky udhëtim do të ofrohet në bazë të kërkesës; grupi minimal i turistëve 4 persona.

**Të përfshira:** Transporti drejt malit të Tomorrit me makina 4x4, biletat e muzeve, 2 dreka, darka, vizita në Kantinën Çobo, akomodim për 1 natë dhe mëngjesi.

### Ju duhet të keni me vete:

- Veshje sportive të ngrohta dhe të lehta
- Këpucë/atlete të pa rrëshqitshme të përshtatshme për ecje
- Një buzëqeshje J

**Çmimi për person:** 10 500 Lekë. Gjithçka më sipër e përfshirë.



**CASTLE  
PARK**

[www.castle-park.com](http://www.castle-park.com)

Rruga Berat - Përmet, 1.5 Km  
nga Ura e Goricës, Berat/Albania  
Mob: +355 67 200 66 23  
[www.castle-park.com](http://www.castle-park.com)  
[castlepark\\_2003@yahoo.it](mailto:castlepark_2003@yahoo.it)











# Mirëse vini në Gjinar, tek Shtëpia e Traditës, e mikpritjes dhe e vlerave



Kur në vitin 2011 botuam në revistën Travel artikullin e parë për Gjinarin, në një bashkëpunim të ngushtë me Ar-djan Bërdufin, një djalë i talentuar e i përkushtuar ndaj promovimit të vlerave të vendit të tij, shumica e atyre që e lexuan artikullin, nuk kishin dëgjuar asnjëherë për Gjinarin. Gjurmët e pikës së bukur turistike të dikurshme ishin tretur nëpër kohëra e ata që dikur mund të kishin qenë atje në ndonjë ekskursion me kolektivin e punës apo të shkollës, sigurisht që nuk ishin aq të shumtë sa të kalonin emrin e Gjinarit gojë më gojë deri në ditët e sotme.

Sot, në vitin 2016, kur turizmi natyror e ai rural në Shqipërim janë konturuar dhe po bëjnë hapat e parë të sigurt, disa zona e kanë të zhvilluar më shumë këtë ofertë turistike. Njëra prej këtyre zonave është edhe Shpati, me kryeqendër Gjinarin, i cili në pesëvjeçarin e fundit,

gradualisht është kthyer në një fshat turistik shumë të preferuar për turistët e huaj, dashurues të natyrës, por edhe nga shqiptarët që tashmë po e shikojnë edhe ata mundësinë e shijimit të turizmit natyror. Për këtë arsye, shumë prej shtëpive të Gjinarit u kthyen në bujtina për të pritur turistët, madje u ngritën edhe struktura të reja pritëse, për shkak të fluksit që rritet çdo vit.

Kështu lindi në hyrje të Gjinarit edhe një shtëpi e vogël dhe e bukur, që në pamje të parë ngjan me një shtëpi përrallash. Është Shtëpia e Traditës, ajo që ju uron e para mirëseardhjen në fshatin e bukur malor, e që don t`ju tregojë se qëndrimi juaj këtu qoftë për një natë, qoftë për më shumë netë e ditë, do të jetë veçse i rehatshëm e mbresëlënës.

E ndërtuar sipas traditave të Shpatit, me kombinimin e gurit me dru, me arkitekturë të këndshme e ambiente të





ngrohta e mikpritëse, Shtëpia e Traditës, pikërisht këtë ka si qëllim, që t'i ofrojë turistit ngrohtësinë e shtëpisë e jo thjesht një dhomë hoteli. OXHAKU në dhomën e ndenjjes, një gotë verë pranë zjarrit, bisedat me miqtë e rastësishëm që do të gjeni në bujtinë, e shton pa masë kënaqësinë e qëndrimit në Gjinar. Është shumë e rëndësishme që të ndjeheni mirë, për të qenë të çlodhur e të freskët, nëse për shembull keni vendosur që Gjinari ta vizitoni në mënyrë aktive, duke organizuar ture ose ekskursionë në zonë. Ardjani do t'ju ndihmojë jo vetëm për qëndrimin tuaj tek Shtëpia e Traditës por edhe që të njiheni më mirë me të gjithë zonën e Shpatit, të vizitoni kishat, të bëni piknikë në natyrë e pse jo, të planifikoni edhe në ditët kur ka festa lokale, të cilat këtu organizohen me shumicë. E ku ka më bukur se pushimet tuaja të pasurohen me festën "Miqte e Malit" ku përveç të gjitha







gjërave të bukura që ka festa, si ushqimet tradicionale, panairët, lojrat, të shijoni edhe këngët dhe vallet e bukura të Grupit të Shpatit. Ky grup ka dhënë me dhjetëra shfaqje brenda e jashtë Shqipërisë dhe është pjesë e pandarë e të gjitha festave që bëhen në Gjinar dhe në të gjithë zonën e Shpatit.

Shtëpia e Traditës nuk është shumë e madhe e ndoshta nuk mund të presë shumë turistë njëherësh, por është një shembull i shkëlqyer se si duhet të ndërtohen strukturat pritëse në një fshat turistik, që të plotësojnë shumë standarte e jo vetëm atë të fjetjes, nëse nesër duam të kemi një turizëm të qëndrueshëm e me vlera. Investime të tilla duhet të shihen si modele për të ardhmen, kur Gjinari do të mbushet plot me turistë e kur shtëpitë e tjera që do të ngrihen të jenë si Shtëpia e Traditës, një shtëpi ku turisti ndjehet mik e ikën me mbresa të paharrueshme.



**Në hyrje të Gjinarit, Elbansan, Albania; Tel.: +355 69 27 83 560  
email: shtepiaetradites@gmail.com; ardjjanber@gmail.com**



TRAVEL PORTAL

# afertat e parezistueshme

Start Tour



www.starttouralbania.com  
e-mail : info@starttouralbania.com  
Mob: 00355 69 91 81 262

Vjeshta vdihe dimri me oferta të parezistueshme edhe në drejtim të udhëttimeve. Drejtohuni tek agjencitë tuaja për të marrë aty ofertën më të fundit. Zgjidhni destinacionet e preferuara. Studioni çmimet më të favorshme për ju. Dhe merrni edhe dhuratën tonë bashkë me paketën turistike apo biletën tuaj.

Nëse do t'i drejtohemi cilësdo agjenci, emrin e së cilës do ta gjeni në Travel Portal, për çdo shërbim që do të të merrni prej aty, do t'ju jepet dhuratë edhe një numër i revistës Travel me qëllim që të shijoni çdo destinacion që ju këmi ofruar nga ky numër

## Festat e Nentorit në Vlorë

Oferte për grupe mbi 15 pax.

**18 Euro/personi.**

(Shoferi dhe guida falas)

Hotel New York 4\*

Per rezervime,

Cel:0696347498

**Exploring Albania**

*The best experience you may have in your life*

Oferta të ngrohta  
për ditët e ftohta



Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati "E88", Nr. 8, Tirana, Albania  
Cel.: +355 69 21 03 119 | +355 68 90 21 731  
Email: reservation@ideal-travel.com.al

**ideal**  
Travel & Tours  
*The best partner for your travel*



**DRITA**  
TRAVEL & TOURS

Linje me Autobus

- + ULQIN
- + BAR
- + PETROVAC
- + BUDVA
- + TIVAT
- + KOTOR
- + PODGORICE
- + DUBROVNIK
- + SPLIT

Çdo ditë 08:00

Tel. 069 32 553 11 / 069 23 48 608

Rr. Urani PANO (mbrapa Hotel Tirana)



# ujeshhtë - dimër

**TISA TOURS**

www.tisatours.com



**FESTAT E FUNDVITIT!!!**

**Udhëtoni me çmime të leverdisshme!**

Zgjidhni paketat tona turistike dhe udhëtoni me komoditetin e duhur, çmimet e leverdisshme dhe udhëtimi juaj do të bëhet i paharrueshëm! Vizitoni vendet më të bukura të Ballkanit dhe Europës për të përjetuar përvojën më të bukur të festave!

Rr. "Ismail Qemali" Blv. Vlore - Skele  
Tel: +355 33 224 339  
Cel: +355 69 67 50 800

E-mail: [tisatours@gmail.com](mailto:tisatours@gmail.com)  
[www.tisatours.com](http://www.tisatours.com)

## KOLASHINI ME BORE!!!

me

**KOPLIKU TRAVEL**

Shkodër, Albania

vetëm  
**10**  
euro

sepse

*Me Kopliku Travel...  
udhëtimi juaj merr vlera...*




Shkodër, Albania, pranë Teatrit "Migjeni"  
+355 682031125; +355 682031124  
+355 674447720; 0222 50370  
[koplikuttravel@yahoo.it](mailto:koplikuttravel@yahoo.it)

## Shijoni Gjirokastrën dhe Antigonën, përmes Udhëtimeve me kuaj


Caravan Riding Center  
organizon "Udhëtim me kuaj  
në Parkun e Antigonës"  
çdo fundjavë mes muajve  
**Nëntor dhe Mars.**

Pjesëmarrja kërkon  
minimalisht formë të mirë  
sportive. Maksimumi i lejuar  
i peshës për të marrë  
pjesë është **85 kg.**

[www.caravanhorseriding.com](http://www.caravanhorseriding.com),  
Mob. 0695375743 / 0692234137  
Mob: 0695259527,  
[travelcaravan@gmail.com](mailto:travelcaravan@gmail.com)







# ALER Travel

*Tourism & Real Estate in Albania*

*Your rest with us  
is a choice of competence  
and reliability!*



## "ALER TRAVEL"

Tourism & Real Estate in Albania  
Teodor Keko str, Konfort Konstruksion  
Tirana, Albania  
Cel. +355 69 3655684  
+355 69 2969214  
Tel./Fax: +355 4 453 5555  
Skype: office.alertravel  
[www.alertravel.com](http://www.alertravel.com)







revista shqiptare e turizmit rajonal

# travel

albaniatravel.info

Nr. 21 / 2016



I rigjallëruar prej një investimi të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan dhe i sjellë në një imazh të ri, duke ruajtur traditat e dikurshme, Pazari i Vjetër i Krujës është kthyer në vendin më të vizituar prej turistëve dhe bashkë me kompleksin e Kalasë dhe Muzeve, e kanë bërë Krujën, ikonën e turizmit kulturor dhe historik në Shqipëri

**Në ballinë:**  
**Pazari i Vjetër i Krujës**  
**Foto: Shkëlzen Rexha ©**

# Fall in Albania

love with



**MAL BERISHA**  
SI I TAKOVA ARBËRESHËT



**SHKËLZEN REXHA**  
FOTOGRAFI YNË



**ËSHTË KOHA E DUHUR**  
PËR TË KALËRUAR



**FESTA E ULLIRIT**  
RIPËRTËRIN ROSKOVECIN



**RRETH BALLKANIT**  
ME BIÇIKLETË